



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2018

Prishtinë, gusht 2019

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	4
Fjala e Auditorit të Përgjithshëm.....	5
Hyrje	6
Përmbledhje e përgjithshme.....	7
Pjesa I: Pasqyrat Financiare Vjetore.....	11
1 Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore 2018	11
1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	12
1.2 Opinioni i auditimit.....	14
2 Analiza e Buxhetit Shtetëror	19
2.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve.....	21
2.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanci i fondeve	32
2.3 Deklarata për kufirin e deficitit buxhetor	33
3 Analiza e shënimeve shpjeguese.....	36
3.1 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë	36
3.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi.....	37
3.3 Borxhet publike dhe Garancitë shtetërore	39
4 Pasuritë	44
5 Llogaritë e arkëtueshme	48
6 Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente.....	51
6.1 Detyrimet kontingjente.....	53
7 Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP-së.....	55
7.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore.....	56
8 Të dhënat e punësimit	58
8.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave dhe me kontrata për shërbime të veçanta	59

Pjesa II - Të përgjithshme	60
9 Zbatimi i rekomandimeve	60
9.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2017	61
9.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2017	62
10 Opinionet e auditimeve në raportet individuale.....	66
10.1 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2018.....	68
11 Qeverisja e mirë.....	69
11.1 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	70
11.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	71
12 Prokurimi	73
12.1 Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit	73
13 Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore.....	76
14 Auditimet e performancës.....	79
15 Ndërmarrjet publike.....	87
15.1 Opinionet e auditimit për ndërmarrjet publike.....	88
15.2 Rekomandimet e vitit paraprak	89
15.3 Prokurimet në ndërmarrjet publike	90
15.4 Analiza e gjendjes financiare në ndërmarrjet publike	92
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	94
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2017	96
Shtojca III: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2018	106
Letra e konfirmimit.....	109

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	MF	Ministria e Financave
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	MAPL	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
BB	Banka Botërore	MFPP	Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BE	Bashkimi Evropian	MAP	Ministria e Administratës Publike
BPV	Bruto Produkti Vendor	MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
DK	Doganat e Kosovës	NP	Ndërmarrjet Publike
DUD	Dokumenti Unik Doganor	OB	Organizata Buxhetore
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit	RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
LPP	Ligji për Prokurim Publik	SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
LSHC	Ligji i Shërbimit Civil	SFQ	Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së
LLVTH	Llogaria e Vetme e Thesarit	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës		
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik		
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli		

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Kam kënaqësinë që t'iu dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2018. Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon të përmbush misionin e saj thelbësor për të forcuar llogaridhënien publike për shpenzimet qeveritare, si dhe përmes rekomandimeve të dhëna të ofroj mbështetje në fushat ku është vlerësuar se ka nevojë për përmirësime.

Fokusi parësor i punës sonë kanë qenë vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me vlerën për para. Ne vazhdojmë të punojmë ngushtë me Kuvendin në mënyrë që të ofrojmë informacion sa më të plotë dhe cilësor mbi përdorimin e fondeve publike dhe për t'i shtuar vlerë funksionimit efikas dhe efektiv të autoriteteve publike.

Ne kemi identifikuar se në mënyrë të theksuar, institucionet kompetente kanë nevojë të fokusohen në menaxhim më të mirë të detyrimeve të papaguara si dhe të llogarive të arkëtueshme dhe të pasurive. Përmirësimet janë të nevojshme edhe në planifikimin buxhetor dhe ngritjen e cilësisë së raportimit.

Përhapja e kulturës që paraja publike të shpenzohet në mënyrë të mençur dhe në pajtim me ligjin ka nevojë të përkrahet përmes aplikimit të praktikave të mira menaxhuese dhe zbatimit të kontroleve siç kërkohet me kornizën e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike. Lidhur me këtë, kemi dhënë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve në raportet individuale dhe po e përcjellim nga afër mënyrën se si subjektet e audituara i adresojnë rekomandimet tona.

Duke qenë se ky raport është një përmbledhje e rezultateve dhe sfidave kyçe të sektorit publik, shpresoj që i njëjti do t'iu shërbejë si një mjet i dobishëm për identifikimin e fushave ku ne duhet të punojmë së bashku për të mirën e sektorit publik dhe të qytetarëve të Kosovës.

Në fund, falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe komisionet parlamentare për mbështetjen e gjithanshme dhe bashkëpunimin korrekt në përmbushjen me sukses të mandatit të institucionit. Mirëpres angazhimin e mëtutjeshëm për të mbajtur përgjegjëse organizatat buxhetore në menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve publike, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe rritjen e transparencës në administratën publike.

Gjithashtu, vlerësoj lartë bashkëpunimin dhe korrektësinë e të gjitha organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike gjatë procesit të auditimit.

Auditori i Përgjithshëm,

Prishtinë, gusht 2019

Besnik Osmani

Hyrje

Raporti Vjetor i Auditimit paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe analitike mbi gjetjet dhe rekomandimet tona të auditimit për vitin fiskal 2018 dhe shpreh Opinionin e Auditimit (në përputhje me SNISA 200) për Pasqyrat Financiare të Qeverisë së Kosovës për vitin 2018. Raporti prezanton një përmbledhje shumë të rëndësishme që i jep mundësinë Kuvendit që të kërkoj llogari nga Qeveria për përdorimin e fondeve publike. Në këtë raport, ne kryesisht adresojmë Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë, por gjetjet dhe konkluzionet tona janë marrë, gjithashtu, edhe nga raportet individuale të auditimeve të kryera për organizatat buxhetore dhe autoriteteve tjera publike.

Ne kemi arritur që të raportojmë të gjitha auditimet në kohë, dhe në këtë mënyrë i kemi dhënë mundësinë edhe Kuvendit, edhe Qeverisë që të inicoj procedurat e llogaridhënies financiare në pajtim me ciklin buxhetor. Kjo ka bërë të mundur shqyrtimin me kohë të raporteve dhe adresimin e rezultateve të auditimit. Ne jemi të kënaqur me faktin se kemi vërejtur një interesim në rritje nga të gjitha palët e interesit për rezultatet e auditimit. Veçanërisht, KMFP ka qenë shumë aktiv në shqyrtimin e shumë raporteve tona si dhe nxjerrjen e konkluzioneve nga seancat dëgjimore.

Raporti është përgatitur në dy pjesë kryesore:

- a) Pjesa e parë e raportit i dedikohet Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2018; dhe
- b) Pjesa e dytë paraqet informata të rëndësishme për vitin raportues, por që nuk kanë ndonjë lidhje direkte dhe nuk i ndikojnë PFV-të e Qeverisë.

Pjesa e parë përmban tetë kapituj kryesor që janë pjesë përbërëse të PFV të BRK:

- 1) Opinioni i auditimit;
- 2) Analizat e Buxhetit Shtetëror;
- 3) Analiza e shënimeve shpjeguese;
- 4) Pasuritë dhe stoqet;
- 5) Llogaritë e arkëtueshme;
- 6) Detyrimet e papaguara dhe kontingjente;
- 7) Pagesat direkte nga Thesari dhe pagesat sipas vendimeve gjyqësore; dhe
- 8) Të dhënat e punësimit.

Pjesa e dytë përmban informacione për çështjet si vijon:

- 1) Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake;
- 2) Opinionet e auditimeve individuale;
- 3) Qeverisja e mirë;
- 4) Sistemi i auditimit të brendshëm;
- 5) Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut;
- 6) Prokurimi;
- 7) Zhvillimet në reformën e administratës publike;
- 8) Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore;
- 9) Auditimet e performancës; dhe
- 10) Ndërmarrjet publike.

Përveç dy pjesëve kryesore, raporti ka edhe tri Shtojca, të cilat kanë të bëjnë me: (1) Shpjegimi i llojeve të opinionëve të aplikuar nga ZKA; (2) Progresi në zbatimin e rekomandimeve; dhe (3) Tri Pasqyrat Financiare kryesore të Qeverisë. Informacione më të hollësishme për raportet individuale të auditimit, mund të gjeni në faqen tonë të internetit: www.zka-rks.org.

Përmbledhje e përgjithshme

Në pajtim me Planin vjetor të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2018 ka publikuar 126 raporte, prej të cilave: 94 raporte të rregullsisë për organizatat buxhetore, 11 auditime të ndërmarrjeve publike, 9 auditime të projekteve të donatorëve, 11 auditime të performancës dhe Raportin për Pasqyrat financiare të Qeverisë. Rezultatet e të gjitha këtyre auditimeve janë përmbledhë në mënyrë gjithëpërfshirëse në këtë Raport.

Pasqyrat financiare të Qeverisë janë audituar veçmas, dhe lidhur me to, Auditori i Përgjithshëm ka dhënë Opinion të pamodifikuar me Theksim të çështjes.

Auditimet tona kanë rezultuar me çështje të cilat duhet të adresohen për të siguruar një performancë më të mirë në shpenzimin e fondeve publike. Një çasje sistematike ndaj kësaj, do të siguronte shpenzimin në pajtim me prioritetet e bëra, suksesin në ambiciet për reforma, dhe do të hapte rrugën për shërbime më të mira për qytetarët.

Çështjet kryesore të raportit nënvizojnë nevojën për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të lartë dhe mbajtësve të buxhetit për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e përmendura si në vijim:

(a) Planifikimi buxhetor - Nga rishikimet tona ka rezultuar se fusha e planifikimit të buxhetit ende ka nevojë për përmirësime. Në fund të vitit fiskal 2018, shuma faktike e pranimeve ishte më e vogël kundrejt planit për 179 milionë apo 8%, prej të cilave 40 milionë euro lidhen me të pranime buxhetore, kurse pjesa tjetër ka të bëjë me mos realizimin e planit të disbursimit të kredive për projekte kapitale me huamarrje shtetërore - klauzola dhe pranime tjera jo buxhetore. Gjithashtu, shuma totale e pagesave për vitin fiskal 2018 ishte më pak sesa buxheti final për 216 milionë, apo 10%. Shpenzimi i buxhetit sipas rrjedhës aktuale të parasë është ekzekutuar në shkallën 98.5%. Këto përqindje tregojnë se diferencat në mes buxhetit fillestar dhe atij final janë fare të vogla, por diferencat në mes planifikimit dhe realizimit janë mjaft të larta, kryesisht për pjesën e fondeve të planifikuara nga huamarrja për projektet kapitale të cilat nuk janë zhvilluar sipas dinamikës së planifikuar të zbatimit të tyre. Gjatë vitit 2018, buxheti nuk i është nënshtruar procedurave të rishikimit, dhe si pasojë e kësaj, diferenca në mes buxhetit përfundimtar dhe ekzekutimit ishte mjaft e theksuar. Megjithatë, meqë të hyrat kanë performuar sipas planit dhe nuk është paraqitur nevoja për rishikim, përmes mekanizmit të transfereve dhe ri-alokimeve sipas autorizimeve të LMFP si dhe ligjit të buxhetit, është mundësuar adresimi i kërkesave të OB, kryesisht në tremujorin e fundit. Pra, për shkak se projeksionet fillestare në shumë elemente ishin jo adekuate, dhe mungesës së rishikimit gjatë vitit, lëvizjet buxhetore të pranimeve dhe pagesave kundrejt ekzekutimit, kanë rezultuar me përqindje relativisht të lartë të shpërputhjeve. Kjo është paraqitur kryesisht për shkak të mos përcjelljes së planifikimit nga OB me zbatimin e projekteve kapitale të financuara nga huamarrja publike. Sidoqoftë, përfshirja e tyre brenda ligjit të buxhetit është kushtëzuar me faktin se këto financime rrjedhin nga marrëveshjet financiare nderkombëtare të ratifikuara dhe sipas legjislacionit duhet të jenë pjesë e Ligjit të buxhetit.

Përderisa buxheti shtetëror kalon nëpër disa procedura më efektive të kontrollit gjatë miratimit, aprovimi i buxhetit apo planeve financiare në ndërmarrjet publike është i pa qëndrueshëm dhe larg parashikimeve fillestare. Si pasojë e planifikimeve të dobëta, shumë objektiva kanë mbetur të përealizuara.

(b) Cilësia e raportimit - Informatat në pasqyra individuale, por edhe në raportin e konsoliduar të Qeverisë, vështruar në kuptimin e cilësisë dhe saktësisë, përgjithësisht janë prezantuar mirë dhe në pajtim me standardet e raportimit. Si rezultat i kësaj, janë dhënë 86 opinione pozitive të auditimit, dhe 19 opinione me rezervë apo të modifikuara (përfshirë edhe ndërmarrjet publike). Mangësi domethënëse në fushën e raportimit janë identifikuar tek ndërmarrjet publike. Vetëm një, nga 11 ndërmarrjet publike, ka opinion pozitiv. Kjo është një tregues se raportimi i tyre financiar për vite me radhë nuk është përmirësuar dhe paraqet një gjendje mjaft shqetësuese.

(c) Keqklasifikimi i shpenzimeve - Vazhdon të mbetet fusha më problematike në aspektin e raportimit. Edhe gjatë këtij viti, janë identifikuar shuma të larta të keq klasifikimit të shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme ekonomike, që në total janë 22,011,636€, dukshëm më e lartë se ajo e vitit paraprak (16,037,978€). Kjo ka ndodhur për tri arsye: **e para**, gabimet me rastin e planifikimeve përmes procesit buxhetor (18,963,580€); **e dyta**, OB-të gjatë vitit për arsye të ndryshme kanë kryer pagesa nga kategoritë joadekuate (1,167,527€); dhe **e treta**, ekzekutimi i pagesave të detyrueshme (vendime gjyqësore dhe përmbarimore, pagesa direkte sipas autorizimit të LMFPN neni 39.2 nga ana e Thesarit nga kategoritë jo adekuate, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë përkatëse të OB. Kategoria më e ndikuar nga keqklasifikimet ishin investimet kapitale, nga e cila ishin paguar mallra dhe shërbime, si dhe subvencione, në shumë prej 19,454,266€ apo 88% e totalit.

(d) Deficiti buxhetor - Viteve të fundit, për shkak të shpërputhjeve në mes të hyrave dhe shpenzimeve, Qeveria vazhdimisht planifikon buxhetin me deficite. Sipas raportit financiar të Qeverisë, shuma maksimale e lejuar me ligj e deficitit buxhetor për vitin 2018 ishte 132.8 milionë (2%), shuma e aprovuar ishte 122.2 milionë (1.8%) ndërsa deficiti faktik (aktual) në fund të vitit ishte 64.7 milionë (duke përfshirë donacionet) apo 1%. Qeveria ka mbajtur nën kontrollë të plotë pragun e deficitit dhe është në kuadër të kërkesave ligjore. Deficiti në fund të vitit sipas vlerësimit të ZKA ishte 66.3 milionë, i cili nuk përfshin grantet e donatorëve.

(e) Borxhi publik - Buxheti i Kosovës, përveç të hyrave të rregullta, financohet edhe nga huamarrjet e brendshme dhe të jashtme, të cilat në fund të vitit 2018 kanë arritë shumën prej 1,093 milionë, duke mos i llogaritur edhe 44 milionë garancione shtetërore prej të cilave 676.6 milionë borxhe të brendshme dhe 416.2 borxhe të jashtme. Niveli i tanishëm i borxhit publik është 17.1% e Bruto Produkti Vendor. Problemi kyç lidhur me këto borxhe është mosefikasiteti i shpenzimeve, kjo për faktin 393 milionë euro kredi të ratifikuara ende nuk janë tërhequr për shkak të vonësave në fillimin dhe realizimin e projekteve për të cilat janë ratifikuar këto shuma të kredive, ndërkohë që shuma të konsiderueshme të shpenzimeve të interesit dhe tarifave tjera janë paguar brenda kësaj periudhe (18.7 milionë shpenzime të interesit dhe 290 mijë euro tarifa të zotimit).

Shuma e huamarrjeve gjatë këtij viti ishte 121,918,000€. Këtë shumë e përbëjnë: huamarrja e brendshme 102,434,000€, huamarrja e jashtme 11,334,000€ dhe pranimet nga nënhuazimet 8,250,000€.

(f) Bilanci i parasë së gatshme - Shuma totale e parasë së gatshme në LLogarinë e Thesarit shtetëror më 31 dhjetor 2018 ishte 387,9 milionë, prej të cilave 86.2 milionë ishin fonde të përcaktuara dhe 301.7 milionë janë fonde të depozituara, por të pa shpërndara. 56% të fondeve të përcaktuara apo 48.2 milionë janë THV të bartura si fonde të pa shpenzuara të komunave dhe OB-ve tjera. Kjo shumë është rritur në krahasim me vitin e kaluar për 15.3 milionë, dhe shpalos tendencën që, OB-të së pari i shpenzojnë fondet nga granti qeveritar, e pastaj të hyrat vetiake.

Bazuar në rezultatet e auditimit nuk ekziston ndonjë kërcënim serioz i stabilitetit financiar të shtetit.

Sfidat kryesore me ndikime në bilancin buxhetor janë detyrimet e pa paguara dhe kërkesat ndaj debitorëve, të cilat në mënyrë direkte apo indirekte mund t'i ndikojnë llogaritë qeveritare. Këto llogari kanë të bëjnë me:

(g) Detyrimet e pa paguara dhe ato kontingjente - Detyrimet e pa paguara të Organizatave buxhetore ndaj furnizuesve dhe operatorëve tjerë ekonomik në fund të vitit 2018 ishin rreth 259 milionë (226 milionë të nivelit qendror prej të cilave vetëm shpronësimet nga MMPH 162 milionë, si dhe 33 milionë në nivel të komunave), një rritje prej 30 % në krahasim me vitin 2017. Përveç këtyre detyrimeve financiare, ekzistojnë edhe disa detyrime potenciale apo kontingjente, të cilat janë rezultat i padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritet të marrin epilogun gjyqësor. Shuma e këtyre detyrimeve të mundshme është rreth 197 milionë (88 milionë në nivel qendror dhe 109 milionë në nivel lokal), me një rritje prej 39% në krahasim me vitin paraprak.

(h) Llogaritë e arkëtueshme - Shuma e borxheve të qyetarëve dhe bizneseve ndaj Qeverisë është rreth 632 milionë, nga të cilat në nivel qendror janë 462 milionë dhe në nivel lokal 169 milionë. Pjesa dërmuese e borxheve të pambledhura ka të bëjë me ATK-në dhe Doganën, të cilat së bashku kanë 418 milionë borxhe të pambledhura apo 66% të shumës totale. Obligimet e subjekteve ekonomike ndaj ATK-së janë 375 milionë, dhe ndaj Doganës 43 milionë. Rritja totale e llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2018, krahasuar me një vit më parë, është 93 milionë apo 17%.

Ndikimi i këtyre dy kategorive në planifikimet buxhetore është i rëndësishëm kritikë, si për të hyrat, ashtu edhe për shpenzimet buxhetore, me ndikimin përfundimtar në qëndrueshmërinë makro-fiskale me rrezikun real që për shkak të vjetërsisë së tyre të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të mos mblidhen asnjëherë.

(i) Pasuritë dhe stoqet - Regjistrimi i pasurive në kontabilitetin qeveritar ende vazhdon të mbetet një proces i pa përfunduar dhe mbase është një ndër problemet kyçe të menaxhimit. Sipas vlerësimeve tona, procesi i regjistrimit është i ngadalshëm dhe shumë larg përfundimit. Totali i pasurive neto në fund të vitit ishte 8 miliardë e 438 milionë. Si rezultat i regjistrimeve të reja gjatë vitit, saldo e pasurive kapitale (me vlerë mbi 1.000 euro) në krahasim me vitin paraprak është rritur për 358 milionë.

Përveç regjistrimeve kontabël të pasurive, pjesa dërmuese e organizatave nuk bëjnë inventarizimin e pasurive dhe stoqeve në fund të vitit për të konfirmuar ekzistencën e pasurisë, dhe për të vlerësuar funksionalitetin dhe përdorimin e tyre. Komisionet e inventarizimit ose i bëjnë me vonesë raportet e inventarizimit, ose nuk bëjnë fare barazimet e gjendjes së regjistrimit me gjendjen kontabël. Mungesa e regjistrimeve të fundvitit pamundëson pasqyrën e plotë të

ekzistencës së pasurive dhe krijon mundësinë e keqmenaxhimit, keqpërdorimit apo edhe vjedhjes së pasurive.

(j) Likuiditeti i organizatave buxhetore - Për shkak të mospagesës së obligimeve me kohë të organizatave buxhetore, Thesari ka ekzekutuar rreth 29 milionë euro pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore si dhe pagesa direkte sipas autorizimeve të Nenit 39.2 të LMFPF dhe ndaj operatorëve ekonomik dhe pretenduesve tjerë. Prej tyre, 8.7 milionë nga Thesari janë ekzekutuar si pagesa direkte në llogari të operatorëve për shkak të mos kryerjes së detyrimeve të subjekteve buxhetore brenda 60 ditësh, ndërsa mbi 20 milionë janë shumat e paguara në emër të Vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore për të cilat janë paditur organizatat buxhetore. Krahasuar me vitin 2017, trendi i ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, ka pasur një rritje afër 44%.

(k) Ndërmarrjet Publike - Rezultatet e auditimit shpalosin se raportimi financiar i 11 ndërmarrjeve të audituara ka mangësi dhe është i pasaktë. Për këtë arsye në 10 raste është dhënë opinion negativ. Përveç raportimit të dobët, gjendja e tyre financiare është e vështirë dhe struktura e financimit është mjaft e pavolitshme. Nga pasqyrat financiare për vitin 2018, shihet se gjashtë ndërmarrje publike kishin operuar me humbje, që në total kap shumën prej rreth 20 milionë, ndërsa pesë ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar, me fitim simbolik prej pak më shumë se 500,000€.

Raportet individuale përmbajnë shifra shqetësuese për stabilitetin financiar të këtyre ndërmarrjeve. Ato, të gjitha së bashku, kanë mbi 144 milionë detyrime kreditore, prej të cilave 73 milionë detyrime afatshkurtëra, dhe mbi 71 milionë detyrime afatgjata. Pagesa e këtyre detyrimeve është mjaft e pasigurt, marrë parasysh faktin se shumica e tyre operojnë me humbje. Madje, parimi i vijimësisë së veprimtarisë në disa prej tyre, mund të vie në pikëpyetje serioze. Trendet e tilla financiare në këto ndërmarrje janë negative, dhe Qeveria si aksionar, mund të ballafaqohet me sfida serioze në vendimet e saj se si të veprohet në rastet kur aftësia likuiduese e tyre është shumë e pasigurt, ndërkaq borxhet dhe kreditë duhet të kthehen brenda afateve ligjore derisa shërbimet kundrejt qytetarëve duhet të kryhen.

(l) Zbatimi i rekomandimeve - Rekomandimet e dhëna në vitin paraprak janë adresuar vetëm pjesërisht. Prej numrit të përgjithshëm të rekomandimeve të dhëna (1,121), plotësisht ishin zbatuar 438 ose 39%, në proces të zbatimit ishin 201 apo 18%, nuk ishin adresuar 354 apo 32% dhe 128 apo 11% ishin mbyllur të pa zbatuara.

Krahasuar me një vit më parë, rekomandimet plotësisht të zbatuara kanë shënuar një rritje nga 395 në 438 apo nga 34% në 39%, çka mund të vlerësohet si një zhvillim pozitiv në përmirësimin e proceseve.

Thesari në emër të Ministrisë së Financave ka përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve, i cili është aprovuar në Qeveri me vendimin nr. 08/69 të datës 16.10.2018. Ky plan parasheh raportim gjashtëmujor në Qeveri të institucioneve të caktuara lidhur me adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së.

Pjesa I: Pasqyrat Financiare Vjetore

1 Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore 2018

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofroj një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë ministrinë, komnatat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Baza juridike për kryerjen e auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë 2018 përcaktohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (neni 19);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (neni 47 dhe 48); dhe
- Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2018/2019.

Auditimi është kryer duke u bazuar në:

- Doracakun për auditimin e rregullsisë;
- Doracakun për menaxhimin e cilësisë;
- Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe është kryer duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime financiare dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme. Në fazën e planifikimit të auditimit është përcaktuar edhe niveli i materialitetit prej 1% i shumës totale të pranimeve buxhetore, përkatësisht shkalla deri në të cilën tolerohen gabimet në prezantimin e të dhënave në PFV, e që nuk konsiderohen me ndikim domethënës për kredibilitetin e pasqyrave.

Sistemi i evidencave dhe raportimit të buxhetit të Kosovës është i bazuar në para të gatshme apo në bazë të modifikuar të parasë së gatshme, ku të gjitha të hyrat dhe të dalat procesohen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, ndërsa regjistrohen në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës. Përkundër kësaj, organizatat buxhetore janë të obliguara të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë, dhe sipas rregullores MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që në bazë të këtyre regjistrave të përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe t'i raportojnë Ministrisë së Financave.

Auditori i Përgjithshëm e përmbushë përgjegjësinë e tij duke e kryer një herë në vit auditimin e raportit të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit dhe raporteve shoqëruese. Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit, ndërsa rezultatet e auditimeve individuale i raportohen veçmas subjekteve të audituara dhe Kuvendeve Komunale.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar me faktin se asnjë nga 94 organizatat individuale buxhetore nuk kishte mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për raportimin vjetor financiar (formati, struktura, afatet e raportimit, etj). Të gjitha OB-të kanë dorëzuar Pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2019. Por, deri në hartimin e Pasqyrave të konsoliduara të Qeverisë (31 mars 2019), 51 OB kanë bërë korrigjime në pasqyrat e tyre, 32 nuk kanë pasur nevojë për korrigjime, dhe në 11 të tjera, gjatë auditimit janë identifikuar gabime të pa korrigjuara.

Nga ky rishikim rezulton se gabimet e pa korrigjuara më të shpeshta në raportet individuale kanë të bëjnë me:

- Ekzistencën e diferencave në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe gjendjen e investimeve kapitale, kurse te shpalosjet - me paraqitjen e diferencave te llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, detyrimet kontingjente dhe grantet e donatorëve;
- Mbivlerësimi apo nënvlerësimi i numrit të punësuarve dhe pagesat e parregullta në fushën e pagave nga organizatat buxhetore;
- Keqklasifikimet apo regjistrimet e shpenzimeve në kodet jo adekuate, çka ndikon në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e llogarive; dhe
- Mungesa e shpalosjes së avanceve në pasqyrat individuale.

Çështjet e ngritura më lart, do të shqyrtohen në hollësi në kapitujt vijues të raportit.

1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatitë dhe prezantoj në mënyrë të drejtë Pasqyrat Financiare Vjetore sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për kontrole të brendshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara nga gabimet dhe mashtrimet.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda afateve ligjore dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe në pajtim me SNKSP, ka dorëzuar për aprovim në Qeveri pasqyrat financiare vjetore për vitin 2018. Më 26 mars 2019, të njëjtat janë aprovuar nga ana e Qeverisë, dhe më 29 mars 2019, një kopje e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 i është dorëzuar edhe Auditorit të Përgjithshëm.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF të Qeverisë. Auditimi ynë është fokusuar në tri pasqyrat kryesore:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin; dhe
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancet e fondeve.

Objektiv i auditimit ishte që të ofrojmë një siguri të arsyeshme:

- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Ekzaminimi i PVF për vitin 2018 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA. Çasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit nëpër të cilin janë hartuar PVF. Ky kuptim ka të bëjë me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për një opinion të pamodifikuar, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Çasja e ndërmarrë reflekton edhe vlerësimin e rezultateve të dala të auditimeve të OB-ve të cilat janë konsoliduar në PVF. Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keq deklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontroleve të brendshme, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Seksionet e mëposhtme të Raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që kanë karakterizuar vitin 2018, por gjithsesi ofrojnë një nivel të pranueshëm të sigurisë.

1.2 Opinioni i auditimit

ZKA ka audituar RFV/BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, i cili përfshinë pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, si dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, RFV i BRK-së paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj se në Pasqyrën e Konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, ekziston një shumë e planifikuar, por e pa specifikuar e të hyrave prej 10,500,000€, si dhe është identifikuar keq klasifikim në planifikimin e shpenzimeve në një shumë totale prej 22,011,636€. Më gjerësisht, shih bazën për opinionin.

SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Përkundër dhënies së opinionit të pamodifikuar, ZKA tërheq vëmendjen tuaj se Pasqyrat përmbajnë disa gabime dhe paqartësi, të cilat nuk janë konsideruar materiale për dhënien e opinionit, për shkak se si të tilla janë sanksionuar me Ligjin e Buxhetit Vjetor nga Kuvendi i Kosovës, përkundër faktit se planifikimi i shpenzimeve nuk ishte në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.

Gabimet dhe paqartësitë kanë të bëjnë me çështjet si në vijim:

- Me rastin e krahasimit të Tabelës 1 të Buxhetit fillestar sipas Ligjit 06/L-020 për Buxhetin 2018 dhe të dhënave të prezantuara në Pasqyrën e Konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, ne kemi identifikuar një mospërputhje prej 10,500,000€. Te planifikimi i rrjedhës hyrëse të parasë sipas buxhetit fillestar, zëri Pranimet tjera ishte parashikuar në shumën 132,500,000€, por me rastin e analizave të këtij zëri buxhetor, ne nuk kemi mundur ta identifikojmë burimin e të hyrave, si te buxheti fillestar ashtu edhe tek ai përfundimtar. Ministria e Financave nuk ishte në gjendje të ofroj sqarimet e duhura për burimin e këtyre të hyrave. Prandaj, konkluzioni është se Buxheti i të hyrave si pranime, ishte mbivlerësuar për të njëjtën shumë. Më gjerësisht, shih kapitullin 2; dhe

- Shuma të konsiderueshme të shpenzimeve ishin planifikuar dhe klasifikuar nëpër kategori ekonomike joadekuate qysh në fazën e aprovimit të Buxhetit vjetor 2018, të cilat më pas, gjatë vitit edhe janë shpenzuar dhe regjistruar në kodet e gabuara ekonomike. Si rezultat i gabimeve qysh në fazën e planifikimeve buxhetore, por edhe gabimeve tjera gjatë vitit, në 44 OB janë identifikuar keq klasifikime të shpenzimeve në një shumë totale prej 22,011,636€. Prej tyre, 14,412,689€ apo 65% te 13 organizata të nivelit qendror, 7,049,876€ apo 32% te 27 komuna, dhe 549,071 apo 3% te 4 institucione të pavarura.

Nga totali i këtyre shpenzimeve të planifikuara, 19,454,266€ janë investime kapitale të cilat ishin shpenzuar për paga, mallra e shërbime dhe subvencione; 1,777,874€ nga Mallrat dhe Shërbimet janë paguar për paga, subvencione dhe investime kapitale; dhe 779,494€ të destinuara për subvencione, janë shpenzuar gabimisht për paga, mallra e shërbime, dhe investime kapitale. Rreth 86% e shumave të keq klasifikuara rrjedh nga buxhetimi, përkatësisht nga Ligji i buxhetit.

Arsyet e keq klasifikimit të shpenzimeve ishin: 18,963,580€ për shkak të planifikimit jo të duhur gjatë procesit buxhetor; 1,167,527€ për shkak të pagesave nga kode të gabuara, nga organizatat buxhetore; dhe 1,880,529€ për shkak të pagesave nga kodet jo adekuate nga ana e Thesarit në emër të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore të formës së prerë si dhe pagesave direkte sipas nenit 39.2 të LMFPP.

Vlen të theksohet se Qeveria i kishte dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa Projektligjin e Buxhetit për vitin 2018, dhe ky Komision më pas i kishte dorëzuar Kuvendit këtë projektligj për miratim me një numër të madh amendamentesh të Komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare dhe deputetëve, të cilat në masë të madhe edhe ishin aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në ligjin përfundimtar. Kjo edhe kishte ndikuar që shumë nga këto shpenzime të planifikuara me ndarje buxhetore, të mos klasifikohen drejt.

Praktikat e keq planifikimit, e rrjedhimisht edhe keq klasifikimit të shpenzimeve, kanë vazhduar për vite me radhë, dhe lidhur me këtë, në vazhdimësi janë dhënë rekomandime për përmirësim. Ne i kemi bërë një analizë të preliminare edhe Ligjit të Buxhetit 2019, dhe kemi vërejtur se përmirësimet në këtë fushë janë të dukshme. Megjithatë, konkluzionet përfundimtare do të nxirren pas auditimit të Pasqyrave financiare të vitit 2019, dhe kjo ka qenë arsyeja për të mos e modifikuar opinionin.

Detaje për keqklasifikime të shpenzimeve janë dhënë në tabelat vijuese:

Tabela 1 - Keq klasifikimi sipas kategorive ekonomike

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Investime Kapitale	Paga dhe mëditje	130,960	18,073	343,977	493,010
	Mallra dhe shërbime	91,856	17,743,459	678,016	18,513,331
	Subvencione dhe Transfere	113,718	319,881	14,326	447,925
Gjithsej Investimet Kapitale					19,454,266
Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	269,872	5,610	535,627	811,109
	Subvencione dhe Transfere	37,459	126,810	0	164,269
	Investime Kapitale	36,953	579,395	186,148	802,496
Gjithsej Mallra dhe shërbime					1,777,874
Subvencione dhe Transfere	Paga dhe mëditje	177,370	0	0	177,370
	Mallra dhe shërbime	309,339	57,783	18,000	385,122
	Investime Kapitale	0	112,569	104,435	217,004
Gjithsej Subvencione dhe Transfere					779,496
Gjithsej keq Klasifikimi		1,167,527	18,963,580	1,880,529	22,011,636

Tabelë në vazhdim përfshinë 11 projektet më të mëdha, në vlerë prej 15,612,652€ të cilat ishin planifikuar gabimisht me Lgjin e buxhetit. Këtu nuk përfshihen pagesat e ekzekutuara nga ana e Thesarit.

Tabela 2 - Të planifikuara me Ligjin e buxhetit

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	7,569,820	Këto pagesa kanë të bëjnë me blerjen e teksteve shkollore për nxënësit e nivelin I dhe II të arsimit para universitar.
Zyra e Kryeministrit	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	2,174,676	Përkundër kërkesave të vazhdueshme, AUV-it nuk i janë ndarë mjete të mjaftueshme për Mallra dhe Shërbime, dhe Subvencione.
Prishtinë	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	1,202,902	Pagesat kanë të bëjnë me shpenzimet për mallra dhe shërbime (Mirëmbajtja e sipërfaqeve publike, deratizimin e podrumeve, trajtimin e qenve endacak, zgjedhjen e sportistit të vitit, dezinfektimin hapësinor, art në hapësira publike).

Prizren	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	923,878	Fondet buxhetore ishin shpenzuar kryesisht për kontratat: Fshirja dhe larja e rrugëve; Furnizimi i fermerëve me farë gruri dhe misri; Sigurimi fizik i objektit; Subvencionimi i klubeve sportive; Manifestimet e festave të Qershorit etj.
MASHT	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	780,247	Këto pagesa janë bërë për: blerje e inventarit për shkolla, pajisje për salla te sportit, etj.
Ministria e Infrastrukturës	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	689,310	Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve janë paguar nga buxheti i investimeve kapitale. Kontratat e mirëmbajtjes në bazë të të cilave janë kryer aktivitetet, si: largimi i vegetacionit, heqja e borës, hedhja e kripës, prerja e barit, monitorimi, inspektimi etj. nuk konsiderohen shpenzime kapitale.
Ministria e Administratës Publike	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	588,300	Vlera prej 500,000€ është paguar si “Mbështetje për zbatimin e reformës së administratës publike” ndërsa vlera prej 88,300€ është për furnizim me inventarë në Universitetin e Mitrovicës.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	512,372	Në regjistrin e pasurisë kapitale në saldon fillestare janë identifikuar pesëmbëdhjetë (15) pasuri të cilat për nga natyra takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.
ShSKUK	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	416,594	Këto pagesa janë shpenzime të mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve mjekësore.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Mallra dhe shërbime	Investime Kapitale	379,941	Këto pagesa janë për projektin “Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillimin Ekonomik të Kosovës (SIZHEK)”, prej 379,941€.
Glligoci	Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	374,616	Pagesat për paga dhe mëditje (paga jubilarë dhe paga sipas marrëveshjes kolektive) të ekzekutuara nga ana e Thesarit me vlerë prej 374,616€.

Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës

- Kuvendi i Kosovës, para se të miratoj Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, duhet të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar sipas kategorive ekonomike adekuate, dhe se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik; dhe
- Të siguroj se të gjitha të hyrat e planifikuara me buxhet, janë të specifikuara qartë sipas burimeve përkatëse të financimit.

Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës

- Qeveria e Kosovës duhet të siguroj se në Projektligjin për ndarjet vjetore të buxhetit, para se t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për aprovim, është bërë klasifikimi i duhur i shpenzimeve nëpër kategoritë përkatëse ekonomike dhe kodet sipas planit kontabël të Thesarit dhe kërkesave raportuese; dhe
- Të siguroj se burimi i të hyrave buxhetore sipas ndarjeve fillestare të Buxhetit vjetor, është i specifikuar qartë dhe planifikimi i buxhetit është bërë në baza të qëndrueshme.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave/Departamenti i Buxhetit

- Me rastin e përgatitjes së Projektligjit vjetor të buxhetit, Ministria e Financave duhet të merr të gjitha masat, të ushtroj kontrolle shtesë dhe të siguroj se organizatat buxhetore kanë planifikuar dhe klasifikuar shpenzimet buxhetore në kategoritë adekuate ekonomike, dhe Qeverisë të mos i dorëzohet Projektligji me gabime qysh në fazën e planifikimit. Departamenti i buxhetit dhe Thesari duhet të punojnë ngusht për eliminimin e këtyre gabimeve, para se Plani buxhetor t'i dorëzohet Qeverisë;
- Para se të miratohet Ligji vjetor i buxhetit, Ministri i Financave duhet të siguroj se amendamentet ligjore të paraqitura nga Komisionet parlamentare, grupet parlamentare apo deputetët, janë në përputhje me kërkesat e planit kontabël dhe nuk implikojnë keq klasifikime të shpenzimeve; dhe
- Me rastin e planifikimit të të hyrave buxhetore, të siguroj se ekzistojnë analiza të mjaftueshme dhe të qarta për dokumentimin e burimeve përkatëse të të hyrave.

2 Analiza e Buxhetit Shtetëror


Pasqyrat e Konsoliduara Financiare të Qeverisë paraqesin informacione për projeksionet fillestare dhe ato përfundimtare të buxhetit 2018, duke i përfshirë fondet dhe burimet e fondeve, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Buxheti për vitin 2018 është përgatitur dhe aprovuar në përputhje me Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin 2018. Qeveria, gjatë vitit 2018 nuk kishte vlerësuar nevojën për rishikim buxheti, kështu që nuk ishte ndërmarrë ndonjë proces rishikimi gjashtëmujor për të pasuar ndryshimet e projeksioneve fillestare të buxhetit. Megjithatë, gjatë vitit kanë ndodhur një sërë ndryshimesh të buxhetit nëpër kategori të ndryshme ekonomike brenda organizatave buxhetore. Qeveria kishte marrë një numër vendimesh me të cilat diku ka rritur, dhe diku ka reduktuar fondet dhe alokimet buxhetore të organizatave të ndryshme. Realizimi i buxhetit edhe këtë vit është përcjellë me mangësi të ndryshme. Reduktimi i fondeve dhe alokimeve nga ana e Qeverisë, ka ndikuar që shuma të konsiderueshme të detyrimeve të mbeten të pa paguara, por edhe një numër i projekteve të mos realizohen dhe të barten për vitin pasues.

Në aspektin e planifikimit edhe të hyrat, edhe shpenzimet, kanë shënuar një trend përkeqësimi në krahasim me vitet paraprake. Të hyrat e buxhetuara janë realizuar në shkallën prej 92%, ndërsa shpenzimet 90% në nivel të buxhetit përfundimtar. Ekzekutimi i buxhetit në bazë rrjedhës aktuale të parasë së gatshme ishte 98.5%, që paraqet një efikasitet më të lartë të shpenzimeve sesa një vit më parë. Dukuria e shpenzimeve të rritura në fund të vitit ka vazhduar edhe këtë vit. Sidomos ky është një tregues i dobët i planifikimit dhe kontrolleve mbi buxhetet e projekteve kapitale.

Informata më të plota mbi planifikimin fillestar dhe buxhetin përfundimtar, janë prezantuar në vijim.

Tabela 3 - Pranimet dhe Pagesat sipas Ligjit të buxhetit fillestar dhe final (në '000 euro)

Nr	Zërat buxhetor	Buxheti fillestar sipas Ligjit 06/L-020	Buxheti fillestar sipas auditimit	Dallimi	Buxheti final sipas SIMFK	Buxheti final sipas auditimit	Dallimi
1.	Gjithsej të hyrat	1,828,425	1,828,425	0	1,828,425	1,828,425	0
2.	Financimi nga huamarrja	216,814	216,814	0	216,814	216,814	0
3.	Pranimet tjera	132,500	122,000	10,500	144,090	133,590	10,500
	Gjithsej pranimet	2,177,739	2,167,239	10,500	2,189,329	2,178,829	10,500
1.	Pagat dhe Meditje	590,000	590,000	0	600,202	600,202	0
2.	Mallra dhe shërbime	265,000	265,000	0	287,249	287,249	0
3.	Subvencione dhe Transfere	526,000	526,000	0	568,475	568,475	0
4.	Rezerva	4,800	4,800	0	222	222	0
5.	Investimet Kapitale	694,000	694,000	0	673,547	673,547	0
6.	Shpenzimet nga donacionet	12,000	12,000	0	0	0	0
7.	Pagesa e interesit	24,000	24,000	0	24,000	24,000	0
8.	Pagesa e kryegjësë	24,000	24,000	0	23,164	23,164	0
9.	Nën huazimet	19,000	19,000	0	19,000	19,000	0
	Gjithsej pagesat	2,158,800	2,158,800	0	2,195,859	2,195,859	0
	Rritja e bilancit bankar	19,000	8,439	10,500	(6,530)	(19,593)	10,500



Me rastin e analizës së Pasqyrës dytë - pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin, ne kemi gjetur se ekziston një diferencë prej 10,500,000 ndërmjet vlerës së prezantuar në PFV dhe vlerës sipas auditimit. Diferenca është identifikuar tek rrjedha hyrëse e parasë së gatshme, në kolonën e buxhetit fillestar, tek pozicioni **Pranimet tjera** në vlerë prej 132,500,000.

Sipas auditimit, bazuar në Ligjin e buxhetit 2018 (Tabela 1), vlera e buxhetuar e Pranimeve tjera është 132,500,000, e cila përbëhet nga burimet e prezantuara në tabelën vijuese.

Tabela 4 - Planifikimi i të hyrave nga Pranimet tjera (në euro)

Zëri - Pranimet tjera	Sipas Ligjit Nr. 06/L-020	Sipas auditimit	Diferenca	Sipas Buxhetit final SIMFK	Sipas auditimit	Diferenca
Të hyrat e dedikuara AKP dhe ASHN	11,000,000	11,000,000	0	11,000,000	11,000,000	0
Kthimi i kredive NP (KEK)	11,000,000	11,000,000	0	11,000,000	11,000,000	0
Të hyrat e njëhershme nga AKP	100,000,000	100,000,000	0	100,000,000	100,000,000	0
Te hyrat e njëhershme nga FKPK	0	0	0	11,590,000	11,590,000	0
Të hyrat e pa identifikuar	10,500,000	0	10,500,000	10,500,000	0	10,500,000
Totali	132,500,000	122,000,000	10,500,000	144,090,000	133,590,000	10,500,000

Ne nuk ishim në gjendje ta sqarojmë se prej nga financohet diferenca e identifikuar prej 10,500,000, për shkak se për këtë shumë të buxhetuar të pranimeve nuk është i njohur burimi i financimit. Kjo diferencë është përcjellur gjatë tërë vitit, dhe si e tillë, është reflektuar edhe tek buxheti final në të njëjtën shumë. Megjithatë, pavarësisht kësaj difference brenda strukturës së tabelës, ndryshimi në bilancin bankar si dhe bilancin neto të prezantuar në pasqyrën e dytë është në përputhje të plotë me këto elemente të tabelës 1 të Ligjit të buxhetit.

2.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet shtetërore duhet të jenë të balancuara. Meqenëse të hyrat sipas buxhetit fillestar ishin parashikuar të jenë më të vogla se shpenzimet, diferenca ishte planifikuar të mbulohej nga fondet e huamarrjes, kthimi i disa borxheve nga ndërmarrjet publike, të hyrat e njëhershme të AKP, dhe nga disa burime tjera jo të rregullta. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2018 nuk i është nënshtruar procedurave të rishikimit buxhetor, por gjatë vitit me vendime të Qeverisë janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore. Këto rregullime janë bazuar në autorizimet ligjore që jepen në bazë të LMFPF.

Pasqyra në vijim paraqet trendin e të hyrave sipas projeksioneve fillestare, përfundimtare dhe shumë aktuale të pranimeve dhe pagesave. Të dhënat për tri vite janë marrë nga Pasqyra e pranimeve dhe pagesave sipas MF.

Tabela 5 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme (në euro¹)

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2018	Buxheti final 2018	Realizimi 2018	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Pranimet	2,177,739,000	2,189,329,000	2,009,673,000	1,923,360,000	1,777,908,000
Pagesat	2,158,645,000	2,195,859,000	1,979,559,000	1,836,805,000	1,763,242,000

Përveç çështjeve të përshkruara në bazën për opinionin e auditimit, çështjet kryesore të dala nga analizat tona janë si në vijim:

- Buxheti fillestar dhe ai final, si në aspektin e planifikimit të të hyrave, ashtu edhe të shpenzimeve, nuk kanë diferenca të theksuara. Pranimet sipas buxhetit final kishin rezultuar për 11,590,000€ ose 0.5% më të larta sesa ato me buxhet fillestar, kurse pagesat për 37,214,000€ ose 1.7%. Variancat në mes projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit janë mjaft të ulta, por diferencat në mes parametrave të planifikuar dhe të realizuar janë shumë të larta. Diferencat e theksuara në mes shumave të planifikuara dhe të realizuara janë kryesisht si rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale me financim nga burimet e jashtme të financimit (klauzola investive) dhe rrjedhimisht mos disbursimit të kredive.
- Të hyrat e parashikuara me buxhet final ishin realizuar 2,009,673,000€, apo 92% e buxhetit përfundimtar, kurse shpenzimet janë realizuar në shumën totale prej 1,979,559,000€ apo 90%
- Pranimet gjatë vitit 2018, krahasuar me ato një vit më parë janë rritur për 86,313,000€, apo 4.5%, kurse pagesat për 142,754,000€ apo rreth 8%.
- Diferenca në mes totalit të Pranimeve dhe totalit të pagesave është 30,115,000€. Kjo shumë paraqet fondet e pa shpenzuara dhe reflekton rritjen e parasë së gatshme në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, e cila në datën 31 dhjetor 2018 ka një saldo përfundimtare prej 387,874,000€.
- Buxheti vjetor, përveç financimeve nga të hyrat e rregullta, ishte planifikuar të financohej edhe nga fondet e huamarrjes. Shuma e huamarrjeve vjetore ishte planifikuar 216,814,000€ apo rreth 10% e totalit të pranimeve. Megjithatë, huamarrjet në fund të vitit ishin 122,018,000€ apo 6% e totalit të pranimeve në para të gatshme. Pjesa dërmuese e huazimeve prej 102,434,000€ janë hua të brendshme, respektivisht emetimi i letrave me vlerë. Fondet e huamarrjes gjatë vitit 2018 ishin zvogëluar në krahasim me vitin paraprak për 89,916,000€ apo 73%.
- Përveç të hyrave tatimore, jotatimore, huamarrjes, një shumë të konsiderueshme në zërat e të hyrave buxhetore e përbën edhe financimi i njëhershëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimi (AKP). Shuma e financuar e buxhetit nga AKP ishte 86,146,000€ apo mbi 4%.

Në përqindje të vogla, arka shtetërore është financuar edhe nga disa burime tjera jo të rregullta, si: (a) Huamarrja e jashtme dhe nën-huazimet 19,584,000€; (b) Të hyrat e njëhershme nga Trusti i Kursimeve Pensionale 11,590,000; (c) Grantet e donatorëve 8,319,000€; (d) Kthimi i kredive nga Ndërmarrjet publike 10,876,000€; (e) Të hyrat e dedikuara 10,493,000€; dhe (f) Fondi i depozitave 3,612,000€.

¹ Për shkak se në Pasqyra shifrat janë prezantuar në mijëshe, në tabelë janë paraqitur të plota, por të rrumbullaksuara.

Vështruar trendin e tri viteve të fundit, vërehet se edhe të hyrat tatimore dhe jotatimore si të hyra të rregullta buxhetore në vitin 2018 janë rritur për 75,051,000€ në krahasim me një vit më parë, ndërkaq të hyrat e vitit 2017 ishin rritur për 85,093,000€ në krahasim me vitin 2016. Pra, gjatë vitit 2018 shihet një rritje e të hyrave prej 4.4%, përkatësisht 5.3% në krahasim me vitin 2017.

2.1.1 Analiza e të hyrave sipas kategorive ekonomike

Burimet kryesore për financimin e buxhetit janë tatimet (direkte dhe indirekte) dhe të hyrat jo tatimore. Pasqyra më poshtë ofron informata më të plota për buxhetin final dhe trendet buxhetore gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 6 - Pasqyra e Buxhetit dhe Pranimeve sipas burimeve (në euro)

Pranimet	Buxheti fillestar 2018	Buxheti final 2018	Realizimi 2018	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Tatimet direkte	267,040,000	267,040,000	267,504,000	238,034,000	232,121,000
Tatimet indirekte	1,378,385,000	1,378,385,000	1,344,130,000	1,315,236,000	1,227,392,000
Kthimet tatimore	(46,000,000)	(46,000,000)	(47,880,000)	(57,583,000)	(38,381,000)
Të hyrat nga borxhi tatimor	8,000,000	8,000,000	0	0	0
Të hyrat jotatimore	202,000,000	202,000,000	192,865,000	185,881,000	175,343,000
Financimi nga Huamarrja	216,814,000	216,814,000	122,018,000	211,934,000	154,412,000
Grantet dhe ndihmat ²	19,000,000	19,000,000	8,319,000	8,312,000	8,735,000
Pranimet tjera ³	132,500,000	144,090,000	122,717,000	21,547,000	18,286,000
Gjithsej:	2,177,739,000	2,189,329,000	2,009,673,000	1,923,360,000	1,777,908,000

Tatimet direkte

Kjo kategori tatimesh përbëhet nga këto burime: Tatimi në të ardhura të korporatave, Tatimi në të ardhura personale, Tatimi në pronë, si dhe të hyrat nga gjobat e ATK-së. Inkasimi i tatimeve direkte ishte realizuar mbi nivelin e buxhetit përfundimtar në shumë prej 464,000€, apo rreth 0.2%.

Zëri kryesor në këtë kategori tatimesh është Tatimi në të ardhura personale me 152,820,000€ (57%), Tatimi në të ardhura të korporatave 86,797,000€ (32%), Tatimi në pronë 24,196,000€ (9%) dhe tatimet tjera 3,692,000€ apo rreth 2%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ndërsa tatimi në pronë nga Komunat. Krahasuar me vitin paraprak, tatimet direkte në masën e përgjithshme kanë shënuar rritje për 12%, përkatësisht 15% krahasuar me vitin 2016.

² Në shumën e realizimit 8,479,000 janë përfshirë edhe pagesat nga palët e treta prej 178,000€.

³ Në totalin e realizimit prej 122,717,000 janë përfshirë: Fondi i depozitave (3,612,000), Kthimet e kredive nga Ndërmarrjet publike (10,876,000), Të hyrat e dedikuara (10,493,000); Financimi i njëhershëm i AKP-së (86,146,000); Të hyrat e njëhershme të Trustit Pensional të Kosovës (11,590,000).

Si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe i efikasitetit të ATK-së, gjatë vitit 2018 kishte një rritje të inkasimit në Tatimin e të ardhurave të korporatave prej mbi 11 milionë apo 15% në krahasim me vitin paraprak.

Tatimet indirekte

Tatimi në Vlerën e Shtuar, Detyrimi doganor dhe Akcizat, janë tri kategoritë kryesore të tatimeve indirekte, të cilat janë edhe burimet kryesore për mbushjen e arkës shtetërore. Në strukturën totale të pranimeve, tatimet indirekte participojnë me 66.4%. Buxheti total i parashikuar për këtë kategori të hyrash ishte realizuar 97.5%. Totali i inkasimeve në krahasim me një vit më parë, ishte rritur për 29 milionë apo rreth 2%. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 799,020,000€ (59.4%), me një rritje prej 5.7% në krahasim me 2017, Akcizat 418,903,000€ ose 31.1% , me një rënie prej 3%, Tatimit doganor prej 123,747,000€ ose rreth 9.2% dhe pjesa tjetër e tatimeve indirekte ishte 2,460,000€ ose 0.3%.

Kthimet tatimore

Shuma e kthimit të tatimeve deri në fund të vitit ishte 47,880,485€ apo 3.6% të totalit të përgjithshëm të tatimeve të inkasuara.

Pjesa dërmuese e shumave të kthyera të tatimeve direkte dhe indirekte ka të bëjë me: kthimi i TVSH-së së brendshme 39,613,731€, kthimi i akcizës 3,410,461€, kthimi i TVSH-së kufitare 472,404€, kthimi i tatimit në korporata 2,278,775€, dhe llojet tjera të kthimeve 2,105,114€.

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të ngarkesave jo adekuate me tatime, dhe me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganën, përlllogariten diferencat, dhe ngarkesat e tepërta u kthehen subjekteve të ndryshme. Planifikimi i kthimeve tatimore me buxhetin përfundimtar ishte përafërsisht real me gjendjen aktuale të kthimeve, dhe në fund të vitit shuma totale e kthimeve kishte rezultuar me një diferencë prej 1.8 milionë më shumë seç ishte planifikuar.

Planifikimi i kthimeve tatimore ka shënuar një përmirësim, dhe shuma e kthimeve tatimore gjatë vitit 2018 ishte për 9.7 milionë më e vogël se një vit më parë apo 20%.

Performanca buxhetore e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore janë dy agjencitë kryesore për mbledhjen e tatimeve direkte dhe indirekte, si: taksa doganore, akcizat, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në të ardhura personale, TVSH-ja dhe tjera. Tatimi në pronë ndonëse është kategori tatimore, nuk realizohet prej këtyre dy agjencive, por mbledhja e këtij tatimi bëhet përmes komunave.

Të hyrat e planifikuara të DK për vitin 2018 ishin 1,175,000,000€, ndërsa të hyrat e realizuara bruto ishin 1,135,015,816€. Kur kësaj shume i zbriten kthimet tatimore 4,231,318, del se të hyrat e realizuara neto janë 1,130,784,498€, me një shkallë të realizimit të planit prej 96%. Vetëm nga Akciza, TVSH në kufi dhe Dogana në import, janë realizuar rreth 1.12 miliardë euro apo 98% të të gjitha të hyrave doganore. Përkundër përmirësimeve të vazhdueshme , procesi i menaxhimit të të hyrave në Doganë në disa raste është përcjellë me mangësi që kanë të bëjnë me kalkulimin e bazës

doganore dhe mos aplikimin e çmimeve uniforme me rastin e rivlerësimit të mallrave për qëllime tatimore.

Të hyrat e planifikuara të ATK-së për vitin 2018, ishin 446,000,000€, ndërsa në shumën bruto ishin realizuar 468,388,976€, duke përfshirë edhe të hyrat e njëhershme nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) në vlerë prej 11.6 milionë euro. Nga kjo shumë, kthimet tatimore gjatë vitit ishin 43,649,167, dhe shuma neto e të hyrave mbetet 424,739,809€, duke përfshirë të hyrat nga FKPK. Për efektet neto të buxhetit, plani ishte realizuar 95%.

Përgjithësisht performanca e të hyrave të realizuara është mjaft e mirë. Me gjithë shkallën e kënaqshme të përmbushjes së planit në realizimin e të hyrave, procesi i mbledhjes dhe menaxhimi i të hyrave në ATK, në raste të caktuara është përcjellë me mangësi. Nga 2,087 kontrollet e planifikuara për vitin 2018, ishin realizuar 1,714 prej tyre, apo 82% nga numri i planifikuar. Më tej, sipas të dhënave të ATK-së, numri i përgjithshëm i bizneseve që ushtrojnë aktivitete biznesore është gjithsej 63,025. Prej tyre, biznese të fiskalizuara janë 23,271 dhe të pa fiskalizuara 39,754. Numri i bizneseve të cilat nuk kërkohet të fiskalizohen është 18,580. Nga kjo del se numri i bizneseve që duhet të fiskalizohen, e që nuk janë fiskalizuar është 21,174 sish.

Nga analizat më lart del se këto dy agjenci, buxhetit të shtetit i kanë sjellë të hyra neto në shumë totale prej 1,555,524,307€ apo i kanë mbuluar pagesat shtetërore në nivelin prej 78.6%.

Të Hyrat jo tatimore

Në grupin e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë: të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, të gjitha llojet e gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Këto të hyra mblidhen edhe nga subjektet e qeverisjes qendrore, edhe te ato lokale. Shuma totale e mbledhur e të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2018 ishte 192,865,000€ prej 202,000,000 sa ishte plani buxhetor. Prej tyre, shuma e mbledhur nga subjektet e Qeverisjes Qendrore 110,398,000€, nga Qeverisja Lokale 46,350,000€, nga Rentat minerare 25,233,000€, nga Taksat koncesionare 8,792,000€, dhe Të hyrat nga interesi i kedive për Ndërmarrjet Publike 2,092,000€

Plani buxhetor për të hyrat jo tatimore ishte realizuar 95.5%.

Krahasuar trendin e tri viteve të fundit, shihet se të hyrat jo tatimore janë rritur për 3.7% krahasuar me vitin 2017, përkatësisht 10% krahasuar me vitin 2016.

Mos shpalosja e të hyrave jo tatimore për organizatat buxhetore të nivelit qendror

Sipas Pasqyrave vjetore financiare të Qeverisë për vitin 2018, Të hyrat jo tatimore, Taksat, ngarkesa dhe tjera, nga OB-të e Qeverisjes Qendrore janë prezantuar në vlerë 110,398,000€, që paraqet një rritje për 6,953,000€, apo 6.7% në krahasim me vitin e kaluar. Shpalosja është bërë sipas llojit të të hyrës në përputhje me Statistikat Financiare Qeveritare (SFQ), dhe jo sipas shumave për secilën OB mbi bazën e të cilës është planifikuar buxheti.

Planifikimi i këtyre të hyrave deri tash kryesisht është bërë në bazë të dhënave historike dhe pritjeve në shuma totale, por jo në plane detale sipas organizatave buxhetore veç e veç. Organizatat

buxhetore në mungesë të një plani të hollësishëm në lidhje me realizmin e të hyrave, hasin në vështirësi në procesin e matjes së performancës kundrejt planifikimit, dhe në mungesë të dhënave të planifikuara, kanë prezantuar të dhëna jo të sakta dhe të plota në PVF individuale.

Taksa, ngarkesa dhe të tjera në nivele të organizatave buxhetore e Qeverisë Lokale

Të hyrat jo tatimore - taksa ngarkesa tjera niveli lokale kanë të bëjnë me : taksë komunale për leje ndërtimore, taksë për regjistrim të automjeteve, taksë për ndërrimin e destinimit të tokës, taksë për regjistrim të trashëgimisë, leje mjedisore komunale, licenca për aktivitete individuale të lira, licenca për regjistrim të bizneseve etj.

Plani buxhetor për të hyrat jo tatimore në nivelin lokal ishte në vlerë 55,000,000€, prej të cilave ishin realizuar 46,350,000€ apo 84%. Përqindja e realizmit të buxhetit në 31 komuna ishte nën 90%. Komunitat me performancë më të dobët në realizmin e planit të të hyrave ishin: Zveçani 9%, Leposaviqit 17%, Zubin Potoku 29%, Rahoveci 43%, Ranillug 49%, Deçan 54%, Viti 56%, Vushtrri 57%, dhe Podujeva 59%.

Çështjet më sfiduese në këtë fushë janë: mangësitë në procesin e planifikimit të të hyrave, shfrytëzimi i pronave me kontrata të skaduar, shfrytëzimi i pronave komunale pa kompensim, vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore, qarkullimi i fondeve nga të hyrat jashtë Llogarisë së Vetme të Thesarit (LVTH), regjistrimi në kode ekonomike jo përkatëse, si dhe mangësitë ligjore në dhënie në shfrytëzim të pronës publike.

Huamarrja e jashtme dhe e brendshme

Si burim për financimin e nevojave buxhetore, Qeveria ka marrë edhe borxhe të brendshme dhe të jashtme. Shuma e huamarrjeve gjatë vitit 2018 ishte realizuar 122,018,000€, prej të cilave: 102,434,000€ janë borxhe të brendshme, 11,334,000€ janë huamarrje e jashtme dhe 8,250,000€ pranime nga nënhuazimet për pagesën e kësteve të këtyre kredive. Qëllimi i huamarrjeve është mbulimi i deficiteve buxhetore dhe financimi i projekteve kapitale.

Sipas buxhetit përfundimtar, shuma e planifikuar e huamarrjeve ishte 216,814,000€, ndërkaq janë realizuar 122,018,000€ apo 56.3%. Krahasuar me dy vitet më parë, huamarrja ka një rënie për 73% krahasuar me 2017, dhe 26.5% në krahasim me vitin 2016.

Në seksionet vijuese të raportit, kjo pjesë do të shtjellohet më hollësisht.

Grantet e përcaktuara të donatorëve

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes Qeverisë dhe dhuruesve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme. Në këtë kategori nuk bëjnë pjesë pagesat nga palët e treta.

Shuma e granteve sipas Buxhetit përfundimtar ishte 12,000,000€, ndërsa prej tyre ishin pranuar vetëm 8,319,000€ apo 69%. Shuma përafërsisht të njëjta ishin pranuar edhe në dy vitet paraprake -

8,312,000€ në vitin 2017 dhe 8,735,000 në vitin 2016. Mos shfrytëzimi i këtyre fondeve me kohë dhe në mënyrë efikase, rritë rrezikun që grantet në të ardhmen të zvogëlohen.

Pranimet tjera

Shuma e pranimeve tjera me buxhet final ishte parashikuar 144,090,000€, ndërsa ishin realizuar 122,717,000€ apo 85%. Këtë shumë e përbëjnë: Fondi i depozitave 3,612,000€, Kthimi i kredive nga Ndërmarrjet publike (KEK) 10,876,000€, të Hyrat e dedikuara 10,493,000€ (AKP 6,494,000€ dhe Agjencia e Shërbimit të Navigimit Ajror 3,999,000€); Të hyrat e njehershme të AKP-së 86,146,000€; dhe Të hyrat e njehershme të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës 11,590,000€.

2.1.2 Realizimi i të hyrave buxhetore - struktura e të hyrave

Nga analiza më sipër shihet se të hyrat tatimore direkte dhe indirekte janë burimet kryesore për arkën shtetërore dhe përbëjnë 78% të të hyrave të tërësishme buxhetore. Këto të hyra tatimore realizohen përmes Doganës së Kosovës (DK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Këto dy agjenci në vitin 2018 kanë shënuar performancë të mirë sa i përket përmbushjes së planit në realizimin e të hyrave.

Në vitin 2018 të hyrat nga tatimet direkte dhe indirekte të planifikuara ishin 1,645,425,000€ ndërsa ishin realizuar në shumën prej 1,611,634,000€, me një realizim të planit prej 98%. Në këtë performancë të mirë ka ndikuar: rritja e shpenzimeve dhe konsumit publik, rritja e importeve në funksion të mbështetjes së aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, por edhe si rezultat i monitorimit më të mirë doganor, efekti nga masat e reja për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, lehtësimet me rastin e importeve për sektorin e prodhimit, planet për ngushtimin e hendekut tatimor dhe ekonomisë jo-formale, masat për avancimin në efikasitetin e mbledhjes së të hyrave nga agjencitë mbledhëse, përmes thjeshtësimit të sistemit tatimor dhe doganor.

Realizimi i planit pothuajse në përqindje maksimale në mbledhjen e të hyrave, është një tregues se kemi të bëjmë me parashikim të besueshëm dhe objektiv të projeksioneve afatmesme të të hyrave buxhetore dhe efikasitet të mirë në mbledhjen e të hyrave.

Të hyrat jo tatimore mbledhen nga Qeveria dhe Komunitat. Shuma totale e mbledhur e të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2018 ishte 192,865,000€. Prej tyre: 110,398,000€ është shuma e mbledhur nga subjektet e Qeverisjes Qendrore, 46,350,000€ nga Qeverisja Lokale, Taksa koncesionare 8,792,000€, Rentat minerare 25,233,000€, dhe të Hyrat nga interesi (ndërmarrjet publike) 2,092,000€. Rritja e të hyrave jotatimore në vitin 2018 në raport me vitin paraprak ishte rreth 3.8%, ndërsa financimi i shpenzimeve të tërësishme buxhetore nga ky burim është 9.7%.

Nga të hyrat tatimore dhe jo tatimore, mbulimi i shpenzimeve buxhetore ishte në shkallën prej 91%.

2.1.3 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2018 të planifikuara sipas buxhetit final ishin 2,195,859,000€, ndërsa shkalla e ekzekutimit ishte 1,979,559,000€ apo 90% e shumës së planifikuar. Përqindja e shpenzimeve në raport me vitin e kaluar ishte më e ultë për 4.6%, por në vlerë nominale shpenzimet e vitit 2018 janë për 142,755,000€ më të larta se në vitin 2017 dhe 216,315,000€ se ato në vitin 2016.


Sipas Ligjit Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, shpenzimet sipas buxhetit fillestar ishin planifikuar në vlerë 2,158,645,000€, kurse me buxhet përfundimtar ato ishin rritur në 2,195,859,000€ apo për 37,214,000€.

Tabela në vazhdim paraqet trendin e shpenzimeve gjatë tri viteve të fundit sipas kategorive ekonomike.

Tabela 7 - Pasqyra e Buxhetit dhe Shpenzimeve sipas kategorive (në euro)

Shpenzimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2018	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Pagat dhe Shtesat	590,077,000	600,202,000	592,588,000	550,749,000	544,831,000
Mallrat dhe Shërbimet	237,586,000	261,353,000	229,057,000	204,161,000	183,050,000
Shërbimet komunale	27,653,000	25,896,000	23,440,000	24,158,000	23,362,000
Subvencione dhe Transfere	525,984,000	568,475,000	558,778,000	508,316,000	475,103,000
Investime kapitale	694,380,000	673,547,000	533,064,000	471,098,000	449,147,000
Pagesat tjera ⁴	82,965,000	66,386,000	42,631,000	78,322,000	87,751,000
Gjithsej:	2,158,645,000	2,195,859,000	1,979,559,000	1,836,804,000	1,763,244,000

Pasqyra e Buxhetit dhe Shpenzimeve sipas kategorive (në '000 euro)



⁴ Shuma e realizimit përfshinë Kthimin e borxheve (40,741,000€) dhe Kthimet nga Fondet e depozitave (1,890,000€).

Nga të dhënat në tabelë shihet se shumata e buxhetuara për shpenzime, kundrejt shpenzimeve faktike kanë një diferencë mjaft të theksuar. Shpenzimet e realizuara në krahasim me planin buxhetor janë 90% nga shumata e planifikuar. Në shpenzimet aktuale të buxhetit, nuk janë përfshi pagesat e kryera nga palët e treta në shumën prej 178,000€.

Planifikimi i dobët i shpenzimeve vërehet sidomos te Shpenzimet Kapitale, të cilat në raport me buxhetin e planifikuar janë realizuar vetëm 79%, ndonëse në vlerë nominale ato janë rritur për 62 milionë në krahasim me vitin paraprak. Qeveria kishte një plan mjaft ambicioz në rritjen e shpenzimeve në këtë kategori, ngase prej 524 milionë sa ishin planifikuar në vitin 2017, shumata e investimeve ishte rritur në 673 milionë gjatë këtij viti, apo rreth 150 milionë.

Analiza e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ka rezultuar me të dhënat si vijon:

Pagat dhe Mëditjet

Planifikimi i shpenzimeve për paga ishte mjaft i përafërt me shpenzimet aktuale dhe ishte realizuar në shkallën 98.7%. Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, pagat marrin pjesë me 30% dhe përfaqësojnë kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Fondi i shpenzimeve të pagave bruto është rritur përafërsisht 42 milionë apo 7.6% në krahasim me vitin 2017. Kjo rritje është si pasojë e rritjes së numrit të punëtorëve në sektorin publik gjatë vitit 2018 për 1,078 të punësuar të rinj, zbatimit të vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave në disa sektorë qeveritar si dhe pagesa e përvojës së punës.

Me rastin e testimit të pagave, respektivisht vijueshmërisë në punë të punësuarve, ne kemi gjetur se 271 punëtorë të sistemuar në njëmbëdhjetë (11) ministri, janë paguar gjatë tërë vitit në një shumë totale prej 1,294,222€ pa dalur fare në punë. Fjala është për: MASHT (32); MSH (22); MAPL (18); MKK (21); MZHE (18); MAP (20); MTI (26); MMPH (29); MKRS (31); MI (32) dhe MPMS (22). Ky staf ishte shpërndarë nëpër këto ministri si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit në mes Kosovës dhe Serbisë të vitit 2016, por që futja e tyre në listën e pagave ishte bërë para se të krijoheshin kushtet normale për punë. Me çështjen e akomodimit ishte e ngarkuar MAP, e cila kishte kontraktuar me qira tri objekte në tri komunat e veriut të Kosovës, por të cilat për arsye të shumta, asnjëherë nuk janë përdorur për këtë qëllim. Ky problem madje daton që nga viti 2016.

Sa i përket numrit të të punësuarve, sipas Ligjit të Buxhetit nr. 06/L-020, numri i lejuar i stafit në nivelin qendror dhe lokal ishte 84,428, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 80,224. Paga mesatare bruto në sektorin publik për vitin 2018 ishte 615 euro. Rritja mesatare e pagave bruto në krahasim me një vit më parë ishte 35 euro apo 6%.

Mallrat dhe Shërbimet

Vështruar trendin e shpenzimeve në këtë kategori gjatë tri viteve të fundit, shihet se rritja e shpenzimeve është gati konstante dhe sillet në 20 -25 milionë për çdo vit. Për furnizimin me mallra dhe shërbime janë shpenzuar mbi 229 milionë apo 11.6% e buxhetit total. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori, në krahasim me vitin e kaluar ishte rreth 25 milionë apo mbi 12%. Kjo rritje është si rezultat i kërkesave të shtuara për rritjen e fondeve për mirëmbajtjen e projekteve kapitale. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të organizatave buxhetore për rritjen e shpenzimeve në këtë kategori, Qeveria zbaton politika mjaft restriktive në ndarjet buxhetore në këtë fushë.

Subvencionet dhe Transferet

Në totalin e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 28%. Në tri vitet e fundit ka pasur një rritje të shpejtë të këtyre shpenzimeve. Krahasuar me vitin 2017, rritja është 50 milionë apo 10%, kurse në krahasim me vitin 2016 subvencionet janë rritur për 83 milionë apo 17.6%.

Nga shuma totale e subvencioneve prej 558,778,000€, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shpenzuar 433,997,000 apo 77.7%, nga të cilat janë financuar të gjitha skemat (pensionet, skemat sociale, etj). Ndikimin vendimtar në rritjen e shpenzimeve në këtë kategori e kanë pasur pensionet për veteranët e luftës dhe pensionet në baza kontributdhënëse. Pjesa tjetër e buxhetit për subvencione prej 115 milionë iu është ndarë ministrive tjera dhe komunave për financimin e programeve të ndryshme, si: në fushën e bujqësisë, kulturës, stimulimin e bizneseve dhe veprimtaritë tjera.

Investimet kapitale

Përkundër projeksioneve fillestare të buxhetit ku për investime kapitale ishin ndarë 694 milionë apo 32% të buxhetit total, me ndryshime buxhetore gjatë vitit kjo shumë ishte zvogëluar në 674 milionë apo 30.7%, ndërsa ishte arritur që të shpenzohen vetëm 533 milionë apo 79% e buxhetit final. Në vitin paraprak, buxheti i shpenzuar në këtë kategori ishte dukshëm më i lartë apo 90%. Pra, shihet një rënie në performancën e shpenzimeve. Megjithatë, në vlerë nominale në këtë kategori, 62 milionë janë shpenzuar më shumë se në vitin paraprak.

Përqindjen e ultë të shpenzimeve kapitale e ka ndikuar mosrealizimi i projekteve të parashikuara me klauzolën e investimeve, sipas së cilës ishin buxhetuar 62,127,422€, ndërsa nuk kishte asnjë shpenzim në fund të vitit. Buxheti për investime kapitale ishte realizuar në një përqindje më të lartë tek institucionet qendrore - rreth 82%, ndërsa te komunat ekzekutimi ishte dukshëm më i ultë rreth 73%. Në performancën e dobët të komunave ka ndikuar mos shfrytëzimi i të hyrave vetjake, i cili ishte vetëm 54% në nivel të gjitha komunave. Realizim më të dobët kishte komuna e Prishtinës (38%), Komuna e Prizrenit (62%), Komuna e Gjilanit (75%) e kështu me radhë.

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, dhe shërbimeve tjera publike.

Me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, vërehet një tendencë permanente e Qeverisë që shpenzimet buxhetore në këtë kategori t'i rritë nga viti në vit në mbështetje të kësaj kategorie buxhetore, për shkak se investimet kapitale ndikojnë direkt në rritjen ekonomike kombëtare. Por, për shkak të procedurave të stërzgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve në OSHP, çështjeve të pazgjidhura pronësore, shkalla e ekzekutimit të buxhetit në këtë kategori, vazhdon të mbetet më e ulta për vite me radhë.

Mangësitë më të theksuara të kësaj kategori të shpenzimeve të identifikuar nga raportet individuale të organizatave buxhetore janë:

- Shkalla e ultë e realizimit të buxhetit për investime kapitale (79%);
- Planifikimet joadekuate dhe aprovimet e shpenzimeve si “kapitale”, ndërkohë që të njëjtat nuk përmbushin kriteret të trajtohen si të tilla, për shkak se këto fonde shpenzohen për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, dhënien e subvencioneve apo qëllime tjera;
- Shumica e pagesave përmes vendimeve të të formës së prerë nga procedurat e përmbartimit dhe gjykatat bëhet nga kategoria buxhetore e Investimeve kapitale, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit në kategoritë adekuate të shpenzimeve;
- Planifikimi i pjesshëm i fondeve buxhetore për financimin e projekteve, dhe rrjedhimisht, ndërprerjet dhe vonesat në realizimin me kohë të këtyre projekteve, dhe rifillimi i punimeve pas sigurimit të fondeve shtesë;
- Revidimet e projekteve dhe korrigjimet e mëvonshme të paramasave dhe parallogarive, dhe tejkallimet e punimeve;
- Monitorimi i pamjaftueshëm i kontratave të prokurimit; dhe
- Çertifikimi i pagesave për punët e pa kryera dhe furnizimet e papranuara.

Pagesat tjera

Në këtë kategori pagesash bëjnë pjesë: Pagesat e borxhit 40,741,000€ dhe Kthimet nga fondet e depozitave 1,890,000€, që në total janë 42,631,000€. Pra, këto pagesa janë kryer për servisimin e borxheve të brendshme dhe të jashtme, pagesat me rastin e anëtarësimit në institucione financiare ndërkombëtare dhe kthimi i fondeve të depozitave.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave, duhet të me rastin e përgatitjes së Buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime;
- Ministria e Financave me rastin e hartimit të buxhetit duhet që shpenzimet t'i planifikoj nëpër kategoritë dhe kodet adekuate, dhe të parandalohet mundësia që keq klasifikimet të përsëriten;
- Ministria e Financave në koordinim me komunat të zhvilloj një proces më efikas të monitorimit dhe vlerësimit të planit për grumbullimin e të hyrave, të identifikohen shkaqet që kanë ndikuar në mos përmbushjen e planit dhe të ndërmerren veprime të duhura dhe efikase me qëllim të realizimit të planit; dhe
- Ministria e Financave duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen për të tejkalluar sfidat e identifikuar me qëllim të arritjes së objektivave brenda afateve kohore. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve, është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.

2.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanci i fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: Grantet e Përcaktuara të Donatorëve, Të Hyrat Vetiake të komunave dhe OB-ve tjera të pa shfrytëzuara gjatë vitit 2018 dhe të bartura në vitin 2019, Fondi zhvillimor në mirëbesim, Të hyrat e dedikuara dhe Të hyrat tjera në mirëbesim (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave), dhe Fondet e pa shpërndara.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa dërmuese e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2018 ishte 387,874,000 euro.

Në vazhdim paraqiten të dhënat në detaje.

Tabela 8 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve (në euro)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Banka Qendrore e Kosovës	374,663,000	339,906,000	257,393,000
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	4,514,000	5,047,000	4,125,000
Paraja në tranzit	4,031,000	10,179,000	7,371,000
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	1,074,000	1,045,000	929,000
Para të gatshme (arka)	1,851,000	1,583,000	1,385,000
Kuotat në Institucione Financiare Ndërkombëtare	1,741,000	0	0
Gjithsej paraja e gatshme në fund të vitit	387,874,000	357,760,000	271,203,000
Bilanci i fondeve	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
A. Gjithsej fonde të përcaktuara	86,182,000	65,563,000	58,444,000
Grantet e përcaktuara të donatorëve	8,366,000	6,837,000	7,280,000
Të hyrat vetiake të bartura në vitin 2018	48,240,000	32,880,000	27,156,000
Fondi zhvillimor në mirëbesim	11,437,000	10,321,000	10,058,000
Të hyrat e dedikuara	1,706,000	803,000	841,000
Të hyrat tjera	16,432,000	14,722,000	13,109,000
B. Fonde të pa shpërndara	301,693,000	292,196,000	212,759,000
Gjithsej fondet (A+B)	387,874,000	357,760,000	271,203,000

Bilanci i llogarive në para të gatshme të mbajtura në BQK është rritur dukshëm në krahasim me dy vitet paraprake. Paraja e gatshme në fund të vitit 2018 është rritur për 30,114,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2017 dhe 116,669,000 në krahasim me fundvitin 2016.

Nga tabela shihet se bartja e të hyrave vetiake si të hyra të pa shpenzuara po rritet, dhe fondet e bartura nga viti 2018 janë për 15.4 milionë apo rreth 47% më të larta se shumat e bartura nga viti 2017, dhe 78% më të larta se ato të vitit 2016. Te komunat vërehet një tendencë e përhershme që së pari të shpenzohen fondet e Grantit të përgjithshëm qeveritar, dhe më pas, të hyrat vetiake të bartura.

Me rastin e rishikimeve analitike të Pasqyrave Financiare, nuk kemi gjetur ndonjë mospërputhje në mes të dhënave të prezantuara në Pasqyrën e mësipërme me të dhënat në Librin e përgjithshëm të Thesarit dhe Llogaritë bankare. Rreth 97% e parasë së gatshme gjindet e depozituar në Llogarinë Kryesore të Buxhetit të Republikës së Kosovës në Bankën Qendrore të Kosovës.

2.2.1 Paraja e gatshme dhe paraja në tranzit

Kjo shumë përfaqëson paranë e imët e cila mbahet nga organizatat buxhetore, e të cilat nuk janë shpenzuar as depozituar në llogarinë kryesore në BQK deri më 31.12.2018. Shuma e mbajtur e këtyre parave nga të gjitha organizatat buxhetore është 1,851,000€, ku pjesa më e madhe e tyre ishte evidencuar në MSH (722 mijë), MPJ (498 mijë) dhe AKI (227 mijë). Paratë në tranzit janë para të cilat janë pranuar përmes bankave komerciale si të hyra të vitit 2018, por që në datën 31.12.2018 nuk janë transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK. Shuma e parave në tranzit në fund të vitit është 4,031,000€,

Llogaritë e misioneve diplomatike, në pajtim me LMFPP janë llogari të hapura nga Thesari në bankat komerciale në shtetet ku Qeveria e Republikës së Kosovës ka misionet diplomatike, dhe të cilat mbahen për qëllime të ofrimit të shërbimeve bankare për Ambasadat dhe Konsullatat në këto shtete, sipas kërkesës së MPJ. Gjendja e fondeve në këto llogari për vitin 2018 ishte 1,0474,000€, përafërsisht e ngjashme me shumën e vitit të kaluar.

2.3 Deklarata për kufirin e deficitit buxhetor

Në bazë të nenit 22.A.1 të Ligjit nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 përcaktohet se: “Asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshij një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar”.

Neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- a) kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit, dhe
- b) procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

LMFPP nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime), përfshinë një vlerësim të pajtueshmërisë për kufirin e deficitit buxhetor i cili nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 2% të Bruto Produkti Vendor (BPV) që për vitin 2018 ishte parashikuar në vlerë prej 6,641,600,000€, ndërsa BPV në fund të vitit kishte rezultuar me vlerën prej 6,529,000,000€⁵.

Neni 7 i Ligjit nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 përcakton se: “Për qëllime të përputhshmërisë me kufirin e deficitit, shpenzimet për projektet kapitale të financuara nga jashtë, nga institucionet financiare ndërkombëtare, Bashkimi Evropian apo institucionet e saj, qeveritë e huaja apo agjencitë e tyre të zhvillimit, nuk do të merren parasysh”. Pra, në totalin e shpenzimeve të përjashtuara nga

⁵ Të dhënat për BPV të vitit 2018 janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

rregulla fiskale janë përfshirë shpenzimet e Të Hyrave Vetiake të Bartura, shpenzimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Kthimi i kredive qeveritare të dhëna më herët, dhe pagesat nga donatorët e jashtëm.

Ne kemi vlerësuar proceset në kuadër të MF-së për të siguruar zbatimin e këtyre kërkesave nga ligji lidhur me kufijtë e deficitit buxhetor dhe kemi vlerësuar kufirin aktual në fund vitin 2018. Ligji i buxhetit për vitin 2018 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar me një deficit buxhetor prej 1.7% të BPV-së, derisa deficitin aktual në fund të vitit 2018 ishte 1%.

Pra, Qeveria me rastin e përgatitjes së Projekt Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2018, kishte siguruar që deficitin i planifikuar të jetë brenda kufirit të lejuar me LMFP.

Analiza e deficitit buxhetor

Sipas nenit 46 të LMFP, Ministri duhet t'i dorëzojë Qeverisë Raportin përfundimtar mbi buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore për këto vite lidhur me diskutimin për respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Financimi i deficiteve buxhetore, sipas rregullave fiskale, bëhet nga fondet e huamarrjeve. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta ka hyrë në huamarrje prej 114,677,000€ apo 1.7% të BPV-së së parashikuar. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar shpenzimet të cilat ishin më të larta se të hyrat e planifikuara. Shuma aktuale e deficitit në fund të vitit ishte 66,329,138€ apo rreth 1% e BPV.

Kufiri i deficitit buxhetor në raport me vitin 2017, në vlerë nominale por edhe në përqindje, pothuajse ishte i njëjtë. Deficitin sipas buxhetit fillestar ishte 1.5%, ndërsa ai aktual në fund të vitit 2017 ishte 0.8%. Sa i përket shpalosjes së të dhënave në Tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2018, ne kemi identifikuar mospërputhje në prezantimin e Të Hyrave apo Shpenzimeve dhe përlllogaritjen e deficitit, të cilat janë prezantuar në mënyrë kumulative në tabelën në vijim.

Tabela 9 - Diferencat në përlllogaritjen e deficitit

(në euro)

Nr.	Zërat buxhetor	Sipas buxhetit fillestar RVF	Deficiti i përlllogaritur sipas auditimit	Aktuali në fund të vitit sipas RVF	Aktuali sipas auditimit
1.	Të hyrat e tërësishme	1,828,425,000	1,816,000,000	1,776,000,000	1,768,209,000
2.	Shpenzimet e tërësishme	2,092,481,000	2,103,677,000	1,937,105,000	1,947,021,093
3.	Të përjashtuara nga rregulla fiskale	(141,803,000)	(173,000,000)	(96,373,000)	(112,482,955)
4.	Deficiti i përlllogaritur	(122,253,000)	(114,677,000)	(64,732,000)	(66,329,138)

Siç shihet nga të dhënat më sipër, deficitin i përlllogaritur me buxhetin fillestar sipas Ministrisë së Financave ishte 122,253,000€, ndërsa sipas kalkulimeve tona kjo shumë duhet të jetë 114,677,000€ apo me një diferencë prej 7,576,000€ më pak sesa ishte përlllogaritur nga MF.

Sipas shpalosjeve në pasqyra financiare të Qeverisë, deficitin aktual në fund të vitit ishte 64,732,000€, ndërsa sipas kalkulimeve të auditimit kjo shumë del të jetë 66,329,138€, pra me një diferencë prej 1,597,138€ apo për 2%, për shkak të përfshirjes në RVF të granteve të donatorëve të cilat nuk do të duhej të ishin përfshirë as në pjesën e pranimeve dhe as të shpenzimeve.

Informatat më në detaje lidhur me përllogaritjen e deficitit buxhetor janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 10 - Përllogaritja e deficitit të planifikuar dhe deficitit aktual për vitin 2018 (në euro)

Nr. rend.	Të Hyrat/Shpenzimet buxhetore	Deficiti i planifikuar	Deficiti aktual
A	Pranimet/Të Hyrat e tërësishme (1 deri 5)	1,816,000,000	1,768,209,000
1.	Tatimet direkte	267,000,000	279,094,000
2.	Tatimet indirekte	1,386,000,000	1,344,130,000
3.	Kthimet tatimore	(46,000,000)	(47,880,000)
4.	Të hyrat jo tatimore	202,000,000	192,865,000
5.	Grantet mbështetje buxhetore	7,000,000	0
B	Pagesat/Shpenzimet e tërësishme (6 deri 16)	2,103,677,000	1,947,021,093
6.	Shpenzimet e pagave	590,077,000	591,915,362
7.	Shpenzimet për mallra dhe shërbime	237,586,000	226,761,329
8.	Shpenzimet komunale	27,653,000	23,439,143
9.	Shpenzimet e Subvencioneve/Transfereve	525,984,000	558,043,256
10.	Shpenzimet për Investime kapitale	694,380,000	530,046,003
11.	Rezerva	4,800,000	0
12.	Shpenzimet e interesit	23,197,000	16,816,000
13.	Pagesat nga Të Hyrat Vetiake të bartura nga 2016	0	(19,331,086)
14.	Shpenzimet e AKP dhe Navigacionit Ajror	(11,000,000)	(9,589,773)
15.	Klauzola e investimeve	(62,000,000)	0
16.	E hyra e njëhershme e AKP-së	(100,000,000)	(83,562,096)
C	Deficiti (A minus B)	(114,677,000)	(66,329,138)

Nga kalkulimi i të hyrave janë përjashtuar pranimet si vijon:

1. Të hyrat e dedikuara të AKP-së dhe Navigimit Ajror (9,589,773) pasi që këto të hyra sipas ligjit përkatës krijohen si rezultat i shitjes së pasurive publike, që do të thotë se nuk paraqesin rritje të vlerës neto, por ndryshim në trajtën e pasurive (nga fikse në likuide);
2. Pagesat nga të hyrat e bartura vetjake (19,331,086€) nga viti 2017; dhe
3. Pranimet nga financimi i njëhershëm i AKP-së (83,562,096€) nga perspektiva e sektorit publik, nuk klasifikohen si e hyrë buxhetore, pasi që paraqet ndryshim në llojin e pasurisë, nga ndërmarrja shoqërore në para të gatshme. Si rrjedhojë, edhe klasifikohet vetëm si zë financimi.

3 Analiza e shënimeve shpjeguese

Qeveria dhe OB-të kanë nën kontroll dhe menaxhojnë me fonde publike, si dhe i përdorin këto burime për të arritur objektivat e realizimit të shërbimeve. Megjithatë, Qeveria do të duhej të mbajë evidenca dhe të ketë informatat të hollësishme lidhur me fondet publike të cilat i menaxhon.

BSNKSP inkurajon fuqimisht që t'i përmbahemi shpalosjes së informatave shtesë, aty ku është e mundshme, në mënyrë që të ngritet transparenca dhe përgjegjësia financiare. Shpalosja e informatave të përshtatshme në PFV në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Qeverisë, mund të rris transparençën e raporteve financiare dhe të ofroj mundësi për kuptim më të mirë të relacionit ndërmjet aktiviteteve qeveritare dhe palëve të interesit.

Përmbajtja e shpalosjeve apo shtojcave në PFV duhet të jetë e qartë dhe të ofroj informacion të mjaftueshëm dhe cilësor për të gjithë zërat e pasqyrave në mënyrë që shfrytëzuesit e PFV-ve t'i kuptojnë më mirë fushat e raportuara, përkatësisht trendet vjetore të buxhetit dhe arsyet për ndryshime.

Përgjithësisht, PFV-të përmbajnë shpalosje të shumta, të cilat ofrojnë informacione të hollësishme për përmbajtjen e shifrave në tri Pasqyrat kryesore. Por, konkluzioni ynë është se nuk është i mjaftueshëm vetëm prezantimi në mënyrë analitike i shifrave në këto tri Pasqyra. Megjithëse krahasuar me RVF 2017 shënimet shpjeguese në RVF 2018 janë më të plota, në disa elemente ende ka nevojë të zgjerohen shpjegimet përkatëse, veçanërisht në pjesët ku ndryshimet janë të vështira të kuptohen nga ana e përdoruesve.

3.1 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë

Procesi i auditimit të organizatave buxhetore ka nxjerrë në pah një sërë mospërputhjesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të Qeverisë. Kjo për shkak se disa prej OB-ve nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra në pasqyrat e tyre financiare, të cilët janë kryesisht pjesë e shpalosjeve. Thesari ka bërë konsolidimin e të dhënave ashtu siç është raportuar nga organizatat individuale. Mangësitë në shifrat e konsoliduara, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:

- Në pasqyrën e shpalosjeve në PVF, pasuria është prezantuar në vlerë prej 8,438,486,497€, ndërsa sipas auditimeve individuale, pasuria kapitale mbi 1,000€ ka rezultuar të jetë 8,450,478,443€, me një mospërputhje apo një nënvlerësim prej 11,991,946€. Kjo diferencë mbetet pas thyerjeve të saldove, për shkak se disa organizata kanë pasuri më shumë sesa i kanë paraqitur në pasqyra, dhe të tjerat kanë prezantuar të dhëna të mangëta mbi gjendjen e pasurive;
- Pasuria e prezantuar nën 1,000€ në pasqyrën e shpalosjeve është në vlerë 40,439,013€, ndërsa sipas auditimeve individuale, totali i pasurive është 34,771,041€, me një diferencë prej 5,667,972€. Pra, siç shihet, në të njëjtën vlerë kishte një mbivlerësim të pasurive, i cili te organizatat e nivelit qendror ishte 5,438,0750€ dhe te komunat 229,897€. Për informata në detaje lidhur me pasuritë, referoju kapitullit 4 të këtij raporti;

- Stoqet në pasqyrën e shpalosjeve në RVF të BRK-së ishin në vlerë 21,134,354€, ndërsa sipas auditimeve individuale kjo vlerë rezultoi 20,499,952€. Saldo e stoqeve të institucionet qendrore në PVF ishte 19,547,747€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë është 18,788,225€ apo ishte mbivlerësuar për 759,522€. Ndërsa te komunat, vlera totale e stoqeve në pasqyra ishte 1,586,607€, kurse sipas auditimit 1,711,727€ apo ishte nënvlerësuar për 125,120€;
- Obligimet e papaguara në nivel vendi, në pasqyrën e shpalosjeve janë prezantuar në shumën prej 258,792,000€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit vlera totale e obligimeve të papaguara ishte 259,137,000€. Pra ekziston një nënvlerësim i obligimeve prej 345,000€;
- Gjendja e detyrimeve kontingjente në RVF është paraqitur në total 196,824,000€, ndërsa vlera e këtyre detyrimeve sipas auditimit ishte 207,318,000€, apo 10,494,000€ më e madhe. Për të njëjtën shumë, gjendja faktike e këtyre detyrimeve ishte nënvlerësuar në pasqyra financiare; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme ishin prezantuar në saldon prej 631,702,606€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit, vlera totale e llogarive të arkëtueshme ishte 634,131,000€, me një nënvlerësim prej 2,428,394€. Vlera e prezantuar në RVF 2018 për nivelin qendror është 462,008,000€, e cila gjatë auditimit ka rezultuar të jetë e nënvlerësuar për 270,000€, meqë kjo shifër duhej të paraqitet në vlerë 462,278,000€, ndërsa sipas raportit të konsoliduar financiar, bilanci i të arkëtueshmeve në 34 komuna⁶ ishte 169,694,000€, kurse sipas auditimit kjo shumë ishte 171,853,000€ apo ishte nënvlerësuar për 2,159,000€.

3.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi

Ministria e Financave, në emër të Qeverisë përgatit Pasqyrat financiare vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës në pajtim me LMFP Nr. 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 03/L-221, Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194, Ligjin 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007, si dhe në bazë të SNKSP - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit të Qeverisë është LMFP dhe SNKSP sipas parimit të parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë.

Sipas parimit kontabël të parasë së gatshme, Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur paratë janë transferuar në llogari të Thesarit, janë pranuar në banka komerciale apo janë në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit, dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e organizatave buxhetore në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato dalin nga Llogaria e Vetme e Thesarit, kurse shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve për udhëtime zyrtare, njihen në momentin e arsyetimit të llogarisë së parave të imëta dhe udhëtimit zyrtar.

⁶ Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku nuk kanë raportuar për llogaritë e arkëtueshme, meqë nuk aplikojnë tatimin në pronë apo ngarkesa tjera të cilat krijojnë të arkëtueshme. Vlenë të përmendet se tatimi në pronë buxhetohet vit pas viti për t'u inkasuar nga këto komuna, por ende nuk zbatohet ndonjë masë konkrete në këtë drejtim.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së Vetme të Thesarit. Llogaria e Vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari në Ministrinë e Financave.

Thesari është i autorizuar që të ekzekutoj edhe pagesat e faturave dhe kërkesave për pagesë sipas nenit 39.2 të LMFP-së dhe vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore sipas nenit 40 të LMFP-së. Pagesat e tilla janë bërë nga kategoritë e ndryshme nga fondet të cilat kanë qenë në dispozicion, gjegjësisht të lira për shlyerjen e obligimit konform kërkesave të LMFP-së.

LMFP ka disa kërkesa shtesë për prezantim të pasurive jo financiare dhe detyrimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në pajtim me Pjesën 2 të SNKSP në bazë të parasë së gatshme.

Pasuritë e prezantuara në aneksin 6 janë bazuar në shënimet e SIMFK, dhe përfshijnë pasuritë në vlerë mbi 1,000 euro në pajtim me Rregulloren Financiare 02/2013. Lista e pasurive jo financiare është paraqitur në vlerën kontabël neto, pas zbatimit të normave të zhvlerësimit sipas kësaj rregulloreje.

Raporti përmban shpalosje të informatave edhe për llogari tjera, të cilat janë paraqitur në anekset:

(7 dhe 8) Pasuritë me vlerë mbi dhe nën 1,000 euro; (9) Stoqet; (10) Të arkëtueshmet; (11 dhe 12) Detyrimet; (16) Numri i të punësuarve jashtë listës së pagave; (17) Numri i të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta.

Transaksionet ndërmjet organizatave buxhetore, të quajtura “Transaksionet ndërdepartamentale” nuk janë konsoliduar në këto pasqyra financiare, me qëllim që të ruhet konsistenca e informatave të raportuara me pasqyrat financiare individuale të organizatave buxhetore. Shpenzimet janë kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të Ligjit të Buxhetit, i bazuar në Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së (SFQ) që janë version i SFQ i vitit 2014 të bazuara në paranë e gatshme.

Pagesat e bëra nga palët e treta nuk konsiderohen pranime ose pagesa në para të gatshme, por janë përfitime të Qeverisë. Këto pagesa shpalosen në shtyllën Pagesat nga palët e treta të Pasqyrës së konsoliduar të pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, banka komerciale, si dhe paratë e gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentet e parasë së gatshme.

Valuta raportuese është Euro (€), ndërsa shpalosja e borxhit shtetëror është paraqitur në aneksin 20. Të dhëna të detajuara rreth Borxhit Shtetëror janë prezantuar në Buletinin 2018, i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave

PFV autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit dhe pas aprovimit në Qeveri.


3.3 Borxhet publike dhe Garancitë shtetërore

Borxhet e përgjithshme shtetërore apo publike përbëhen prej borxheve të jashtme, borxheve të brendshme, por për nevoja të përlogaritjes së borxhit të përgjithshëm kundrejt BPV, në kategorinë e borxheve konsiderohen edhe garancitë shtetërore. Si burim i financimit buxhetor, këto huamarrje merren me qëllim të mbulimit të deficiteve buxhetore dhe për nevoja të financimit të projekteve kapitale. Kosova ka marrë borxhe të jashtme që nga viti 2009, ndërsa nga viti 2012, huamarrja bëhet edhe nga burimet e brendshme.

Në fund të vitit 2018 Borxhi i Përgjithshëm ka arrit në vlerën rreth 1,093 milionë euro që krahasuar me vitin paraprak ka një rritje prej 9.7%. Në këtë vlerë nuk janë të përfshira garancitë shtetërore prej 44 milionë euro. Tabela në vazhdim paraqet trendin e borxhit në tri vitet e fundit.

Tabela 11 - Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm shtetëror (në euro)

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Borxhi Ndërkombëtar	416,150,000	422,150,000	373,770,000
Borxhi i Brendshëm	676,620,000	574,270,000	478,970,000
Borxhi i Përgjithshëm	1,092,770,000	996,420,000	852,740,000
Garancitë Shtetërore	44,000,000	44,000,000	20,000,000
Borxhi i përgjithshëm + Garancitë	1,136,770,000	1,040,420,000	872,740,000
Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV)	17.12%	16.63%	14.58%
BPV nga ASK	6,641,600,000	6,257,000,000	5,985,000,000



Qeveria për vitin 2018 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve publike, ku në këtë vit borxhi publik në raport me Bruto Prodhimin Vendor ishte 17.12%. Sipas Ligji për Borxhet Publike është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind (40%) të Bruto Prodhimit Vendor (BPV).

Të dhënat në tabelë tregojnë se pjesa më e madhe e borxheve (61.9%) janë nga huamarrja e brendshme, ndërsa borxhet e jashtme marrin pjesë me një përqindje më të ultë (38.1%). Siç shihet, në raport me vitin e kaluar, borxhi i jashtëm është zvogëluar për 6 milionë si rezultat i kthimit të kësteve dhe tërheqjeve në shuma të vogla për projektet e ratifikuara, ndërkaq borxhet e brendshme kanë pasur një rritje prej më shumë se 102 milionë euro nga emetimet e reja të letrave me vlerë.

Garancitë shtetërore paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara. Në këto raste, Qeveria duhet të paguaj obligimet për garancionin e dhënë. Nga tabela sipër shihet se Qeveria ka dhënë garancione për 44 milionë euro (dy garancione nga 10 milionë për vitet 2015 dhe 2016, dhe 24 milionë për vitin 2017).

Prej 1,092.77 milionë (duke mos i llogaritur garancitë), 948.06 milionë janë borxhe në valutën euro dhe 144.71 milionë janë të Drejta Speciale të Tirazhit (përbëhet nga shporta e monedhave EUR, USD, GPD, Juani kinez dhe Jeni japonez) dhe SAR (Saudi Riyad). Në vlerën e borxhit të përgjithshëm, borxhet me normë të interesit fikse janë 932.6 milionë, ndërsa më normë variabile të interesit 160.1 milionë euro.

Borxhet e jashtme

Në fund të vitit 2018, Borxhi i jashtëm i akumuluar apo ndërkombëtar ishte 416,150,000 euro, apo 38.1% e borxhit të përgjithshëm, ndërsa në raport me BPV shuma e këtij borxhi ishte 6.3%.

Tabela 12 - Borxhi i jashtëm sipas kreditorëve

(në euro)

Kreditori	Borxhi i Ratifikuar	Borxhi i tërhequr	Borxhi i pa tërhequr	Borxhi i pakthyer ⁷	Borxhet e kthyera
	(A)	(B)	(C=A-B)	(D=B-E)	(E)
BNRZH	381,210,000	381,210,000	0	146,980,000	234,230,000
ANZH	148,440,000	49,560,000	98,880,000	49,510,000	50,000
FMN	287,380,000	287,380,000	0	160,140,000	124,130,000
KfW	71,000,000	68,260,000	2,740,000	48,910,000	19,360,000
UniCredit	7,040,000	7,040,000	0	7,040,000	0
FOZHN, BIZH, SFZH	46,830,000	3,570,000	43,260,000	3,570,000	0
BERZH	139,900,000	0	139,900,000	0	0
EIB	42,000,000	0	42,000,000	0	0
NATIXIS Franca	66,000,000	0	66,000,000	0	0
Borxhi i jashtëm	1,189,800,000	797,020,000	392,780,000	416,150,000	377,770,000

⁷ Diferenca te Borxhi i pakthyer ndryshon varësisht nga kursi i këmbimit në datën e raportimit, për kreditë të cilat janë në valuta jo-Euro.

Borxhi i jashtëm merret përmes kredive bankare nga Institucionet e jashtme financiare, ku si kreditorë kryesor deri tani ishte BNRZH, ANZH, BERZH dhe FMN me rreth 956.9 milionë euro.

Nga borxhi i jashtëm i ratifikuar nga viti 2009 deri më 2018 në vlerë 1,189.8 milionë euro, shteti ka tërhequr 797 milionë euro, duke përfshirë edhe Kredinë e konsoliduar C nga ish Jugosllavia, si pjesë e Borxhit shtetëror të Kosovës, prej të cilave deri në fund të vitit 2018 i ka kthyer 377.7 milionë euro. Pjesa më e madhe e kthimit të kredisë është bërë për Kredinë e konsoliduar C në vlerë 234 milion apo 62% e vlerës së kthyer dhe FMN në vlerën 124 milion apo 33%.

Vlera e pa tërhequr nga marrëveshjet e kredive të ratifikuara mbetet në vlerën 392.8 milion euro apo 33% e borxhit të ratifikuar.

Gjatë vitit 2018 ishin nënshkruar shtatë (7) marrëveshje, ku prej tyre vetëm dy janë ratifikuar në vitin 2018. Prej marrëveshjeve të ratifikuara janë Projekti për Autostradën Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq në vlerë 80 milionë euro, si dhe marrëveshja për projektin e ekonomisë digjitale të Kosovës në vlerë 20.7 milionë.

Borxhet e brendshme

Në fund të vitit 2018, borxhi i brendshëm i akumuluar ishte 676,620,000 euro apo 61.9% e borxhit të përgjithshëm, ndërsa në raport me BPV ishte 10.18%.

Vlera e emetuar gjatë viti 2018 ka shërbyer për ri financimin e instrumenteve që maturohen në vitin 2018 në vlerën 319.95 milionë dhe instrumentet e reja të planifikuara me Ligjin e buxhetit 2018 në vlerë 102 milionë euro.

Tabela 13 - Borxhet e brendshme në tri vitet e fundit

(në euro)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Emetimet e Reja	102,430,000	95,300,000	101,190,000
Stoku i Borxhit të brendshëm	676,620,000	574,270,000	478,970,000
Borxhi i Brendshëm (% e BPV-së)	10.18%	9.18%	8.00%
BPV	6,641,600,000	6,257,000,000	5,985,000,000

Shërbimi i borxheve të brendshme dhe të jashtme

Kthimet e borxhit të jashtëm dhe të brendshëm për vitin 2018 ishin 41 milionë euro. Prej tyre, për borxhin e jashtëm ishin 34.3 milion ndërsa për borxhin e brendshëm ishte 6.7 milion euro. Tabela në vazhdim prezanton të dhëna për kthimin e borxheve të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë kthimin e kryegjësë, shpenzimet e interesit, tarifatat zotuese dhe tarifatat tjera si pjesë e borxhit.

Tabela 14 - Shërbimet e borxhit të jashtëm dhe të brendshëm për vitin 2018 (në euro)

Kthimi i borxheve	Kryegjëja	Interesi i paguar	Tarifat zotuese	Tarifat tjera	Gjithsej pagesat
Borxhi i jashtëm	22,030,000	12,010,000	290,000	0	34,330,000
Borxhi i brendshëm	0	6,690,000	0	0	6,690,000
Totali:	22,030,000	18,700,000	290,000	0	41,020,000

Vlen të theksohet se për kreditë e ratifikuara që nga viti 2009 deri më 2018, e të cilat ende nuk janë tërhequr nga Qeveria, përkatësisht njësitë zbatuese të projekteve, për vitin 2018 janë paguar tarifa të zotimit 290,000 euro.

Garancitë shtetërore

Për qëllime të përlogaritjes së borxhit të përgjithshëm dhe për të përcaktuar kufirin e borxhit të tillë, Garancitë Shtetërore dhe Komunale trajtohen si borxh. Në fund të vitit 2018, vlera e garancive të dhëna shtetërore ishte 44 milionë euro.

Konkluzionet e auditimit

Në mungesë të përgatitjeve të duhura për fillimin e ekzekutimit të projekteve, vlera e pa tërhequr e kredive të ratifikuara deri në fund të vitit 2018 ishte 393 milionë euro, duke rezultuar që fondet e huamarrjeve të mos shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Shkak i kësaj ishte se aranzhimet për huamarrje kanë ndodhur shumë kohë para se të krijohen kushtet për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

Prej marrëveshjeve të ratifikuara, për 11⁸ projekte në vlerë 393 milionë euro nuk janë tërhequr fondet kreditore. Fondet e pa shpenzuara kanë të bëjnë me Projektet e pa realizuara si në vijim:

- Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale, zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës, 29 milionë euro;
- Projekti i Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10, zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës dhe Infrakos, 42 milionë;
- Projekti për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit, zbatuese e projektit ishte Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe NP Ibër - Lepenci, 7 milionë;
- Projekti për trajtimin e ujërave të zeza, zbatuese e projektit ishte Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 66 milionë;
- Projekti i rrugës 6 nga Kijeva në Pejë, zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës, 80 milionë;
- Projekti për konkurrueshmëri dhe gatishmëri për eksport, zbatuese e projektit ishte Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 14.3 milionë;

⁸ Prej 11 projekteve, dy janë marrëveshje të ratifikuara në vitin 2018, dhe tjerat nga vitet e mëhershme.

- Projekti i ekonomisë digjitale të Kosovës, zbatuese e projektit ishte Ministria e Zhvillimit Ekonomik 20.7 milionë;
- Projekti për financimin shtesë të projektit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ku zbatuese e projektit ishte Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 20.8 milionë;
- Projekti për Autostradën Kijevë-Zahaq, zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës, 71 milionë;
- Rehabilitimi i Rrugëve hekurudhore 10, zbatuese e projektit Infrakos, 39.9 milionë; dhe
- Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në Komuna, zbatuese të projektit komunat: Ferizaj, Prishtina, Gjakova, Gjilani, 2.5 milionë.

Mostërhegja e kredive të ratifikuara kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë të projekteve të cilat do të financoheshin nga huamarrjet, vonesat në themelimin e njësive zbatuese të projekteve, procedurat e ndryshme të prokurimit nga ato të parapara me marrëveshje të kredive etj.

Si rezultat i kësaj, Qeveria e Kosovës është duke paguar tarifë të zotimit për vlerën e mjeteve të zotuara të cilat nuk i ka tërhequr. Për shkak të mospërputhjes së dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, vlera e paguar e tarifave të zotimit për vitin 2018 për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit është 290,000 euro për të gjitha kreditë e ratifikuara deri në vitin 2018.

ZKA edhe në raportin e vitit të kaluar ka adresuar problemin e hyrjes në kredi të Qeverisë, para se të jenë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e projekteve, por praktika e njëjtë ka vazhduar edhe këtë vit, duke u rritur saldo e kredive të pa tërhequra edhe për 97 milionë, nga 296 në 393 milionë.

Rekomandimet për Qeverinë

- Qeveria duhet t'i shqyrtoj arsyet për vonesa në tërheqjen e fondeve dhe të vazhdoj reformat në këtë fushë në mënyrë që përmes ligjit të ri për borxhin shtetëror, të përcaktoj edhe kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim, si dhe mbikëqyrje të nivelit të shfrytëzimit të këtyre fondeve; dhe
- Qeveria duhet të siguroj kapacitete të mjaftueshme të resurseve humane që sigurojnë zbatimin e projekteve të financuara nga huamarrja.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave duhet të vazhdoj me veprimet e marra në adresimin e projekteve që financohen nga huamarrja dhe t'i paraqes dy herë në vit Qeverisë për informim dhe shqyrtim, raport të konsoliduar të progresit të projekteve me huamarrje, duke i identifikuar sfidat përkatëse dhe duke i propozuar edhe masat për tejkalimin e tyre; dhe
- Departamenti i Buxhetit të vazhdoj përkrahjen në zbatimin e këtij rekomandimi përmes hartimit të një udhëzimi administrativ për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale, ndërsa Thesari, para negociimit të huamarrjes, të vazhdoj të aplikoj kërkesën për letër zotuese ndaj të gjitha Ministrive të linjës dhe komunave - zbatuese të projekteve.

4 Pasuritë

Sipas kërkesave ligjore, organizatat buxhetore obligohen të mbajnë të dhëna të sakta dhe të plota të pasurive përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive si pjesë integrale e SIMFK-së me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerave të tyre. Përveç regjistrimeve dhe raportimeve, ato duhet të kujdesen edhe për ruajtjen dhe përdorimin e tyre efektiv.

Rregullorja MF nr. 02/ 2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë dhe vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

Pasuritë e organizatave buxhetore si tërësi ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe që kanë vlerë financiare mbi 1,000€;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, por që kanë vlerë financiare më pak se 1,000€; dhe
- Stoqet ose pajisje rezervë dhe material zyre.

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël të SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MF, ku evidentohen pasuritë që kanë vlerë mbi 1,000 euro, dhe aplikacionit "E - pasuria" që është një sistem i integruar elektronik në kuadër të MAP, ku të gjitha institucionet publike duhet të evidentojnë dhe raportojnë për pasuritë e tyre me vlera nën 1,000€.

Organizatat buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në Pasqyrat e Ministrisë së Financave. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, ne kemi vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Gjetjet kryesore lidhur me raportimin dhe kontrollin e pasurive janë:

Pasuritë e institucioneve qendrore - Me rastin e auditimeve individuale, ka rezultuar se disa organizata për asrye të ndryshme nuk kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në PFV-të e konsoliduara ishte nënvlerësuar për 5,980,553€. Ndërsa, situata e kundërt ishte që disa organizata, kryesisht për shkak të mos llogaritjes së zhvlerësimit vjetor apo gabimeve tjera në regjistrime, pasuritë jo kapitale i kishin mbivlerësuar me rastin e raportimeve në PFV për 5,438,075€.

Tabela në vazhdim paraqet diferencat në mes të dhënave të prezantuara në PFV dhe auditimeve individuale.

Tabela 15 - Gjendja e pasurive në institucionet qendrore

(në euro)

Pasuritë më 31.12.2018	Sipas PFV-ve	Sipas auditimit	Mbivlerësimi/ Nënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)	2,619,095,058	2,625,075,611	5,980,553
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)	27,426,473	21,988,398	5,438,075

Gabimet e identifikuar apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive të raportuara më pak apo më shumë, janë identifikuar në 20 organizata të nivelit qendror, ku bëjnë pjesë: 14 ministri, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi Spitaor Klinik Universitar dhe katër (4) agjenci.

Dobësi tjera në kontrolle të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek Institucionet Qendrore janë:

- Në dhjetë (10) institucione nuk është kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë;
- Në tetë (8) institucione nuk kishte funksionuar sistemi e-pasuria;
- Në shtatë (7) institucione nuk është kryer inventarizimi vjetor apo procesi kishte përfunduar me vonesa në inventarizimin e pasurisë, respektivisht raportet e inventarizimit ishin dorëzuar pas hartimit të pasqyrave financiare; dhe
- Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nuk ka raportuar në MF pasuritë mbi dhe nën 1,000€.

Pasuritë e komunave - Për arsye të njëjta siç u përmendën më lartë, edhe te komunat pasuria kapitale sipas vlerës neto e prezantuar në PFV është nënvlerësuar për 6,011,393€, ndërsa pasuria jo kapitale është mbivlerësuar për 229,897€. Tabela në vazhdim paraqet diferencat në mes të dhënave të prezantuara në PFV dhe auditimeve individuale.

Tabela 16 - Pasuritë e komunave

(në euro)

Pasuritë më 31.12.2018	Sipas PFV-ve	Sipas auditimit	Mbivlerësimi/ Nënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)	5,819,391,439	5,825,402,832	6,011,393
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)	13,012,540	12,782,643	229,897

Dukuritë e gabimeve dhe mangësive lidhur me pasuritë, janë identifikuar në shumicën e komunave. Nga gjithsej tridhjetë e tetë (38) komuna, njëzetë e tri (23) prej tyre kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë e prezantuara në PFV.

Dobësi tjera në kontrole të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Komuna e Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit nuk kanë raportuar pasuritë me vlerë mbi 1,000€. Komuna e Ferizajit, Novobërdës, Mamushës, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Parteshit kanë raportuar pasurinë nën 1,000€ me vlerën zero, ndërsa Komuna e Kllokotit nuk ka raportuar pasuritë nën 1.000€.
- Në katërmbëdhjetë (14) komuna, nuk ka funksionuar sistemi e-pasuria;
- Në trembëdhjetë (13) komuna, raportet e inventarizimit ishin kryer pas hartimit të pasqyrave;
- Në nëntë (9) komuna, mungojnë politikat dhe procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurisë;
- Në tetë (8) komuna, nuk ishte aplikuar moduli i zhvlerësimit të pasurive;
- Në shtatë (7) komuna, nuk ishin themeluar komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë; dhe
- Në gjashtë (6) komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes regjistrit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit.

Mangësi tjera të evidentuara si te institucionet qendrore dhe ato lokale janë: menaxhim jo i mirë i automjeteve zyrtare; mungesa e zyrtarëve të pasurive; inventarizimi i pjesshëm i pasurisë; mos evidentimi i pasurive në regjistra të pasurisë dhe mungesa e barkodeve për pasuritë.

Organizatat buxhetore, po ashtu, kanë paqartësi lidhur me regjistrimin dhe përditësimet e pasurive me vlerën kontabël zero.

Stoqet për Institucionet Qendrore dhe Komunat 2018

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre te institucionet qendrore sipas PVF-se janë 19,547,747€, ndërsa sipas auditimeve individuale 18,788,225€, me një mbivlerësim prej 759,522€. Ndërsa stoqet të komunat sipas PFV-se janë 1,586,607€, ndërsa sipas auditimeve 1,711,727€ ose të nënvlerësuara për 125,120€.

Edhe te institucionet qendrore, edhe të komunat, janë identifikuar nga dy raste të mbivlerësimit apo nënvlerësimit të stoqeve.

Konkluzioni i auditimit

Edhe në vitin 2018, kontrollet mbi menaxhimin e pasurive nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat kanë kontrole të plota mbi pasuritë dhe i menaxhojnë pasuritë në mënyrë efikase dhe në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive fikse në sistemin e menaxhimit të pasurive SIMFK dhe E-pasuria, janë të pasakta dhe jo të plota. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe me tutje si te institucionet e nivelit qendror edhe ato lokal, edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e kësaj fushe.

Rekomandimet për Qeverinë

Qeveria duhet të luaj një rol proaktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të ndërtoj mekanizma llogaridhënës që:

- Të siguroj se të gjitha organizatat kanë të sistemuar zyrtarët e duhur për pasuri dhe nuk ekzistojnë probleme buxhetore lidhur me plotësimin e vendeve të punës për këta zyrtarë;
- Të gjitha organizatat t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar të gjitha pasuritë në posedim; dhe
- Të merr masa për funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë. Në të kundërtën, të shfuqizoj pjesën e rregullores e cila i obligon OB-të që ta përdorin këtë sistem, dhe të dhënat të mbahen veçmas në programe tjera të OB-ve.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Thesari përmes trajnimeve të fundvitit lidhur me hartimin e Pasygrave financiare, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit të reflektojnë në pasqyra financiare; dhe
- Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendos kontrole formale në veçanti lidhur me raportimin e stoqeve me gjendjen zero, dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, pasi në raportet e tri viteve të fundit ka diferenca të theksuara.

5 Llogaritë e arkëtueshme

Kontabilizimi aktual i transaksioneve sipas bazës së keshit, nënkupton që gjendja e llogarive të arkëtueshme konsolidohet dhe raportohet kryesisht në mënyrë manuale, si për hartimin e pasqyrave financiare individuale të organizatave buxhetore, ashtu edhe për ato të konsoliduara. Përderisa përbëjnë një zë tejet të rëndësishëm të pasurive afatshkurtëra, kërkojnë vëmendje të shtuar, si për qëllime të auditimit ashtu edhe përgjatë procesit të tërësishëm të buxhetit - aq më tepër kur një çasje e tillë e mbledhjes së informatave kontabël, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre. Rëndom, gabimet e identifikuara gjatë audimeve të fundit kanë qenë materiale.


Për vitin 2018, gjithsej vlera e deklaruar në Raportin Vjetor Financiar (RVF) 2018, për nivelin qendror dhe lokal kap shumën 631,702,000€, për të rezultuar kështu me një diferencë nënvlerësuese prej 2,429,000€ nga gjithsej shifra e audituar e cila rezultoi 634,131,000€. Madje, dallime ka edhe kur krahasojmë shënimet e pasqyrave individuale me ato të konsoliduara (612,000€ nënvlerësim në RVF). Kjo mos shpalosje e saktë është si pasojë e mungesës së një strukture formale për raportimin, mbikëqyrjen dhe konsolidimin e të dhënave si dhe për shkak të gabimeve pothuajse teknike gjatë bartjes së shënimeve nga PF në RVF, me rastin e përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara.

Krahasuar me vitin 2017, kjo kategori shënoi rritje për 17% apo shpehur si lëvizje në shumë absolute prej 93,021,000€. Kjo rritje paraqet një normë shumë më të lartë se sa rritja që ishte nga viti 2016, prej 4%.

Tabela 17 - Krahasimi i llogarive të arkëtueshme në tri vitet e fundit (në euro)

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2018	Sipas PF të OB 2018	Sipas RVF 2018	Sipas RVF 2017	Sipas RVF 2016	Krahasimi 2018-2017
Niveli qendror	462,278,000	461,003,000	462,008,000	377,127,000	371,241,000	23%
Niveli lokal	171,853,000	170,087,000	169,694,000	161,554,000	144,748,000	5%
Gjithsej	634,131,000	631,090,000	631,702,000	538,681,000	515,989,000	17%

Krahasimi i llogarive të arkëtueshme në tri vitet e fundit (në '000 euro)



Llogaritë e arkëtueshme të nivelit qendror

Vlera e prezantuar në RVF 2018 për nivelin qendror është 462,008,000€, e cila gjatë auditimit ka rezultuar të jetë e nënvlerësuar për 270,000€, meqë kjo shifër duhet të paraqitet në vlerë 462,278,000€. Gabimet ishin kryesisht:

- Pjesa më e madhe e diferencës rrjedh nga një gabim teknik, ku vlera prej 1,007€ e Llogarive të Arkëtueshme (Ll/A) të Zyrës së Kryeministrit është paraqitur si vlerë 1,006,750€;
- Në Ministrinë Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht tek Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit llogaritë ishin nënvlerësuar për 1,166,540€, meqë nuk ishin përfshirë saldot e viteve paraprake; dhe
- Ministria e Shëndetësisë (MSh) nuk ka përfshirë 80,287€ për shkak se njësitë vartëse të MSh-së nuk kishin raportuar gjendjen reale të këtyre llogarive

Rreth 91% e llogarive të arkëtueshme të nivelit qendror e përbëjnë të arkëtueshmet nga Dogana dhe ATK, respektivisht nga Ministria e Financave (shifra e audituar 419,065,577 €). Krahasuar me vitin paraprak, Ll/A të nivelit qendror karakterizohen me një trend rritës prej 23%.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal

Sipas raportit të konsoliduar financiar, bilanci i të arkëtueshmeve në 34 komuna⁹ ishte 169,694,000€ por auditimi ka nxjerrë një nënvlerësim prej 2,159,000€. Shuma që duhet të paraqitet si saldo e Ll/A në nivel komunal është 171,853,000€. Kjo diferencë prej mbi një milioni, rrjedhë shkaku i harmonizimit në mënyrë manuale të të dhënave përcjellur me një cilësi të dobët raportimi dhe monitorimi nga drejtoritë përkatëse komunale. Problematikë tjetër është se në disa komuna, shënimet për gjendjen e të arkëtueshmeve për taksat në biznes nuk ekzistojnë fare, dhe është lënë në vullnet të bizneseve, nëse duan të paguajnë. Gjithashtu, disa shifra nuk janë të reflektuara fare në pasqyrat e konsoliduara financiare. Më saktësisht:

- Komuna e Ferizajt, nuk ka paraqitur mbi 1 milion euro taksa në biznes dhe leje ndërtimore;
- Komuna e Mitrovicës, ka nënvlerësuar për rreth 500,000€ këtë kategori sepse nuk kishte përfshirë të arkëtueshmet nga taksat e mbeturinave, lejet e ndërtimit dhe qiratë;
- Komuna e Novobërdës e cila deklaroi Ll/A 360,000€ por të njëjtat nuk janë të paraqitura në raportin e konsoliduar financiar;
- Tek Komuna e Istogut Ll/A janë të nënvlerësuar për 196,101€ meqë nuk përfshijnë ngarkesa në afarizëm të bizneseve, ngarkesat për shërbime të pijeve alkoolike si dhe ato të qirave;
- Komuna e Vushtrisë me një nënvlerësim prej 309,175€, duke përjashtuar të arkëtueshmet nga shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave;

⁹ Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku nuk kanë raportuar për llogaritë e arkëtueshme, meqë nuk aplikojnë tatimin në pronë apo ngarkesa tjera të cilat krijojnë të arkëtueshme. Vlenë të përmendet se tatimi në pronë buxhetohet vit pas viti për tu inkasuar nga këto komuna, por ende nuk zbatohet ndonjë masë konkrete në këtë drejtim.

- Komuna e Prishtinës me 287,092€ të mbivlerësuar, sepse që nga viti 2013, vazhdon të kalkuloj të arkëtueshmet nga ish objekti 'Rilindja', e cila që nga ai vit është objekt qeveritar dhe lirohet nga ky tatim; dhe
- Komuna e Prizrenit nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të tatimit në pronë me saldot fillestare, duke mbivlerësuar Ll/A për 214,234€, dhe duke mos ofruar dëshmi për të arsyetuar diferencën e paraqitur;

Në llogari të arkëtueshme të nivelit lokal përfshihen në përgjithësi të arkëtueshmet nga, tatimi në pronë, taksat në biznes, taksat për shërbimet e mbeturinave, qiratë dhe tjera. Kjo kategori dominohet nga ajo e tatimit në pronë në të cilat përfshihen ngarkesat aktuale si dhe kamatat e dënimit për mos kryerje të obligimeve të mëhershme. Viteve të fundit, gjenerimi i të dhënave të sakta për tatimin në pronë ka qenë sfidues gjatë hartimit të pasqyrave financiare individuale. Shënimet paraqiten si të mirëqena nga sistemi aktual i menaxhimit të tatimit në pronë Protax i cili menaxhohet nga Ministria e Financave. Në prill 2018, ZKA ka publikuar një raport mbi efektivitetin e sistemit të tatimit në pronë. Ndër tjera, është raportuar për dështim të procesimit të pagesave në sistemin aktual, gjë që rrezikon edhe saktësinë e raportimit të llogarive të arkëtueshme. Më tej, edhe për një numër objektsh të cilat gjenden nën menaxhim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, ndër vite, i kanë të pashlyera obligimet e tatimit në pronë, të cilat nuk janë fshirë ende nga sistemi. Gjithashtu, disa nga auditimet individuale kanë raportuar se ekzistojnë prona pa pronarë, gjë që rritë gjendjen e Ll/A në mënyrë fiktive.

Përveç tatimit në pronë, i cili menaxhohet përmes aplikacionit 'ProTax', pjesa tjetër e shënimeve të llogarive të arkëtueshme mirëmbahet krejtësisht në mënyrë manuale në programet aplikative MS Excel ose Access. Kjo rritë rrezikun e kontroleve dhe ndryshimit të të dhënave në mënyrë të pa autorizuar.

Trendi rritës i kësaj kategorie ndërlidhet shumë me dobësi të raportuara sa i përket formave të mbledhjes së obligueshme, ngarkesave dhe faturimeve të mëvonshme si dhe me vjetërsinë e tyre. Komunitat kanë të deklaruara të arkëtueshme të cilat datojnë që nga viti 2002, gjë që e vështirëson edhe më tej inkasimin tyre për shkak të ndryshimit të rrethanave. Krahasuar me vitin 2017, Ll/A kanë shënuar një rritje prej 5%.

Rekomandimi për Qeverinë dhe Ministrinë e Financave

- Në koordinim me komunitat dhe organizatat që krijojnë të hyra, duhet të rishikojnë rrugët e inkasimit, konsolidimit, mbikëqyrjes dhe raportimit të Ll/A në mënyrë që njësitë vartëse dhe drejtoritë përkatëse të jenë të vetëdijshme për rëndësinë e këtyre burimeve në mbarëvajtjen buxhetore dhe realizimin e objektivave. Aty ku është e mundur, të automatizohen proceset në konsolidimin dhe azhurnimin e të dhënave.

6 Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente

Detyrimet e papaguara parqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të bazës kesh të kontabilitetit, gjendja e detyrimit të papaguar vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, ato mbledhen në mënyrë manuale nga organizatat buxhetore dhe raportohen në baza mujore në MF, për konsolidim të mëtejshëm. Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit (urdhërblenjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dizpozicion, por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë. Ky fakt ka sjellur një trend rritës të detyrimeve nga viti në vit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror.

Në raportin e konsoliduar financiar, detyrimet totale të papaguara janë paraqitur në shumën 258,792,000€, vlerë kjo që sipas auditimit është e nënvlerësuar për 345,000€, sepse duhet të jetë 259,137,000€. Krahasuar me vitin paraprak, detyrimet janë rritur për 30%.


Mbulimi i këtyre detyrimeve nuk planifikohet në ligjet vjetore të buxhetit. Por, pas fillimit të vitit fiskal, Ministria e Financave kërkon nga organizatat të prioritojnë projektet dhe të planifikojnë pagesën e borxheve të bartura. Përkundër kësaj, organizatat vazhdimisht përballen me borxhe të grumbulluara që datojnë vite më parë, madje në pothuajse të gjitha kategoritë. Si pasojë e kësaj vijnë në shprehje edhe pagesat direkte nga Thesari dhe ato me vendime gjyqësore, të cilat janë trajtuar më shumë në kapitullin 7 dhe 7.1 të këtij raporti.

Tabela 18 - Detyrimet e pa paguara në tri vitet e fundit

(në euro)

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2018	Sipas PF të OB 2018	Sipas RVF 2018	Sipas RVF 2017	Sipas RVF 2016	Krahasimi 2018-2017
Niveli qendror	225,806,000	226,642,000	226,643,000	170,334,000	200,275,000	33%
Niveli lokal	33,331,000	32,226,000	32,149,000	29,077,000	15,407,000	11%
Gjithsej	259,137,000	258,868,000	258,792,000	199,411,000	215,682,000	30%

Detyrimet e pa paguara në tri vitet e fundit (në '000 euro)



Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Vlera totale e detyrimeve të papaguara të nivelit qendror raportohet të jetë 226,643,000€, por është e mbivlerësuar për 837,000€ meqë kjo shifër duhet të paraqitet në vlerë 225,806,000€. Arsye për këtë është cilësia e dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve. Më saktësisht:

- Pjesa më e madhe e gabimit rrjedh nga PF të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), e cila ka paraqitur afërsisht 950,000€ obligime më shumë meqë nuk i takonin kësaj Ministrie¹⁰;
- Në anën tjetër, Ministria e Infrastrukturës (MI) kishte nënvlerësuar detyrime për afërsisht 95,000€ të cilat i kishte ende të papaguara në kategorinë e subvencioneve, por nuk i kishte deklaruar.

Mbi 70% e detyrimeve të nivelit qendror i takojnë MMPH (mbi 160 milionë euro) për shpronësim të pronave. Rritja e përgjithshme e tyre prej 33% nga viti 2017, rrjedh kryesisht nga mos pagesa e obligimeve nga kjo Ministri, si rezultat i mungesës së mjeteve financiare dhe i menaxhimit jo të duhur të procesit të shpronësimeve nga të tri ministrinë përgjegjëse: Ministria e Infrastrukturës e cila ka përgjegjësi që të caktojë segmentet e shpronësimit, Ministria e Financave që është përgjegjëse për përcaktimin e vlerës financiare të shpronësimeve dhe MMPH-ja që është ekzekutuese e pagesave të vlerës financiare të përcaktuar nga MF.

Mbi 38,000,000€ apo rreth 17% të detyrimeve të nivelit qendror janë nga MI, kryesisht për projektin Ndërtimi i Autoudhës R6 Prishtinë - Han i Elezit.

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Gabimet në raportim, janë dukshëm të theksuara edhe në nivelin lokal si pasojë e kontrolleve të dobëta nga drejtoritë dhe raportimi i tyre tek Zyrtari Kryesor Financiar. Shuma e raportuar si 32,149,000€ është nënvlerësuar për 1,182,000€, kryesisht nga:

- Komuna e Prizrenit e cila kishte të nënvlerësuar PF për 904,746€ si pasojë e gabimeve gjatë konsolidimit të të dhënave;
- Komuna e Leposaviqit, me një diferencë nënvlerësuese prej 213,095€ sepse nuk kishte përllëgarit detyrimet për kumatën e kërkuar nga përmbaruesi privat për mos kryerje të obligimeve të viteve të kaluara;
- Komuna e Gjilanit e cila kishte raportuar 208,427€ më shumë, meqë nuk kishte harmonizuar disa pagesa që veçse ishin paguar deri në datën e raportimit; dhe
- Komuna e Rahovecit nuk ka paraqitur 133,000€, gjithashtu si pasojë e kontrolleve të dobëta.

¹⁰ MMPH në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Kompania Regjionale e Ujësjellësit Gjakova kishin nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi sipas së cilës Ministria do të financoj realizimin e projektit me vlerë prej 200,000 €, vlerë e cila ishte paguar gjatë 2018. Fatura shtesë prej 950,000€ i është faturuar nga OE implementuese Kosova Water and Energy kësaj Ministrie, dhe e njëjta e ka paraqitur si obligim, pavarësisht që marrëveshja nuk e obligonte Ministrinë ta paguaj këtë.

Komunat me obligimet më të larta janë ajo e Gjilanit 7,577,653€ apo 23% të gjithëj borxheve të nivelit lokal, pastaj Prishtina 7,545,271€, si dhe Prizreni dhe Ferizaj me nga mbi 3,000,000€ secila.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave në koordinim me organizatat që kanë detyrime të papaguara, duhet të rishikojnë prioritetin e pagesës së detyrimeve të prapambetura. Madje, MF duhet të shqyrtoj mundësinë që të mos bëj alokime buxhetore para se të jenë shlyer detyrimet e pa paguara. Për rastet e caktuara kur obligimet janë në shumta të larta, pagesa e këtyre borxheve të jetë e programuar me shumë kujdes në mënyrë që të mënjanoen shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative.

6.1 Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, shpalosen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të shndërrohen në detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Në raportin e konsoliduar, detyrimet kontigjente janë gjithsej 196,824,000€, por të nënvlerësuara për 10,494,000€ meqë do duhej të paraqitej në vlerë 207,318,000€. Kjo kategori si e tillë, është subjekt i gabimeve potenciale në shpalosje, sepse varen nga bashkëpunimi mes zyrave ligjore të OB-ve, Avokaturës Shtetërore si dhe autoriteteve gjyqësore. Por, diferencat gjithashtu kanë të bëjnë edhe me disa gabime që janë lëshuar nga Ministria e Financave gjatë konsolidimit të shënimeve që i kanë pranuar nga organizatat buxhetore. Është shqetësues trendi në rritje i këtyre detyrimeve dhe njëkohësisht pakujdesia dhe mospërkushtimi i duhur në raportimin e tyre. Krahasuar me vitin paraprak, këto janë më të larta për 39%.

Si mangësi e shpalosjeve, RVF 2018 nuk përmbanë fare kolonat e detyrimeve kontingjente të vitit 2017 dhe 2016.

Tabela 19 - Detyrimet kontingjente gjatë tri viteve të fundit

(në euro)

Detyrimet Kontigjente	Sipas Auditimit 2018	Sipas PF të OB 2018	Sipas RVF 2018	Sipas auditimit 2017	Sipas auditimit 2016	Krahasimi 2017- 2018
Niveli qendror	94,436,000	94,667,000	88,043,000	75,602,000	28,953,000	16%
Niveli lokal	112,882,000	112,903,000	108,781,000	66,165,000	26,146,000	64%
Gjithsej	207,318,000	207,570,000	196,824,000	141,767,000	55,099,000	39%

Detyrimet kontingjente të nivelit qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente të nivelit qendror u raportua në RVF 2018 si 88,043,000€, por është e nënvlerësuar për 6,393,000€. Sipas auditimit, duhet të jetë 94,436,000€. Arsye për këtë është cilësia e dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve nga OB-të tek MF, si dhe kjo e fundit në disa raste kishte bartur gabimisht shënimet. Disa nga gabimet ishin:

- Ministria e Arsimit ka raportuar në PF të saj 4,998,660€, shumë kjo e konfirmuar edhe nga auditimi, por në RVF janë paraqitur vetëm 4,499€;
- Ngjashëm, Universiteti i Prishtinës dhe Agjencia për Menaxhimin e Memorialeve raportuan në PF 1,795,439€ respektivisht 754,828, por në RVF nuk janë paraqitur fare;
- Në anën tjetër, Gjykata Kushtetuese e Kosovës (GJKK) nuk ka raportuar fare detyrime kontingjente dhe këtë e ka konfirmuar edhe auditimi. Por, në RVF shihet shuma prej 754,828€. Ne mund të konkludojmë që MF ka ngatërruar këto dy organizata, me ç'rast në vend të shpalosjes së vlerës së detyrimeve kontingjente tek Agjencioni i Memorialeve (shih pikën më lartë), të njejtat i janë vendosur GjKK-së;

Ministria e Mjedisit prinë për nivelin e lartë të detyrimeve kontingjente (25,870,000€) ku përfshihen obligimet e mundshme për shpronësimin e tokave. Në pasqyrat e saj për vitin 2017 ishin raportuar vetëm 1.3 milion, duke lënë jashtë lëndët në proces gjyqësor për shpronësimet. Ndërsa për vitin 2018, auditori u ka rekomanduar përfshirjen e tyre. Në një masë, kjo ka kontribuar në rritjen e përgjithshme të detyrimeve kontingjente.

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal tejkalojnë si shumë ato të nivelit qendror. Paditë ndaj komunave janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri tek paditë për shpronësime. Për shkak të çasjes aspak të strukturuar dhe jo formale në harmonizimin e të dhënave, auditimi ka nxjerrë një shesh një mori gabimesh. Shuma e raportuar si 108,781,000€ është nënvlerësuar për 4,101,000€, kryesisht për shkak se për Komunën e Prizrenit, sikurse tek detyrimet e papaguara, edhe detyrimet kontingjente në vlerë prej 4,130,000€ nuk janë paraqitur fare në RVF. Rasti i ngjashëm ishte edhe me Istogun, ku 152,019€ nuk janë prezantuar fare në RVF.

Komunat me obligimet më të larta janë ajo e Prishtinës me 38,280,748€ apo me 35% të gjithsej borxheve të nivelit lokal, pastaj Rahoveci 32,695,000€, si dhe Gjilani 9,836,300€.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave në koordinim me organizatat buxhetore duhet të sigurohet se nga OB bëhet një vlerësim i përafërt i detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RVF të jenë sa më të sakta.

7 Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP-së

Për vitin 2018, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 8,684,200€¹¹ sipas nenit 39.2. Në raport me vitin 2017, pagesat e ekzekutuara brenda këtij viti janë rritur për 80,200€ apo diçka më pak se 1%. Hyrja në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, neglizhenca dhe papërgjegjësia e zyrtarëve përgjegjës në pagesën e faturave me kohë, janë shkaqet kryesore për ekzekutimin e këtyre pagesave.

Tabela më poshtë paraqet trendin e këtyre pagesave gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 20 - Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP (në euro)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2018	Totali 2017	Totali 2016
Mallra dhe Shërbime (Komunali)	1,673,869	1,892,000	666,000
Subvencione dhe transfere	0	316,000	0
Investime Kapitale	7,010,331	6,396,000	4,239,000
Gjithsej	8,684,200	8,604,000	4,905,000

Më poshtë, janë pasqyruar disa prej OB-ve tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në shuma më të larta, bazuar në nenin 39.2 të LMFP, që përfshinë 87% të totalit të këtyre pagesave:

- Ministria e Infrastrukturës 4,184,557€
- Komuna e Ferizajit 1,208,960€
- Komuna e Prizrenit 980,941€
- Komuna e Prishtinës 601,411€
- Komuna e Gjakovës 592,175€;

Kjo mënyrë e realizimit të pagesave mund të rritë rrezikun e vazhdimet të praktikave të tilla nga OB-të. Me rastin e rishikimit të procesit të këtyre pagesave, nuk kemi vërejtur parregullsi dhe se procedura për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe të papaguara sipas nenit 39.2 të LMFP-së është zbatuar me konsistencë nga ana e Thesarit.


¹¹ Sipas LMFP neni 39.2, kur një faturë nuk është paguar nga Organizata buxhetore për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, operatori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e pagesës drejtpërdrejt nga MF/Thesari.

7.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Në vitin 2018, me vendime të gjykatave dhe vendime të përmbaruesve privat janë bërë pagesa në shumë prej 20,260,075€. Në raport me të dhënat e vitit 2017, shumta e këtyre pagesave është rritur për 8,716,075€ apo 75%. Siç shihet nga tabela, trendi i këtyre pagesave në tri vitet e fundit ka shënuar një rritje enorme, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore janë gjithnjë e më pak likuiduese në kryerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik dhe debitorëve tjerë.

Tabela 21 - Pagesat me vendim të gjykatave dhe përmbarimeve (në euro)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2018	Totali 2017	Totali 2016
Paga dhe mëditje	303,522	34,000	117,000
Mallra dhe Shërbime (Komunali)	4,058,530	2,251,000	1,949,000
Subvencione dhe transfere	590,977	373,000	404,000
Investime Kapitale	15,307,046	8,886,000	3,881,000
Gjithsej:	20,260,075	11,544,000	6,351,000



Mos pagesat me kohë dëmtojnë operatorët pasi që të njëjtit borxhet e tyre i inkasojnë pas periudhave të gjata kohore, çka mund të ndikoj në ushtrimin e rregullt të veprimtarisë për shkak të mungesës së mjeteve qarkulluese. Këto procese shkaktojnë vonesa dhe shpenzime shtesë për buxhetin, si dhe dëmtojnë besueshmërinë ndaj institucioneve publike.

Më poshtë, janë pasqyruar disa prej OB-ve tek të cilat përbëjnë gati gjysmën e pagesave totale të kryera përmes vendimeve gjyqësore dhe procedurave përmbarimore, si:

• Komuna e Ferizajit	2,895,937€
• Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2,372,453€;
• Komuna e Leposaviqit	2,230,658€
• Komuna e Mitrovicës	1,053,387€
• Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit	1,033,181€;

Shkaqet kryesore të pagesës së faturave nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bëjnë me pagesat e pa kryera në bazë të marrëveshjes kolektive për pagesë të pagave jubilarë të punonjësve pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve, për pagesat e punëtorëve të mbetur jashtë listës së pagave në mungesë të pozitive të buxhetuara, për pagesën e faturave të mbetura konteste nga vitet e më hershme, për kompensimin e të dënuarve pa bazë, mos pagesa sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike, si dhe vonesat në pagesa për operatorët ekonomik si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

Me rastin e rishikimeve tona analitike kemi vërejtur se në Raportin vjetor financiar, në aneksin 19 dhe në regjistrin e vendimeve gjyqësore është përfshi pagesa në shumë prej 600,000€ e cila i takon Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) e cila në fakt nuk është pagesë për vendim gjyqësor, por është vetëm transfer nga kodi ekonomik 14410 “shpenzime - vendime të gjykatave” në kodin 83093 “depozitat - skemat e kompensimit”. Dalja e mjeteve përmes kodit 14410 është shfrytëzuar si metodë për të transferuar mjetet në kodin ekonomik 83093. Për të njëjtën shumë, pagesat sipas vendimeve gjyqësore janë mbivlerësuar në pasqyra financiare.

Siç shihet nga tabela, 75% të këtyre pagesave janë kryer nga kategoria e investimeve kapitale, që do të thotë se shumë projekte kapitale është dashtë të reduktohen për t’u paguar këto detyrime.

8 Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, numri i aprovuar i të punësuarve për nivelin qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura), ishte 40,550, përderisa numri aktual në fund të vitit 2018, sipas PVF të BRK-së ishte 37,317€. Pra, kemi një diferencë të numrit të të punësuarve aktual me atë të buxhetuar për 3,233. Kjo diferencë paraqet pozitat e aprovuara me ligj të buxhetit, por të paplotësuara nga organizatat buxhetore gjatë vitit 2018.

Diferencat më të shprehura dhe shkaqet që kanë ndikuar në mos plotësimin e pozitave të aprovuara janë tek:

- Ministria e Punëve të Brendshme, ku arsyet për mosplotësimin e pozitave (664) ishin buxheti i pamjaftueshëm për pozitat e aprovuara, mos aprovimi i pozitave nga MAP, zgjatja e afateve për shkak të mungesës së kapacitetit të institucionit për të vlerësuar aplikacionet e shumta.
- Universiteti i Prishtinës, arsyeja për mosplotësimin e këtyre pozitave (541) ishte dështimi në konkurset e shpallura.
- Ministria e Mbrojtjes, ku arsyet për mosplotësimin e pozitave (490) ishin: pensionimet e parakohshme, demobilizimi vullnetar si rezultat i shkeljeve, mos angazhim i plotë i komponentës rezervë të FSK, mosrekrutimi i plotë sipas planifikimit;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ku mosplotësimi i pozitave (288) ishte si rezultat i mos zhvillimit të procedurave të rekrutimit, si dhe;
- Ministria e Drejtësisë, e cila nuk kishte arritur të plotësoj numrin e aprovuar të pozitave (226) për shkak të tejzgjatjes së procedurave të rekrutimit, duke e përfshirë edhe afatin e ankesave.

Numri i të punësuarve të aprovuar për nivelin komunal sipas Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 ishte 43,878, përderisa numri aktual në fund të vitit 2018, sipas PVF të BRK-së për nivelin lokal ishte 42,907, me një diferencë prej 971 pozita të paplotësuara në raport me numrin e lejuar.

Dallimet më të mëdha në mos plotësimin e pozitave, janë vërejtur kryesisht në këto komuna: Mitrovica e Veriut 400, Zubin Potoku me 252, Leposaviq 192, Zveçan 157 dhe Shtërpca 124 pozita.

Sa i përket buxhetit të lejuar për paga për pozitat e pa plotësuara, në disa raste buxheti ishte zvogëluar përmes vendimeve të Qeverisë për deklarim të kursimeve, apo buxheti kishte shkuar në suficit, ndërsa në raste tjera sikurse tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, buxheti ishte shpenzuar në rritjen e pagave për gjyqtarë dhe stafin administrativ.

8.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave dhe me kontrata për shërbime të veçanta

Numri i të punësuarve jashtë listës së pagave

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2018, në institucionet e nivelit qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura) numri total i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 407.

Numri më i madh i tyre është hasur në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (299). Këta punëtorë janë specializantë dhe specialistë të cilët nuk janë në listat e pagave në QKUK, mirëpo janë prezent vetëm në mbajtje të kujdestarive. Arsyet pse nuk janë rekrutuar sipas procedurave të rregullta të rekrutimit ishte mungesa e buxhetit në këtë kategori. Po ashtu, edhe në Organin Shqyrtues të Prokurimit janë 48 punëtorë të angazhuar si ekspertë teknik dhe profesional. Në Zyrën e Kryeministrit janë 33 të angazhuar punëtorë jashtë listës së pagave të cilët janë praktikantë bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 166 ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) dhe Zyrës së Kryeministrit (ZKM), lidhur për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës - **Praktikë në Punë**. Kohëzgjatja e marrëveshjes është për 6 muaj, e vazhduar edhe për 6 muaj me Aneks Kontratë.

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2018, në nivelin komunal, numri i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 100. Komunat me numrin më të madhë të këtyre të punësuarve janë Shtërpca (28), Mamusha (25) dhe Mitrovica (22).

Marrëveshjet për shërbime të veçanta

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2018, numri total i të angazhuarve përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV), ishte 2,493.¹² Krahasuar me numrin e tyre në vitin 2017 që ishte 2,929, kemi një zvogëlim të tyre për 436 apo rreth 18%.

Gjetjet kryesore të dala nga raportet individuale të auditimit për vitin 2018, sa i përket këtyre të angazhuarve ishin: angazhimi i tyre pa respektuar ndonjë procedurë të rekrutimit, siç kërkojnë rregullat ligjore, periudha e angazhimit të zyrtarëve më e gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, kontratat e lidhura për këto pozita ishin për pozita të rregullta, e jo për ekspertë të fushave përkatëse, dhe vazhdimi i angazhimit të zyrtarëve me MSHV nga vitet paraprake.

Rekomandimi për Qeverinë

Rekomandojmë Qeverinë që të merr masat e duhura që të parandaloj pagesën e stafit jashtë listës së pagave, respektivisht aty ku është e mundur dhe e domosdoshme, të zgjidhë statusin e tyre në baza të rekrutimit dhe kontratave të rregullta të punës.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Administratës Publike

Që në bashkëpunim me OB-të, të ndihmojnë përmes procesit buxhetor dhe procedurave të rekrutimit të mundësojnë angazhimin e stafit në pozita të rregullta aty ku ky numër është i aprovuar me ligj.

¹² Në total përfshihen Ministritë, Institucionet e Pavarura dhe Komunat.

Pjesa II - Të përgjithshme

9 Zbatimi i rekomandimeve

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e dobësive në sistemet e qeverisjes, veçanërisht të sistemeve financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si një mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Analizat në këtë fushë kanë rezultuar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm.

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2017, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, dhe i njëjti është dërguar në Kuvend (KMFP), megjithatë, nuk ishte raportuar për progresin e arritur.

Në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Ndonëse, krahasuar me vitin 2016, numri rekomandimeve ka shënuar rënie, megjithatë, një numër i vogël i rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit ose të pa zbatuara, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Përveç kësaj, një numër i rekomandimeve janë trajtuar si të mbyllura për faktin e ndryshimeve të bazës ligjore si dhe ndryshimit të strukturës së raportimit e të cilat nuk do të përsëriten.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Shkaqet dhe arsyet që kanë ndikuar për një progres të dobët, janë të ndryshme, të cilat do të shpjegohen më poshtë.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku parregullsitë janë identifikua.

ZKA, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe vitet e mëhershme, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nuk janë vërejtur ndryshime.

Shtojca II e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA, ndërsa Tabela 1 dhe 2 paraqet statistikën e rekomandimeve për organizatat individuale.

Te auditimet e performancës matja e zbatimit të rekomandimeve bëhet përmes kryerjes së vlerësimeve specifike që njihen edhe si “faza e përcjelljes”.

Çështjet dhe rekomandimet për Ndërmarrjet Publike do të trajtohen në një seksion të veçantë të këtij raporti.

9.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2017

Në RVA për vitin 2017, Auditori i Përgjithshëm kishte rekomanduar Kuvendin të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2017 dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza tremujore.

Qeveria e Kosovës në tetor të vitit 2018 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. I njëjti është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës (KMFP). Mirëpo, sipas KMFP, nuk ka ndonjë veprim apo raport lidhur me shqyrtimin e progresit të rekomandimeve.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve tjera, kanë reflektuar me një progres të ultë në zbatimin e rekomandimeve edhe pse krahasuar me vitin e kaluar për nga numri, niveli i tyre ka shënuar rënie.

Nga gjithsej 35 rekomandime¹³ të dhëna në RVA-në 2017, pesë (5) janë zbatuar plotësisht, 17 ishin në proces të zbatimit dhe 13 të tjera nuk ishin adresuar ende. Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2017.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Raportimi i gabueshëm i shpenzimeve në PFV për shkak të keqklasifikimit (përfshirë edhe pagesat direkte nga Thesari) dhe shpalosja jo e mjaftueshme e informatave;
- Dobësitë në fushat e qeverisjes që ndërlidhen me vetëvlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Dobësitë në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm për institucionet e vogla të pavarura; dhe
- Menaxhim joefikas i burimeve në komuna.

¹³ Pesë (5) Rekomandime janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 29 për Qeverinë / ministrinë, dhe 1 për Kuvendet Komunale. Nga këto rekomandime 6 janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

9.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2017

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt, dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2017 dhe 2016, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.

Organizatave të audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror¹⁴, Institucione të pavarura¹⁵ dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna).

Në vijmë është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

Tabela 22 - Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2017 për organizatat buxhetore

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara		Të mbyllura të pa zbatuara	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	357	144	40%	59	17%	103	29%	51	14%
Institucionet e pavarura	164	106	65%	19	12%	22	13%	17	10%
Institucionet e nivelit lokal	600	188	31%	123	21%	229	38%	60	10%
Gjithsej	1,121	438	39%	201	18%	354	32%	128	11%

¹⁴ 21 Ministri, Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana dhe ShSKUK.

¹⁵ Në institucionet e pavarura janë përfshirë Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Universiteti i Prishtinës dhe 28 institucione.

Grafiku vijues paraqet në mënyrë ilustrative progresin e rekomandimeve sipas institucioneve.




Tabela 23 - Zbatimi i rekomandimeve të organizatave buxhetore për vitin 2016

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet e nivelit qendror	307	112	36%	57	19%	138	45%
Institucionet e pavarura	220	118	54%	63	29%	39	18%
Institucionet e nivelit lokal	650	165	25%	191	29%	294	45%
Gjithsej rekomandime	1,177	395	34%	311	26%	471	40%

Siç shihet edhe nga tabelat më lartw, numri total i rekomandimeve të dhëna për vitet 2016/2017, është në rënie, e cila reflektohet sipas nivelit të institucioneve, megjithatë niveli i rekomandimeve të pa zbatuara ende mbetet i lartë.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar se rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në vitin 2019, ZKA ka dërguar tek Organizatat buxhetore “Rregullore të punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit” si dhe formatet e formularëve për planin e veprimit të rekomandimeve dhe monitorimit (progresit) të tyre.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorim i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha Organizatat Buxhetore.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e performancës

Qëllimi i rekomandimeve tona në auditimet e performancës është në përmirësimin e procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara në mënyrë që të përmirësojnë çasjen e tyre në raport me shpenzimin e fondeve publike.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes auditimeve të veçanta, të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Pas këtij procesi nxjerrën edhe rezultatet e zbatimit të rekomandimeve. Përmes auditimeve të performancës, ZKA i ka ofruar Kuvendit dhe të audituarve rekomandime të dobishme që të përmirësojnë dhe rrisin ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në sektorë të rëndësishëm si: sistemi gjyqësorë, shëndetësia, mjedisi, sistemet e teknologjisë informative, prokurimi publik.

Rekomandimet e auditimit të performancës kanë përfshirë si nivelin e qeverisjes qendrore, ashtu edhe atë lokale. Megjithatë, përkundër rekomandimeve të dhëna, shqyrtimeve të raporteve nga KMFP dhe Komisionet relevante të Kuvendit si dhe organizimi i diskutimeve publike mbi rezultatet e auditimit, kuptimi i rëndësisë së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës ende nuk është në nivel të dëshirueshëm. Kjo për faktin, se për pjesën më të madhe të raporteve të auditimit, organizatat nuk përgatisin as planet e veprimit për zbatim të rekomandimeve, e në anën tjetër, edhe zbatimi i tyre merr më shumë kohë.

Për sezonin auditues 2018/2019, ZKA ka kryer një auditim përcjellës me temën “Përgjegjësitë e monitorimit dhe menaxhimit në përdorimin e pajisjeve mjekësore” Rasti: Tomografia e Kompjuterizuar ” Konkluzioni i auditimit përcjellës ishte se nga 10 rekomandimet e dhëna asnjë rekomandim nuk është zbatuar plotësisht, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe tri (3) rekomandime nuk janë zbatuar fare. Përderisa, në fushën e mjedisit, bazuar në rekomandimet e auditimit janë ndërmarrë masa nga Qeveria për miratimin e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit, si dhe Instituti Hidrometeorologjik ka vënë në funksion softuerin dhe aplikacionin mobil për raportimin e të dhënave të cilësisë së ajrit në kohë reale. Po ashtu, KRPP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në bazë të rekomandimeve të dhëna në auditimin Vlera për para në prokurimet e centralizuara, ka ndërmarrë disa veprime korigjuese duke plotësuar dhe avancuar më tutje Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik të hartuar nga KRPP. Niveli i zbatimit të rekomandimeve në këtë fushë mbetet të vlerësohet përmes auditimit të fazës së dytë pas implementimit të prokurimeve të centralizuara. Më tutje, edhe rekomandimi i dhënë për Sistemin e Tatimit në Pronë, pavarësisht disa përmirësimeve që ishin bërë gjatë procesit auditues, sistemi vazhdon të prodhoj të dhëna jo të plota. Rekomandimi ynë lidhur me iniciimin e diskutimeve nga komisioni parlamentar për shëndetësi për sfidat në aplikimin e Sistemit Informativ Shëndetësor është adresuar, megjithatë, zbatimi i këtij sistemi nga Institucionet shëndetësore, mbetet të vlerësohet nga auditimi përcjellës.

Arsyet për zbatim të ultë të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatim të rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesorë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten.

Për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve, nevojiten masa shtesë nga ana e Qeverisë ndaj OB-ve dhe forcimi i masave të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës.

Rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP. Po ashtu, të përcaktoj saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që të paktën një herë në vit të shqyrtoj progresin e arritur për rekomandimet e dhëna.

Rekomandimi për Kuvendet e Komunave

Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar që Kryetarët e Komunave t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë.

10 Opinionet e auditimeve në raportet individuale

ZKA ka kryer auditimet e rregullsisë së PFV-ve për vitin 2018 në 92 Organizata Buxhetore. Opinionet e auditimit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, derisa te gjetjet e auditimit janë paraqitur në raportet individuale të auditimit të OB-ve.

Tabela 24 - Numri dhe lloji i opinioneve të dhëna për vitin 2018

Subjektet e audituara	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes	Opinion i kualifikuar	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i kundërt me theksim të çështjes	Gjithsej
Organizatat e nivelit qendror	7	13	0	6	0	26
Komunat	3	33	0	2	0	38
Institucionet e Pavarura	27	2	1	0	0	30
Gjithsej	37	48	1	8	0	94

Siç shihet edhe nga tabela, auditimet individuale të OB-ve kanë rezultuar me 85 opinione të pamodifikuara (prej tyre 37 të pamodifikuara dhe 48 të pamodifikuara me theksim të çështjes), si dhe 9 opinione të modifikuara (1 opinion i kualifikuar dhe 8 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes).

Shprehur në përqindje, në 90% të rasteve auditimet në kuptim të raportimit, paraqesin pamje të drejtë dhe të saktë të PFV-ve, dhe në 10% të rasteve, pasqyrat kanë përmbajtur gabime dhe parregullsi materiale. Në krahasim me vitin paraprak ka një përmirësim, pasi që në vitin 2017, në 17% të OB-ve pasqyrat kanë pasur gabime materiale. Arsyet që kanë ndikuar në modifikimin e opinionëve, dhe ato për theksim të çështjes janë dhënë në detaje në Shtojcën II të këtij raporti.

Në tabelën vijuese janë paraqitur organizatat me opinione të kualifikuara të auditimit.

Tabela 25 - Organizatat buxhetore me opinion të kualifikuar

Organizata Buxhetore	Vlera e Gabimit	Natyra e gjetjeve	Arsyeja për modifikim
1. Opinion i kualifikuar			
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	113,199	Pagesa të pa rregullta	Pagesa për pagat e anëtarëve të KQZ-së të cilëve iu kishte skaduar mandati.
2. Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes			
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	981,595	Keq klasifikimi shpenzimeve; Pagesat të parregullta; Mos arsyetim i subvencioneve, dhe Mungesa e vijueshmërisë në punë.	Pagesa në vlerë 390,455€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate; Në Institutin Arkeologjik të Kosovës ishin realizuar pagesa në vlerë 273,913€, për punëtorët e angazhuar për punë në teren sipas një rregullore e cila ishte e shfuqizuar me vendim të qeverisë; subvencionet e dhëna në vlerë 153,864€ nuk ishin arsyetuar nga përfituesit e tyre si dhe pagesa në vlerë 163,363€ për paga dhe mëditje në mungesë të dëshmimeve për vijueshmërinë në punë.
Ministria për Kthim dhe Komunitete	100,430	Pagesa pa vijueshmëri në punë.	Pagesa për paga për 21 të punësuar në vlerë prej 100,430€, për pa u paraqitur punonjësit në punë.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	139,711	Pagesa pa vijueshmëri në punë.	Shpenzimeve për paga në vlerë prej 139,711€ për 26 punonjës pa vijueshmëri në punë.
Ministria e Punëve të Jashtme	343,527	Mosbarazim i shpenzime me regjistrin kontabël.	Shuma e shpenzuar për mallra dhe shërbime prej 343,527€, për të cilën nuk janë bërë barazimet e fund vitit me regjistrin kontabël.
Zyra e Kryeministrit	869,149	Mungesa e dëshmimeve për rregullsinë e pagesave.	Pagesa te parregullta, Pagesat për projekte që nuk janë përfshirë në planin fillestar të buxhetit në vlerë prej 869,149€ janë paguar me vendime të Qeverisë nga fondi rezervë dhe nga ndarjet buxhetore shtesë gjatë vitit. Për këto pagesa nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për rregullsinë e këtyre shpenzimeve.
Ministria e Administratës Publike	121,905	Pagesa të kryera pa evdidencat për vijueshmëri në punë dhe pagesa të qirasë për objekte të pashfrytëzuara.	Shpenzimet për paga në vlerë prej 99,916€ për 20 punëtorë të cilët nuk kanë vijuar orarin e rregullt të punës dhe shpenzimet për tri objektet e marra me qira në vlerë prej 121,989€, të cilat nuk janë shfrytëzuar.

Novo Bërdë	149,181	Mbivlerësimi/ nënvlerësimi i buxhetit për të hyrat dhe të garantëve të përcaktuara të donatoreve në Raportin e ekzekutimit të buxhetit; Mungesa e dëshmive për vijueshmëri në punë.	Raporti i ekzekutimit të buxhetit, hyrja e parasë se gatshme në llogari të thesarit të hyrat jo tatimore si buxhet ishin mbivlerësuar materialisht për 100,000€, ndërsa edhe realizimi i tyre ishte mbi vlerësuar për 1,000€; Raporti i ekzekutimit të buxhetit, buxheti final i garantëve të përcaktuara të donatorëve, ishte prezantuar gabimisht në vlerën 34,285€ apo 5,788€ më pak, ndërsa realizimi i garantëve ishte mbivlerësuar për 13,007€; dhe • Nga 20 rastet e audituara në drejtorinë e arsimit, në 14 prej tyre nuk kishte evidenca për vijueshmërinë në punë për personelin arsimor. Paga bruto për këta punëtorë gjatë kësaj periudhe ishte 43,393€.
Ferizaj	364,680	Mungesa e dokumentacionit për 12 pagesa nga vendimet gjyqësore.	12 Pagesa nga kategoria e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 364,680€, që komuna ka dështuar t'i siguroj për çështje të auditimit.


10.1 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2018

Përveç opinioneve të auditimit, në raportet individuale të OB-ve janë edhe rekomandimet për përmirësime, për secilën fushë ku janë identifikuar gabime dhe parregullsi. Pasqyra më poshtë paraqet detajet mbi numrin e rekomandimeve të dhëna në tri vitet e fundit.

Tabela 26 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për tri vitet e fundit

Subjektet e audituara	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Institucionet e Nivelit Qendror	275	363	306
Komunat	585	600	650
Institucionet e Pavarura	60	166	229
Ndërmarrjet publike	254	149	83
Gjithsej rekomandime	1,174	1,278	1,268

Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për tri vitet e fundit



Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për rënie të numrit të rekomandimeve në krahasim me vitet paraprake. Rënie më të madhe të numrit të rekomandimeve ka tek Institucionet e Pavarura dhe te Institucionet e Nivelit Qendror. Ndërsa rritja e numrit të rekomandimeve te Ndërmarrjet publike ishte për arsye të rritjes së numrit të Ndërmarrjeve të audituara, prej 6 në vitin 2016, në 11 në vitin 2018.

11 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë në sektorin publik inkurajon vendimmarrje të mirë dhe afatgjatë si dhe shfrytëzim efikas dhe efektiv të burimeve si financiare, ashtu edhe atyre njerëzore. Për të arritur këtë, institucionet shtetërore duhet të respektojnë parimet themelore të llogaridhënies, transparencës, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, funksionimin e auditimit të brendshëm si dhe administrimin e mirë me burimet publike.

Në funksion të qeverisjes së mirë, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, procedurat për menaxhim financiar dhe kontrollin, si dhe ka miratuar Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Planifikimi strategjik, regjistri i rreziqeve, vetëvlerësimi si dhe funksionimi i auditimit të brendshëm janë disa nga kërkesat që secili institucion publik duhet t'i vë në funksion të qeverisjes së mirë dhe drejt arritjes së objektivave institucionale. Rezultatet e auditimeve individuale të rregullsisë kanë nxjerrë në pah se pavarësisht progresit të shënuar gjatë viteve, institucionet publike me theks të veçantë institucionet e nivelit lokal ende nuk kanë arritur të kuptojnë rëndësinë dhe përfitimet që mund t'i kenë nga zbatimi i kërkesave që lidhen me qeverisjen e mirë. Hartimi i planeve strategjike, regjistrin të rreziqeve, pyetësorët e vet-vlerësimit ende nuk janë kuptuar si mekanizma të cilat mund të fuqizojnë llogaridhënien, rrisin transparencën dhe i kontribuojnë menaxhimit të shëndosh financiar. Zbatimi i këtyre kërkesave ende shoqërohet me dobësi në aspektin e cilësisë dhe marrjes së veprimeve për të adresuar sfidat ekzistuese.

Sfidat më të theksuara me të cilat përballen organizatat buxhetore në këtë fushë janë:

- Nga gjithsej 94¹⁶ organizata buxhetore, 16¹⁷ prej tyre ose 17% nuk kishin hartuar planin strategjik. Kjo dobësi po e përcjell sidomos nivelin lokal, si dhe aty ku ekzistojnë strategjitë, ato nuk zbatohen apo monitorohen për të përcaktuar nëse objektivat po arrihen;
- Hartimi i regjistrit të rreziqeve, është ende sfidë për shumë organizata. 24¹⁸ organizata nuk kanë hartuar regjistrin e rreziqeve, shumica prej tyre janë po ashtu të nivelit lokal. Për më shumë, aty ku është hartuar ky regjistër, nuk është azhurnuar dhe monitoruar për të parandaluar gabimet dhe mangësitë në sistem;
- Situata më e mirë është me procesin e vetëvlerësimit. Vetëm dy (2) nga 94 organizata buxhetore nuk kishin plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit; dhe
- Themelimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe Komiteteve të Auditimit në të gjitha organizatat ende mbetet sfidë si dhe ka ende mungesë të stafit/auditorëve të mjaftueshëm në institucionet e sektorit publik.

Pavarësisht, se shumica e Institucioneve publike kanë hartuar dokumentet e cekura më lartë, ato ende nuk monitorohen, vlerësohen dhe nuk janë vënë në funksion të qeverisjes së mirë. Kjo për faktin, se rezultatet e auditimeve individuale kanë treguar mangësi në menaxhimin financiar dhe kontrollit në fusha të rëndësishme siç janë: investimet kapitale, subvencionet, menaxhimi i personelit, menaxhimi i pasurive etj. Ndryshimet e shpeshta të stafit në departamentin e prokurimit janë sfidë duke ndikuar negativisht në menaxhimin e kontratave, në shërbime të mira dhe vlerë për paratë e dhëna, si dhe mungesë e monitorimit dhe kontrollit për mjetet e dhëna për OJQ në sektorin e arsimit, dobësi në pranimin e mallrave dhe në fushën e personelit.

11.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrën e duhur. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të organizatave buxhetore, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Njëra nga objektivat e Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (SKBFP) 2015-2019 është avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillim profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore. Pra, rëndësia dhe ndjeshmëria e profesionit i obligon AB-të që të kenë nivelin e duhur profesional.

Njësia Qendrore Harmonizuese është koordinatorë e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjekte të sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike. Si zhvillime pozitive të kësaj periudhe në kuadër të SKBFP 2015-2019, është edhe fakti që në prill 2018 është miratuar Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe në fillim të vitit 2019 është aprovuar Udhëzimi Administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit, si dhe rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm.

¹⁶ 30 institucione të pavarura, 38 organizata të nivelit lokal, dhe 26 organizata të nivelit qendror.

¹⁷ 12 organizata të nivelit lokal dhe 2 organizata të nivelit qendror, 2 institucione të pavarura.

¹⁸ 22 organizata të nivelit lokal dhe 2 organizata të nivelit qendror

Po ashtu, situatë më e mirë ishte mbulueshmëria e vitit aktual me aktivitetet e auditimit, pasi rreth 58% e auditimeve kishin në fokus vitin aktual. Ndërsa, sa i përket veprimeve të ndërmarrja nga menaxhmenti i OB-ve në zbatimin e rekomandimeve, kemi vërejtur se 51% e rekomandimeve të dhëna kishin gjetur zbatim të plotë përderisa, pjesa tjetër ishin në proces apo të pazbatuara.

Mangësitë e vërejtura në sistemin e auditimit të brendshëm i kemi paraqitur në vijim:

UA nr. 23/2009 dhe rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm përcakton kriteret që duhet plotësuar për themelimin e NjAB-së, dhe përcakton numrin minimal të auditorëve që duhet të ketë OB-ja. Kemi identifikuar se tetë (8) komuna¹⁹ përkundër që e plotësojnë kriterin, nuk e kishin të themeluar NjAB. Përderisa, nga 72 OB që kanë NjAB-në, në 35 prej tyre kishin numër të auditorëve më pak se sa që e parasheh qoftë udhëzimi në fuqi për vitin 2018 apo edhe rregullorja e re; dhe

Themelimi i Komiteteve të Auditimit (KA) në të gjitha organizatat ende mbetet sfidë. Nga 72 OB që kishin të themeluara NjAB, në 55 prej tyre Komitetet e Auditimit ishin funksionale, dhe kishin mbuluar 61 njësi të auditimit të brendshëm. Megjithatë vlen të theksohet se në gjashtë komuna²⁰ kjo ishte bërë në vitin 2019. Më tej, nga 55 OB ku funksiononte KA, është vërejtur se në 16 prej tyre kishin mbajtur më pak se katër (4) takime vjetore të punës. Kjo tregon se KA-të ende nuk janë efektive për të mbështetur plotësisht punën e NjAB-së.

Auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve. Sistemi i kontrollit të brendshëm përkundër përmirësimeve nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, dhe ky është tregues se NjAB duhet të forcohen më tutje për të vepruar si mekanizëm parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

11.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti duhet të instaloj mekanizma raportues dhe monitorues në baza të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosja e rezultateve në mënyrë transparente.

Drejtuesit e OB-ve, ndonëse kanë zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të mangëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Nga auditimet individuale të kryera nga gjithsejtë 94²¹ organizata, në 52²² prej tyre kemi evidentuar dobësi në kontrollet menaxheriale dhe llogaridhënie. Institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal vazhdojnë të operojnë me kontrolle jo efektive në fushën e investimeve kapitale, subvencioneve, personelit, menaxhimit të pasurive, të hyrave, llogarive të arketueshme si dhe detyrimeve kontigjente. Si rezultat i mungesës së kontrolleve kemi një numër të madh të ekzekutimit të

¹⁹ Komuna si: Zubin Potoku, Mamusha, Mitrovica Veriore, Parteshi, Leposaviqi, Zveçani, Klllokoti dhe Hani i Elezit

²⁰ Obiliq, Malishevë, Viti, NovoBrda, Juniku dhe Mitrovica.

²¹ 30 institucione të pavarura, 38 organizata të nivelit lokal, dhe 26 organizata të nivelit qendror.

²² 4 institucione të pavarura, 35 organizata të nivelit lokal dhe 13 organizata të nivelit qendror.

pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe nga Thesari si rezultat i vonësive në kryerjen e obligimeve me kohë nga organizatat. Gjithashtu, janë kryer pagesa nga fondi i shpenzimeve të pa parashikuara (rezervat) për rastet të cilat nuk trajtohen si raste urgjente, duke mos shpjeguar rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojat shtesë, dhe arsyet pse nuk janë parashikuar me ligjin e buxhetit. Përveç kësaj, formati aktual i raportimeve menaxheriale në nivel lokal nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive, pasi që raportimi me shkrim tek drejtuesit e lartë, të shumtën e rasteve bëhet vetëm sipas kërkesave, dhe jo në baza të rregullta.

Përderisa, shumica e Institucioneve të pavarura, kanë vendosur kontrolle efektive në menaxhimin e financave publike. Megjithatë, në dy institucione auditimi ka identifikuar mangësi në llogaridhënie, përmbushje të funksionit dhe misionit. Konsolidimi i organeve funksionale²³, mbetet ende sfidë e cila nuk varet direkt nga Institucionet e pavarura si dhe azhurnimi i Strukturës Organizative sipas mandatit dhe misionit të institucioneve.

Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën. Nga auditimet individuale të kryera nga gjithsejtë 94²⁴ organizata, 24²⁵ ose 26% nuk kanë hartuar regjistër të rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së. Prej tyre, dy (2) ishin të nivelit qendror dhe 24 të nivelit lokal. Për më shumë, në tetë (8) institucione si në nivelin qendror dhe atë lokal dhe në dy (2) institucione të pavarura edhe pse e kishin hartuar regjistrin e rreziqeve ajo nuk ishte monitoruar dhe as azhurnuar. Një numër i vogël i institucioneve publike e kanë trajtuar seriozisht menaxhimin e rrezikut, duke e vënë në funksion të parandalimit dhe evitimit të gabimeve, ndërsa shumica e institucioneve nuk i ka shfrytëzuar përfitimet nga monitorimi i regjistrit të rreziqeve. Kjo e ka pamundësuar reagimin e menjëhershëm nga ana e menaxhmentit për adresimin dhe menaxhimin e rreziqeve të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Të sigurohet se të gjitha organizatat hartojnë regjistër të rreziqeve, duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve përmes veprimeve të duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.
- Të sigurohet përmes monitorimit se menaxhmenti i organizatave buxhetore të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, sa më parë t'i themelojnë këto njësi si dhe t'i plotësojnë me staf, përmes së cilave do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Ndërsa, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtrojnë përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore; dhe
- Të sigurohet se subjektet e sektorit publik themelojnë Komitetet e Auditimit, të cilat duhet të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së dhe ta mbështesin arritjen e objektivave.

²³ Bordi Mbikëqyrës dhe Komisionet.

²⁴ 30 institucione të pavarura, 38 organizata të nivelit lokal, dhe 26 organizata të nivelit qendror.

²⁵ 22 organizata të nivelit lokal dhe 2 organizata të nivelit qendror.

12 Prokurimi

Në vitin 2018, institucionet publike përmes procedurave të prokurimit publik kanë kontraktuar 30% të buxhetit të Kosovës, duke nënshkruar 12,412 kontrata (përfshirë aneks kontratat) në vlerë të përgjithshme prej 631,622,686€. Me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit, në 2018, sistemi i prokurimit publik edhe mëtej është avancuar. Në shtator të vitit 2018, është kërkuar që institucionet publike t'i publikojnë të gjitha kontratat e nënshkruara. Shumica e kontratave të nënshkruara pas kësaj kërkesë ishin publikuar në platformën elektronike të prokurimit.

Po ashtu, një nga zhvillimet kryesore në fushën e prokurimit publik për vitin 2018 ishte edhe rritja e shfrytëzimit të platformës së prokurimit elektronik. Nga janari 2018, të gjitha procedurat me vlerë mbi 10,000€ janë zhvilluar përmes e-prokurimit, nga inicimi i procedurës deri në nënshkrimin e kontratës, ndërsa për procedurat deri në 10,000 euro nuk ishte përdorur çdo herë e-prokurimi. Në fund të vitit, është arritur që të gjitha ofertat të dorëzohen në mënyrë elektronike. Këto zhvillime kanë ndikuar në zvogëlimin e kontaktit fizik mes Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik, është mundësuar monitorimi në kohë reale i aktiviteteve, si dhe është rritur transparenca.

Përkundër avancimeve në sistem, auditimi i vitit 2018 ka identifikuar se aktivitetet e prokurimit vazhdojnë të përcjellën me mangësi duke filluar nga planifikimi i prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit, deri te menaxhimi i kontratave. Gjatë vitit 2018, ishin nënshkruar 499 kontrata jashtë planit të prokurimit. Prej tyre , pjesën më të madhe e përbëjnë komunat me afro 72%, institucionet qendrore me mbi 15%, ndërsa institucionet e pavarura me afër 13%.

12.1 Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit

Raportet individuale të auditimit edhe për vitin 2018 kanë treguar se rekomandimet e viteve të kaluara nuk po gjejnë zbatim të mjaftueshëm prandaj edhe i tërë procesi i prokurimit po vazhdon të përcillet me mangësi. Vlen të theksohet se institucionet e pavarura qëndrojnë më mirë në zbatimin e procedurave të prokurimit, pasi që dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit janë identifikuar vetëm në tri institucione²⁶. Ndërsa, për 15 institucione të pavarura, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga AQP.

Përveç institucioneve të pavarura, përmirësim në zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin 2018 kishin edhe gjashtë komuna, në të cilat auditimi nuk ka identifikuar ndonjë dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit²⁷.

Tabela në vijim paraqet çështjet kryesore të cilat janë hasur në institucionet e nivelit qendror apo nivelit lokal.

²⁶ Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia për menaxhimin e komplekseve memoriale.

²⁷ KK Kamenicë, KK Viti, KK Mamushë, KK Zubin Potok, KK Han i Elezit dhe KK Graçanicë (në Graçanicë është identifikuar vetëm nënshkrimi i dy kontratave të njëjta me kontrata të centralizuara ekzistuese).

Tabela 27 - Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit

Çështja	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga organizatat buxhetore
Planifikimi jo i duhur i aktiviteteve të prokurimit kishte ndikuar që të ketë numër të madh të aneks kontratave dhe aktiviteteve jashtë planit të prokurimit.	Vlerësimi i dobët i nevojave dhe nevoja për aneks kontrata ndikon në mosrealizimin me kohë të projekteve dhe dëmtimin potencial të buxhetit.	Të kryhen analiza më të detajuara të nevojave, para finalizimit të planit të prokurimit, në mënyrë që të dihet saktë se çfarë do të prokurohet gjatë vitit dhe të shmanget sa më shumë nevoja për aneks kontrata.
Hyrja në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontratat pa buxhet të mjaftueshëm në dispozicion.	Hyrja në obligime përtej mjeteve të aprovuara me buxhet, rrezikon mbarëvajtjen dhe mos implementimin në kohë të projekteve si dhe dëmtimin e buxhetit të dedikuar për projekte tjera.	Të ndërpriten praktikatat e hyrjes në detyrime kontraktuale nëse më parë nuk janë zotuar fondet e mjaftueshme që sigurojnë përfundimin e projekteve sipas kontratës.
Zhvillimi i procedurave pa hartimin e projekteve ekzekutuese dhe fillimi i projekteve pa sigurimin e parakushteve për implementim.	Inicimi i procedurave në mungesë të projekteve të hartuara si dhe hartimi i projekteve ekzekutuese jo në pajtueshmëri me specifikacionet teknike, rezulton me mos përfundim të projekteve në afatet e parapara, pamundëson planifikimin e vlerës reale të investimeve dhe kosto shtesë të projekteve.	Të sigurohet se kërkesat ligjore janë aplikuar në mënyrë strikte, e që sigurojnë se hartimi i projekteve kryesore është bërë në përputhje me kushtet në terren në mënyrë që zbatimi i tyre të realizohet në kohë dhe pa shpenzime shtesë.
Lidhja e kontratave duke anashkaluar procedurat e prokurimit.	Lidhja e kontratave në mungesë të procedurave të prokurimit përveç që dëmton transparencën, dhe eliminon konkurrencën. Po ashtu, mund të rezultojë me vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.	Të sigurohet se janë zhvilluar procedurat e prokurimit për çdo blerje për të cilën kërkohet një gjë e tillë. Zhvillimi i procedurave dhe nënshkrimi i kontratës në përputhje me LPP është i obligueshëm dhe duhet të sigurojë transparencë, konkurrencë dhe vlerë për para.
Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik që nuk i kanë plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë së dosjes së tenderit.	Anashkalimi i kritereve të dosjes së tenderit rritë rrezikun e nënshkrimit të kontratave me OE të pa përgjegjshëm. Kjo rritë mundësinë e diskriminimit të operatorëve tjerë konkurrues.	Të sigurohet se gjatë vlerësimit janë zbatuar me përpikëri të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit dhe se asnjë operator i pa përgjegjshëm nuk është shpërblyer me kontratë.

Vonesat në përfundimin e projekteve kapitale si dhe mos aplikimi i ndëshkimeve për vonesa.	Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që AK-të të mos arrijnë objektivat e përcaktuara. Mos aplikimi i ndëshkimeve është dëmtrim i buxhetit.	Të sigurohet se janë analizuar shkaqet që kanë ndikuar në mos realizimin e punimeve sipas planeve dinamike në mënyrë që të parandalohen vonesat dhe të sigurohet se projekti vihen në përdorim sipas planit. Po ashtu, në rast të vonesave të aplikohen ndëshkimet në pajtim me ligjin.
Mos konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit apo vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit për kohë më të shkurtër se kohëzgjatja e parashikuar me kontratë.	Mos konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës dhe siguria e ekzekutimit për kohë më të shkurtër se kërkesat e kontratës, rrisin rrezikun që OE të mos i përmbushin obligimet e tyre kontraktuale e rrjedhimisht mos të arrihen objektivat e AK-ve.	Me qëllim të përmbushjes së kontratës, siguria e ekzekutimit duhet të kërkohe në përputhje me nevojat dhe sa herë që kontrata nuk është përmbushur me kohë apo sipas specifikave, kjo siguri duhet të konfiskohet.
Mos caktimi i menaxherëve të kontratave, mungesa e planeve për menaxhimin e kontratave dhe menaxhimi i dobët i kontratave.	Mangësitë në procesin e menaxhimit të kontratave, pamundësojnë mbarëvajtjen e kësaj faze dhe pamundësojnë vlerësimin se si po realizohet kontrata duke mos ofruar siguri se kontratat realizohen konform kushteve dhe specifikave të parapara.	Të sigurohet se pas lidhjes së çdo kontrate është caktuar personi përgjegjës për menaxhimin e saj, i cili duhet të bëjë përcjelljen e përmbushjes së kontratës sipas të gjitha kërkesave dhe standardeve të parapara.
Pagesa për punë të pakryera dhe pa dëshmi të mjaftueshme.	Kryerja e pagesave pa u pranuar punët dhe kryerja e pagesave pa dëshmi të mjaftueshme, rritë rrezikun që pagesat të bëhen e punët mos të përfundohen asnjëherë.	Të sigurohet se asnjë pagesë nuk realizohet para se punët të jenë kryer, të jenë pranuar punët, mallra apo shërbimet dhe se ka dëshmi të mjaftueshme që mbështesin punët e kryera.

Rekomandojmë Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Financave që të siguroj se:

- Platforma elektronike e prokurimit publik po shfrytëzohet plotësisht në të gjitha organizatat;
- Ndryshimet në rregullat e prokurimit publik përvetësohen me kohë nga organizatat buxhetore;
- Asnjë AK nuk zhvillon procedura të prokurimit dhe as nuk nënshkruan kontrata për blerje të njëjta për të cilat veç ekzistojnë kontrata të centralizuara të lidhura nga AQP; dhe
- Janë identifikuar dhe eliminuar shkaqet të cilat ndikojnë në përsëritjen e mangësive të njëjta vit pas viti në të gjitha fazat e prokurimit.

13 Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore

Në auditimet e kryera të pasqyrave individuale për organizatat buxhetore ka pasur raste të mos pajtueshmërisë së caktuara me dispozitat ligjore (përfshirë këtu mangësitë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, punësimit, menaxhim personeli dhe procedimit të pagesave, të cilat janë trajtuar nëpër kapituj të veçantë të RVA-së). Megjithatë janë përzgjedhur raste që kanë të bëjnë me sfidat ligjore të një rëndësi të veçantë të cilat do raportohen, si vijim.

MKRS - Mos përputhje mes ligjit organik me ligjin për administratën shtetërore - Ligjet organike me të cilat rregullohet veprimtaria e Institucioneve vartëse të kulturës në MKRS në shumë raste janë në konflikt me ligjet e përgjithshme mbi bazën e të cilave duhet të funksionojë ministria. Drejtorët e këtyre institucioneve raportojnë në departamentin e kulturës, edhe pse Ligji për Administratën Shtetërore, Rregullorja për Standardet e Organizimit të Administratës Shtetërore dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MKRS, e përcaktojnë shumë qartë se të vetmet njësi organizative që departamentet mund t'i kenë në vartësi, janë divizionet e përafërta.

Po ashtu, institucionet e trashëgimisë kulturore nuk janë të rregulluara me ligje të veçanta, dhe raportojnë tek Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS. Veprimtarinë e tyre e mbështesin në ligjin për trashëgiminë kulturore (përveç Muzeut të Kosovës, i cili bazohet në ligjin për institucionet e kulturës). Në bazë të këtij rregullimi, këto institucione nuk kanë të drejtë të kenë kode buxhetore dhe të menaxhojnë me buxhetin e tyre, mirëpo këto duhet të kryhen nga ana e ministrisë. Ndërkaq, ne kemi vërejtur se këto institucione bëjnë shpenzime në kundërshtim me rregullimin ligjor ekzistues të tyre. Për më tepër kjo çështje ishte prezantuar edhe në raportin e vitit të kaluar, por ekipi i auditimit nuk kishte vërejtur që Qeveria/MKRS ka ndërmarr veprime për rregullimin e kësaj çështje.

Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës dhe MKRS

Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Kulturës, duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të institucioneve vartëse me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu, menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse apo delegimi i disa funksioneve të caktuara tek njësitë vartëse.

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës - Mos sigurimi i vazhdimit të licencës për administrimin e mbeturinave - KMDK menaxhon Deponitë e Mbeturinave në rreth 70% të territorit të Kosovës. Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 (neni 16 -pika 1), përcakton “Mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bënë vetëm personi i licencuar”. Edhe përkundër përpjekjeve për sigurimin e licencës, kompania ende vazhdon të operoj me licencë të përkohshme prej vitit 2012, për shkak të mos përgjigjes nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Mos sigurimi i tarifores për deponimin e mbeturinave - Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 neni 14 pika 2, përcakton se “Në bazë të dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike , Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në marrëveshje me Komunat përkatëse përcakton tarifat për deponimin e mbeturinave komunale në deponit e caktuara”. KMDK nuk kishte arrit të siguroj tarifën sipas kësaj

kërkese dhe ende vazhdon që shërbimet e veta t'i faturoj në bazë të tarifores së trashëguar që nga viti 2012. Kjo tarifore (e skaduar) mbulon vetëm mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë me vlerë 5.31€/ton. Kompania vazhdon të pranojë lloje tjera të mbeturinave për të cilat nuk kishte licencë as tarifore, siç janë: deponimin e qelqit, gomës, mbeturinat e dheut dhe gurëve, mbetje shtazore dhe asgjësimin e mbeturinave të doganës. Për këto lloje të mbeturinave, Bordi i Drejtorëve të kompanisë në janar të 2016 kishte caktuar tarifën në vlerë prej 50€/ton. Ketë veprim kompania e kishte bërë shkak i mos përgjigjes nga organi kompetent për caktimin e tarifave, respektivisht MZHE. Për më tepër, këto dy çështje janë potencuar edhe në raportin e vitit të kaluar.

Të Kompania Rajonale e Mbeturineve „Uniteti-SH.A” Mitrovicë - Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese. Sipas nenit 34.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Po ashtu, Neni 7.2 i Statutit të kompanisë kërkon që kompania të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë. Kompania nuk kishte përgatitur rregullore për menaxhimin e pasurisë, e cila duhej të përshtatej me nevojat dhe kërkesat e kompanisë bazuar në standardet dhe ligjet në fuqi. Kjo ka ndikuar që pasuria gjatë vitit të mos menaxhohej në mënyrë adekuate. Rrjedhimisht, regjistri i pasurisë së kompanisë është i mangët pasi që në të nuk janë përfshirë të gjitha ato pasuri të cilat ishin me vlerë zero, por që ishin ende në përdorim.

Kompania Rajonale e Mbeturineve „Uniteti - SH.A” Mitrovicë - Mungesa e rregulloreve përkatëse Sipas Ligjit për NP neni 34.1, të gjitha NP-të do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare” si dhe neni 7.2 i Statutit të kompanisë thekson që kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë. Kompania nuk kishte përgatitur ndonjë rregullore për të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme në të cilat duhet të përcaktohen procedurat për të hyrat, për provizionimin e borxheve të këqia dhe për mënyrën e trajtimit të tyre. Për më tepër, kompania nuk kishte nxjerrë rregullore që përcakton nivelizimin e koeficientëve të pagave e cila përmban dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë.

Kompania Rajonale e Mbeturineve „Uniteti-SH.A” Mitrovicë - Mos publikimi i dokumenteve në faqen e internetit të kompanisë. Sipas nenit 34.2 të Ligjit për NP, një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohen dhe mbahen në një faqe në internet me çasje publike e cila mirëmbahet nga NP-ja. Në faqe të internetit duhet të publikohet plani i biznesit, raportet tremujore, raportet vjetore dhe informatat tjera të rëndësishme për publikun. Kompania ende nuk kishte funksionale një faqe interneti ku do të publikohen rregulloret dhe raportet e saj. Kjo gjendje ka ndodhur për shkak që nuk kishte mjete financiare të mjaftueshme për të zhvilluar faqen e internetit.

Rekomandimet Qeverinë, Komunat dhe Bordet përkatëse të Ndërmarrjeve publike

- Qeveria duhet të shqyrtoj çështjen e operimit pa licencë pune të Ndërmarrjes publike KMDK dhe në bashkëpunim me MMPH dhe Bordin Drejtues të kësaj Ndërmarrje, brenda një afati të arsyeshëm, të njëjtën ta pajis me licencë valide të punës;
- Në bashkëpunim me MZHE, të zgjidhin problemin e përcaktimit të tarifave për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave për nevojat e KMDK-së;
- Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit të NP “Unitetit duhet të sigurojë që të hartohen rregulloret e brendshme për menaxhimin e pasurive, ku përcaktohen procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, tjetërsimin e pasurive dhe regjistrin e plotë dhe të saktë të pasurive, si dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e saj;
- Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit të NP “Uniteti” duhet të sigurojë që janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për nxjerrjen e rregulloreve përkatëse për trajtimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme në funksion të përmirësimit të kontrolleve të brendshme duke përcaktuar procedura dhe kontrolle të qarta, në mbështetje të standardeve dhe rregullave në fuqi; dhe
- Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj krijimin dhe funksionimin e ueb-faqes së internetit me të dhënat e kompanisë dhe të publikojë të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji i ndërmarrjeve publike, me qëllim të transparencës ndaj palëve të interesit.

14 Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit, viteve të fundit po i kushton një rëndësi të shtuar auditimeve të performancës me qëllim që të promovoj llogaridhënien lidhur me efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomizimin e fondeve publike.

ZKA, gjatë vitit 2018, në fokus të auditimit kishte disa fusha me interes shoqëror dhe ekonomik, siç janë: grantet dhe subvencionet në bujqësi, siguria në komunikacion, procesi i politik bërjes, mjedisin, politikat e punësimit, banimit social, menaxhimi i të hyrave vetjake, vlerësimi i sistemeve të TI në nivel vendi, barnat esenciale për qytetarët, dhe auditime për zbatim të rekomandimeve në fushën e shëndetësisë. Qasja e aplikuar në auditimet e performancës reflekton kornizën e inkorporuar në standardet e ONISA, bazuar në 3 E²⁸-të.

Përveç kësaj ne kemi kryer edhe Vlerësimin e sistemeve të TI në nivelin qendror dhe lokal, ku nga 105 OB, ne kemi mbuluar 37 organizata të nivelit qendror dhe 26 komuna. Gjatë këtij sezoni, janë publikuar 10 raporte të auditimit të performancës të fushave të ndryshme dhe përmes këtyre raporteve kemi dhënë 131 rekomandime për entitetet e audituara. Në vijim janë përmbledhur raportet e auditimit të performancës²⁹.

Në vijim, shkurtimisht është paraqitur përmbajtja e raporteve të performancës, përfshirë objektivin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

(a) Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave të punësimit

Shkalla e papunësisë në vend është alarmante, prandaj politikat në nivel qeveritar dhe sektorial duhet të shërbejnë si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar të papunësisë në vend. Kjo mund të arrihet përmes një planifikimi adekuat të kapaciteteve të nevojshme njerëzore e financiare për implementim të politikës si dhe përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm monitorues.

Mesazhi i auditimit - Konkluzioni i auditimit është se politikat e punësimit në nivel qeveritar dhe sektorial nuk janë efikase dhe efektive. Procesi i planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave të punësimit, si në nivel qeveritar ashtu edhe atë sektorial, është karakterizuar me mangësi të shumta, të cilat kanë ndikuar të mos arrihet promovimi dhe rritja e punësimit.

Zyra e Kryeministrit nuk i ka paraprirë një vlerësimi të duhur të aspekteve të punësimit, me theks të veçantë, nuk janë definuar qartë përgjegjësitë e ministrive të linjës si dhe nuk është bërë identifikimi i plotë i burimeve financiare. Prioritetet strategjike që ndërlidhen me punësim si dhe objektivat sektoriale të punësimit, nuk janë monitoruar si duhet pasi që monitorimi nuk është bazuar në analiza të mirëfillta. Zbatimin e masave proaktive të tregut të punës, sidomos gjatë vitit 2017 e kanë vështirësuar vonesat e mëdha në funksionalizimin e Agjencisë së Punësimit, mungesa e profilizimit të një numri të papunëve, përpilimi i listave me numër të kufizuar të papunëve për t'iu nënshtruar procesit të përzgjedhjes, si dhe

²⁸ Ekonomia - minimizimin e kostos së resurseve të përdorura në një aktivitetet, duke marrë e ruajtur cilësinë; Efikasiteti - relacioni ndërmjet outputeve (daljeve) në kuptim të mallrave, shërbimeve, rezultateve dhe resurseve të përdorura për prodhimin e tyre; dhe Efektiviteti - shkalla e arritjes së objektivave dhe relacioni ndërmjet ndikimit të synuar dhe ndikimit aktual të një aktiviteti.

²⁹ Raportet e plota individuale mund t'i gjeni: <http://www.zka-rks.org/publications/>

mungesa e prioritizimit të papunëve afatgjatë gjatë procesit të përzgjedhjes. Këto mangësi pamundësojnë identifikimin e të papunëve që kanë probabilitet më të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë, nuk ofrojnë mundësi të barabarta për një numër të konsiderueshëm të papunëve, si dhe ndikojnë në rritjen e numrit të të papunëve afatgjatë.

(b) Efektiviteti i programeve të veçanta të banimit

Qeveria nuk ka arritur të krijojë mekanizma të qëndrueshëm që do të ndihmonin në zbatim, koordinim dhe monitorim të Programeve të Veçanta për Banim, dhe si rezultat Programi i Veçantë për Banim nuk funksionon si duhet. Si pasojë shumica e atyre që kanë nevojë për banim social, nuk kanë arritur të përfitojnë dhe shumë qytetarë do të vazhdojnë të jetojnë në objekte të rrezikshme ose të papërshtatshme për banim.

Mesazhi i auditimit - *Konkluzioni i auditimit është se Programi i Veçantë i Banimit nuk performon mirë. Janë disa arsye, pse ky program nuk është duke performuar mirë.*

Së pari, programi nuk financohet mjaftueshëm dhe resurset në dispozicion nuk janë alokuar në mënyrë efektive. Suksesi i programit në masë të madhe varet nga ndërtimi i banesave të reja/të shtrenjta. Si pasojë e kësaj, është e vështirë për komunat që të gjenerojnë fonde të mjaftueshme për t'i përmbushur të gjitha kërkesat e banimit. Për më shumë, burimet në dispozicion nuk ndahen në vazhdimësi tek qytetarët që kanë më shumë nevojë, dhe ka raste që përfitojnë njerëz të cilët nuk e gëzojnë këtë të drejtë dhe jetojnë në banesat e dedikuara për këtë program.

Së dyti, performanca dhe praktikat mes komunave janë dukshëm të ndryshme, dhe në anën tjetër kriteret e komplikuar shtetërore nuk aplikohen në mënyrë konsistente, duke rezultuar në parregullsi të shpeshta dhe në rezultate të padëshiruara. Banesat e destinuara për këtë program kryesisht janë të ndërtuara në zona urbane, dhe për pasojë aplikuesit që jetojnë në zona rurale kanë shumë pak mundësi të marrin një shtëpi në zonat ku ata jetojnë.

Së treti, ka mangësi sa i përket sistemit të informimit, monitorimit dhe inspektimit. Qeveria dhe komunat nuk kanë zhvilluar një sistem për të identifikuar nevojat për banim social, dhe për pasojë, nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me numrin e atyre që kanë nevojë për këtë program.

(c) Menaxhimi i të hyrave vetjake në nivelin lokal

Menaxhimi i të hyrave vetjake në nivelin lokal të qeverisjes nuk është duke u zhvilluar sipas praktikave të mira. Qeveria nuk ka arritur të jetë plotësisht efektive dhe efikase gjatë gjithë procesit, si nga niveli qendror, ashtu edhe nga ai lokal me qëllim të arritjes së objektivave komunale drejt përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Përcaktimi i tarifave për shërbime komunale dallon nga një komunë në tjetrën, dhe si pasojë kostot për shërbime të njëjta, janë dukshëm të theksuara ku ka raste që tarifat për shërbim të njëjtë janë mbi katër (4) herë më të larta. Kjo mund të shkaktojë pakënaqësi dhe të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve.

Mesazhi i auditimit - *Konkluzioni i auditimit është se Të hyrat vetjake të komunave nuk janë duke u menxhuar mirë. Arsyet për këtë janë:*

Së pari, mungesa e procedurave dhe udhëzuesve adekuat nga Ministria e Financave mbi planifikimin e të hyrave vetjake, krijon vështirësi tek komunat për aplikimin e një sistemi unik nga komunat;

Së dyti, mungesa e procedurave të brendshme komunale për procesin e planifikimit, pa zhvilluar analiza të plota lidhur me potencialin ekzistues mbi realizimin e të hyrave krijon vështirësi në planifikimin objektiv dhe realizimin e të hyrave. Çmimet për shërbimet e ofruara ndaj qytetarëve nuk janë përcaktuar në bazë të analizave dhe përlllogaritjeve adekuate; dhe

Së treti, ka mangësi sa i përket sistemit të raportimit dhe transparencës. Komunat e audituara nuk kanë arritur të kenë një raportim efektiv për të siguruar të dhëna të rëndësishme dhe informata të mjaftueshme për përdoruesit e këtyre raporteve. Komunat nuk e kanë të vendosur një proces formal dhe funksional i cili do të siguronte transparencë për identifikimin e nevojave nga qytetarët e deri tek aprovimi i projekteve nga Kuvendet Komunale.

(d) Vlerësimi i sistemeve të TI në nivelin qendror dhe lokal

Organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe lokal kanë mangësi të theksuar në qeverisjen e teknologjisë informative. Rreth 70% e tyre kanë mungesë të strategjisë, politikave dhe procedurave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë informative, strukturë jo të përshtatshme organizative të departamentit të Teknologjisë Informative. Po ashtu, duhet theksuar se, për disa Organizata Buxhetore të cilat kanë deklaruar se posedojnë dokumentacionin e duhur, pas rishikimit të tyre është vërejtur se ato dokumentacione nuk janë të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse. Mungesa e tyre rrezikon mos arritjen e objektivave të organizatës buxhetore si dhe mund të rrezikon sigurinë e informacionit. Mos përdorimi i këtyre shërbimeve sjellë rreziqe dhe cenueshmëri për të dhëna që përpunohen.

Mesazhi i auditimit - *Konkluzionet e auditimit janë se në fushën e teknologjisë informative ekzistojnë mangësi të shumta në qeverisjen e teknologjisë informative, siguri të informacionit dhe kontrolle të dobëta në sistemet informative. Nga auditimet e kryera vërehet se përkundër investimeve në këto aplikacione, asnjëri nga to nuk e ka arritur objektivin e plotë për të cilin janë financuar. Për më shumë, edhe pse disa prej tyre janë vënë në funksion diku prej vitit 2010, ende nuk janë në funksionalizuar plotësisht. Përveç auditimeve, edhe nga pyetësorët është vërejt që ekzistojnë edhe aplikacione paralele që kryejnë funksionin e njëjtë me këto, e cila ka pasur për pasojë edhe kosto shtesë buxhetore. Kjo ka ndodhur si pasojë mungesës së një plani apo strategjie të detajuar për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e tyre, mungesës së trajnimeve për shfrytëzimin e tyre, mungesës së kapaciteteve profesionale, mungesës së vëmendjes mbi sigurinë e këtyre aplikacioneve si dhe sigurisë së të dhënave që ato përmbajnë.*

(e) Menaxhimi i listës esenciale të barnave

Institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht synimet e parapara përmes Listës Esenciale të Barnave. Procesi i planifikimit, shpërndarjes dhe monitorimit të barnave, si në nivelin dytësor, ashtu edhe në atë tretësor, është përcjellë me mangësi. Si pasojë, qytetarët nuk i marrin barnat të cilat u takojnë në kohën kur u nevojiten.

Mesazhi i auditimit - Konkluzioni i auditimit është se Menaxhimi i Listës së barnave nuk është bërë në mënyrë efektive dhe efikase. Janë disa arsye të cilat kanë ndikuar në mos përmbushjen e objektivave të synuara përmes Listës Esenciale të Barnave.

Së pari, Lista esenciale e barnave nuk është azhurnuar që nga viti 2013 dhe ekziston rreziku që barna të rëndësishme dhe me kosto efektive mos të jenë në këtë listë. Rreth 30% e barnave nuk porositen asnjëherë, ndërsa ka barna të rëndësishme të cilat janë kërkuar në vazhdimësi mirëpo nuk janë përfshirë në listën esenciale. Për vitet 2015-2017, Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka shpenzuar rreth 3.5 milionë euro për barna dhe material shpenzues jashtë listës esenciale.

Së dyti, për shkak të planifikimit jo të duhur, spitalet nuk kanë barna kur ato u nevojiten. Planifikimi vjetor i barnave deri te aprovimi final pëson ndryshime në pajtim me buxhetin në dispozicion, mirëpo këto ndryshime nuk janë të dokumentuara se cilit bar i është dhënë përparësi. Si pasojë e kësaj janë bërë ndryshime edhe në barnat vitale, efekti i të cilave mund të jetë fatal për pacientin. Në vitin 2016 ka bar vital që është reduktuar deri në 74% të sasisë fillestare të planifikuar. Një faktor tjetër që ka ndikuar në mungesë të barnave është edhe vonesa në procesin e shpërndarjes së tyre.

Së treti, Ministria e Shëndetësisë dhe Institucionet Shëndetësore nuk bëjnë monitorime të procesit të planifikimit dhe shpërndarjes së barnave. Ndërsa, Fondi për Sigurime Shëndetësore nuk harton raporte monitorimi për të prezantuar sasinë e shpërndarë në çdo tremujorë, vlefshmërinë e kontratave të secilit barë në mënyrë të vazhdueshme dhe gjendjen e stokut në fund të çdo viti.

(f) Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Në vitet 2015-2017, mesatarisht janë kontraktuar rreth 428 milionë euro për vit përmes prokurimit publik. Prej këtyre 428 milionëve, mesatarisht diku 13% janë kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë që në krahasim me Bashkimin Evropian është dyfish më e lartë. Marrë parasysh rëndësinë që ka përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar nëse Autoritet Kontraktuese e kanë arsyetuar dhe dokumentuar mjaftueshëm përdorimin e kësaj procedure si dhe nëse kanë arritur çmime më ekonomike.

Mesazhet e auditimit - Konkluzionet e auditimit janë se në disa raste kontratat e negociuara kanë rezultuar me kosto më të lartë se kontratat me procedurë të hapur. Në mungesë të analizave të mjaftueshme, vlerësimit të nevojave dhe njohjes së tregut, autoritetet kontraktuese kanë lidhur marrëveshje kontraktuese përmes procedurës së negociuar e cila në disa raste kishte rezultuar me kosto më të lartë për shërbimet/mallrat e pranuar se sa kontratat paraprahe me procedurë të hapur apo mundësitë që ishin në treg.

Raporti thekson se asnjë nga autoritet kontraktuese të audituara nuk kishin bërë analiza të përfitimeve dhe kostove pas zbatimit të kontratave dhe kështu nuk kanë ndonjë bazë mbi të cilën do të mund të merrnin vendimet për blerjet e radhës. Katër institucionet publike që ZKA ka audituar, nuk kishin vepruar në mënyrë adekuate për të shmangur përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo për të përfituar çmimin më të mirë në rastet kur procedura me negociim ishte e pashmangshme. Një element që i kishte kontribuar kësaj gjendjeje në shumicën e Autoriteteve Kontraktues ishte mungesa e hulumtimit të tregut -

identifikimi i furnizuesve potencial dhe identifikimi i zgjidhjeve që ofrojnë ata. Si pasojë, 65% e kontratave të audituara përmes procedurës së negociuar ishin lidhur në kushte minimale të konkurrencës. Prej tyre afër 47% me vetëm një operator ekonomik dhe 18% e tyre me vetëm dy operator ekonomik. Kjo mënyrë e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve si dhe punëve, nuk është transparente dhe nuk garanton se autoriteti kontraktues ka marrë vlerën e pritur për parane e shpenzuar. Me disa përmirësime në aspektin e hulumtimit të tregut dhe të analizës së kontratave paraprake, autoritetet kontraktuese të audituara do të mund të siguronin konkurrencë më të lartë dhe çmime më ekonomike.

(g) Zhvillimi i kapaciteteve në procesin e bërjes së politikave dhe koordinimit në Kosovë

Ky raport i auditimit është realizuar në bazë të marrëveshjes ndërmjet ZKAK dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Qëllimi i këtij auditimi ishte të bëhet një vlerësim afatmesëm i Projektit për zhvillimin e politikave. Projekti në përgjithësi ka arritur rezultate të rëndësishme duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e politikave brenda Qeverisë, duke futur mekanizma për kryerjen e analizave të politikave, analizën e ndikimit dhe mekanizmat mbështetës për përfshirjen efektive të shoqërisë civile. Pavarësisht kësaj, ekziston rreziku që pas përfundimit të Projektit, Qeveria nuk do të ketë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme për të kryer analizat e nevojshme të ndikimit ekonomik, planifikimit strategjik dhe komponentëve të tjera të procesit për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit.

Mesazhet e auditimit - Konkluzionet e auditimit janë se ekziston një efektivitet i ultë dhe dhe jo i qëndrueshëm në procesin e zhvillimit të politikave. Arsyet për këtë janë:

Së pari, komunikimi nuk është i mjaftueshëm në mes të Projektit dhe përfituesve të synuar. As Qeveria, e as Projekti, nuk kanë zhvilluar një sistem për të identifikuar nevojat në vazhdimësi për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e procesit të bërjes së politikave. Mungesa e komunikimit interaktiv nga ekspertët afatgjatë të Projektit me ministritë e linjës dhe departamentet e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) mund të krijoj vështirësi në identifikimin e qartë të nevojave të tyre zhvillimore dhe plotësimin e këtyre mangësive.

Së dyti, shumica e aktiviteteve të kryera nga ekspertët afatgjatë dhe afatshkurtër duket se më shumë po i plotësojnë boshllëqet aktuale, me përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në analizën e politikave dhe legjislacionit që po zhvillohen, në komentimin e koncept dokumenteve (KD) dhe draft-politikat tjera si ekspertizë direkte. Veçanërisht, ekspertët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në analizën e ndikimit ekonomik, zhvillimin e komunikimit, planifikimin strategjik, etj. Megjithatë, kapacitetet për analiza të tilla nuk janë duke u zhvilluar brenda ZKM-së, përveç trajnimeve të kryera nga Projekti.

Së treti, komunikimi nuk është i mjaftueshëm në mes të institucioneve qeveritare, dhe në mes të Qeverisë dhe qytetarëve. Qasja që ndjekin Zyrat për Komunikim me Publikun (ZKP) për informimin e publikut është e përqendruar kryesisht në aktivitetet e institucioneve që ata përfaqësojnë sesa komunikimi interaktiv duke përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje dhe në procesin e vendimmarrjes.

(h) Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë

Për të zhvilluar sektorin e bujqësisë dhe rritjen e konkurrencës në treg, Qeveria e Kosovës ndan çdo vit fonde publike në vlerë rreth 48 milionë euro. Institucionet publike përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programeve për sektorin e bujqësisë si dhe menaxhimin e fondeve publike për këtë qëllim janë: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe komunat për zbatimin e planeve komunale në këtë sektor. Auditimi ka konkluduar se ka mangësi të theksuara të cilat rrezikojnë efektivitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë.

Mesazhi i auditimit - Konkluzionet e auditimit janë se Menaxhimi i programeve për bujqësi nuk siguron arritjen e rezultateve të synuara për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Arsyet për këtë janë:

Së pari, mënyra aktuale e menaxhimit të programeve për bujqësi nuk siguron arritjen e rezultateve të synuara për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, dhe procesi i monitorimit të programeve nuk siguron matjen e rezultateve dhe krijimin e qëndrueshmërisë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Për më shumë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar dy programe të veçanta të mbështetjes financiare në vlerë 8 milionë euro të cilat janë miratuar pa analizë paraprake. Me miratimin e tyre, Ministria ka tejkaluar buxhetin e paraparë për grante për vitin 2018. Këto programe nuk sigurojnë rezultate të qëndrueshme dhe shfrytëzim efektiv të mjeteve.

Së dyti, përkundër faktit që është hartuar Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 dhe është bazuar në parimet e Instrumentit për Asistencë në Para-Anëtarësim për Zhvillim Rural (IPARD), ende nuk janë themeluar strukturat sipas rregullave të IPARD dhe për dallim nga vendet e rajonit, Kosova nuk ka përfituruar fonde nga BE për të financuar zbatimin e masave dhe programeve të parapara për sektorin e bujqësisë. Mekanizmat e vendosur nga Ministria nuk kanë arritur të menaxhojnë si duhet procesin e dhënies së granteve dhe subvencioneve i cili është përcjellë me vonesa deri në tetë muaj sikurse që ka mangësi në vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve.

Së treti, koordinimi ndërmjet Ministrisë dhe Komunave rreth mbështetjes së sektorit të bujqësisë nuk është i mirë, pasi ka raste që fermerët për qëllime të njëjta kanë përfituruar edhe nga ministria edhe nga komuna. Po ashtu, komunat nuk kryejnë kontrolle pas dhënies së granteve apo subvencioneve dhe si pasojë nuk kanë informata nëse kanë ndikuar në përmirësimin e sektorit të bujqësisë apo nëse fondet janë përdorur për qëllimin për të cilin janë dhënë.

(i) Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje

Në fokus të këtij auditimi ishin tenderët e ndarë në lloje (pjesë) vlera e të cilëve ishte mbi 4 milionë euro ose afër 18% e totalit të vlerës së tenderëve të ndarë në lloje (22.8 milion euro). Përmes ndarjes së aktiviteteve të prokurimit në lloje, komunat e përfshira në këtë auditim, kishin tri objektiva dhe auditimi ka nxjerr në pah se katër komunat e audituara kishin arritur pjesërisht objektivat e synuara përmes ndarjes së tenderëve në lloje.

Mesazhi i auditimit - Konkluzionet e auditimit janë se ndarja e tenderëve në lloje nuk kishte arritur të nxistë zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe të rrisë konkurrencën. Është e paqartë nëse ndarja e tenderëve në lloje e ka arritur efektin e synuar të paraparë me legjislacionin të prokurimit publik që është nxitja e zhvillimit të NVM-ve dhe rritja e konkurrencës, për shkak se

komunat nuk kishin njohuri lidhur me numrin e operatorëve ekonomik në përgjithësi dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në veçanti që ushtrojnë biznes në kuadër të komunës apo në nivel kombëtar. Komunat kishin arritur vetëm pjesërisht objektivin e tyre të zbatimit paralel të kontratave për arsye të buxhetimit jo adekuat. Katër komunat kishin arritur objektivin e efikasitetit në aspektin e zhvillimit të procedurave të prokurimit, kanë përmbyllur aktivitetin e tyre të prokurimit ashtu siç e kanë planifikuar. Pra, asnjë tender nuk është anuluar për shkak të mungesës së ofertave, të gjitha kontratat janë nënshkruar në datën e planifikuar. Komunat e audituara nuk kishin vepruar siç kërkohet me Udhëzuesin operativ për prokurim publik dhe praktikrat e mira për të mbledhur informacione rreth karakteristikave të tregut dhe zhvillimeve të fundit në treg që mund të ndikojnë në konkurrencë. Si rezultat i kësaj, komunat nuk kishin pasur informacione nëse ndarja e tenderëve ishte e duhur apo jo, prandaj vendimi për ndarje të tenderëve në lloje nuk ishte i mbështetur në informata të plota.

(j) Implementimi i rekomandimeve për pajisjet mjekësore rasti “Tomografia e Kompjuterizuar”

Për të vlerësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve, kemi audituar Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si dhe Spitalet e Përgjithshme; Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. Auditimi mbulon periudhën 2015-2017.

Mesazhet e auditimit - Rekomandimet e dhëna në vitin 2015 nuk janë adresuar plotësisht. Prej tyre, shtatë rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe tri rekomandime nuk janë zbatuar fare. Për pasojë, menaxhimi dhe monitorimi i pajisjeve mjekësore me theks Tomografitë e Kompjuterizuara të vendosura në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme vazhdojnë të përcillen me mangësi thelbësore duke rrezikuar kështu profesionalizmin e stafit mjekësor dhe duke rritur rrezikun e dhënies së diagnozave jo të duhura për qytetarët e vendi. Edhe përkundër investimeve të bëra, si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes me kohë, pajisjet shpesh ishin jashtë funksionit edhe deri në gjashtë muaj gjatë vitit. Për më shumë, ka raste kur Tomografitë kanë funksionuar jashtë parametrave të rekomanduara nga prodhuesi, duke rrezikuar kështu profesionalizmin e stafit mjekësor dhe duke rritur rrezikun e dhënies së diagnozave jo të duhura për qytetarët e vendit. Më tutje, ngecjet më të mëdha mbeten edhe në aspektin legjislativ, si dhe pamundësia e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore me kapacitetet e brendshme. Megjithatë, vlen të ceket që ka një progres të lehtë në funksionimin e pajisjeve mjekësore krahasuar me periudhën kur është kryer auditimi në vitin 2015. Ky progres ka të bëjë me përshkrimin e prishjeve të Tomografisë së Kompjuterizuar në librat e ndërrimeve si dhe me themelimin e trupave mbikëqyrës. Pavarësisht, kësaj institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të ofrojnë shërbime të mirëfillta për qytetarët. Për më shumë, mos përgatitja e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve tregon mungesën e përgjegjësisë dhe vullnetit të institucioneve përgjegjëse për të përmirësuar menaxhimin e pajisjeve mjekësore e me këtë edhe ofrimin e shërbimeve mjekësore ndaj qytetarëve.

Rekomandojmë Qeverinë e Kosovës dhe Komunitet qe:

- Qeveria duhet ta sigurojë mekanizma të qëndrueshëm që do të ndihmonin në zbatimin e programeve dhe çështjen e banimit në mënyrë të duhur dhe të siguroj zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik;
- Qeveria duhet të sigurojë që politikat e hartuara do të shërbejnë si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar të papunësisë në vend. Politikat qeveritare duhet të nxisin rishpërndarjen e punësimit nëpër sektorë të ndryshëm që janë më premtues dhe që kanë potencial për vende të reja të punës;
- Qeveria duhet të ofroj përkrahje për Sistemet e Teknologjisë Informative dhe të siguroj që ato janë të besueshme, të sigurta dhe të paprekshme ndaj sulmeve kompjuterike. Qeveria duhet të sigurojë se informacioni është konfidencial dhe të ruaj integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave;
- Qeveria duhet të ndërmarrë veprimet e duhura në mënyrë që barnat esenciale dhe pajisjet mjekësore në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme të jenë në dispozicion për qytetarët gjatë tërë vitit në kohën që ju duhen;
- Qeveria duhet të jetë e fokusuar më shumë në zhvillimin e kapaciteteve në nivelin qeveritar duke rritur dhe përdorur kapacitetet e ekspertëve vendor për të kryer analizat e nevojshme të ndikimit ekonomik, planifikimit strategjik dhe komponentëve të tjera të procesit për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit;
- Qeveria duhet të siguroj se ka funksionalizuar mekanizmat monitorues dhe llogaridhënës për të vlerësuar rezultatet e arritura në sektorin e bujqësisë përmes subvencioneve dhe ndihmës nga fondet publike; dhe
- Komunitet duhet të sigurojnë arritjen e plotë të objektivave e synuara përmes ndarjes së tenderëve në lloje si dhe të kryejnë një analizë e plotë e tregut që përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave të tregut si dhe dokumentimin e tyre.

15 Ndërmarrjet publike

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), përveç organizatave buxhetore, këtë sezonë ka audituar edhe PFV-të e njëmbëdhjetë (11) Ndërmarrjeve Publike (NP) të vitit 2018. Prej tyre: tri (3) janë audituar për herë të parë nga ZKA, gjashtë (6) janë audituar për herë të dytë, dhe dy (2) për herë të tretë.

Auditimi i PFV-ve të vitit 2018, ka nxjerrë në pah se sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në NP ka nevojë për përmirësime të dukshme. Fakti që për dhjetë NP janë dhënë opinione të modifikuara, tregon për cilësinë jo të mirë të sistemeve financiare në NP. Të dhënat financiare të raportuara në Pasqyrat Financiare kishin gabime materiale dhe keqdeklarime të llogarive. Kjo, dobëson cilësinë e raportimit financiar dhe transparencën lidhur me menaxhimin e fondeve publike. Për më shumë, ne shumicën e ndërmarrjeve publike ende nuk ishte instaluar një mekanizëm i qeverisjes së mirë i cili do t'i kontribuonte zbatimit të politikave efektive që sigurojnë se objektivat janë duke u arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Gjendje veçanërisht të keqe kanë Posta e Kosovës dhe Telekom i Kosovës. Ato përveç që kanë operuar me humbje prej 18 milionësh, kanë edhe detyrime të shumta afatshkurtëra në shumë prej 60 milionësh. Në pozitë po aq të keqe është edhe KRU Hidroregjioni Jugor - Prizren, e cila ka mbi 16 milionë detyrime afatshkurtëra dhe afatgjata, si dhe Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, e cila ka mbi 5 milionë detyrime të tilla. Trendet negative financiare në këto dy kompani, jo vetëm që rrezikojnë shërbimet që ofrohen prej tyre, por rrezikojnë edhe një numër të konsiderueshëm punëtorësh që punojnë dhe janë të varur nga ekzistenca e këtyre kompanive.

Mungesa e planeve strategjike, llogaridhënies menaxheriale, raportet e mangëta tremujore, ndarja e detyrave jo adekuate, mungesa e publikimeve të rregulloreve, raporteve dhe informatave të nevojshme për qëllime të transparencës, auditime të brendshme jo efektive, dhe prezantime jo të sakta të transaksioneve dhe të zërave të pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe vet Pasqyrat financiare me gabime dhe keq deklarime, tregojnë për domosdoshmërinë e rishikimit të aranzhimeve ekzistuese. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk ishin adekuate. Ato nuk përmbajnë analiza të mjaftueshme dhe nuk marrin në konsideratë rreziqet të cilat mund të ndodhin dhe të rrezikojnë NP-të në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Bordet drejtuese të ndërmarrjeve publike nuk duket se janë mjaft kompetente dhe efikase në nxjerrjen e politikave dhe marrjes së masave për të bërë ndryshime të mëdha të gjendjes aktuale. Tendenca për t'i hedhur përgjegjësitë e dështimeve herë tek menaxhmenti, herë tek Bordet drejtuese, nuk e ndihmon daljen nga situata e vështirë e ndërmarrjeve publike. Qeveria ka ndihmuar në mënyrë permanente me subvencione disa prej tyre, por vendosja e veprimtarisë së tyre në baza të qëndrueshme, nuk duket se do të ndodhë së shpejti. Dhe, nëse nuk merren masa të menjëhershme që situata të përmirësohet, barra e dështimeve do të rëndojë edhe mbi Qeverinë, por edhe mbi komunat.

Për të përmirësuar mënyrën aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, ZKA ka dhënë një numër të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me qeverisje të NP-ve.

15.1 Opinionet e auditimit për ndërmarrjet publike

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyrë e opinionëve për PFV-të e vitit 2018.

Tabela 28 - Opinionet e dhëna për Ndërmarrjet Publike të audituara

Nr.	Ndërmarrjet e audituara	Opinionit i auditimit
1	KMDK sh.a.	Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes
2	Stacioni i Autobusëve Prishtinë sh.a.	I Kualifikuar
3	Hortikultura sh.a. Prishtinë	I Kualifikuar
4	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	I Kualifikuar
5	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren	I Kundërt
6	Posta e Kosovës sh.a	I Kundërt
7	Telekomi i Kosovës sh.a	I Kundërt
8	KRU Prishtina sh.a.	I Kundërt
9	KRM Pastrimi sh.a	I Kundërt
10.	KRM Uniteti sha. Mitrovicë	Mohim i Opinionit
11.	KRU Drini i Bardhë sh.a. Pejë	Mohim i Opinionit

Parregullsitë e identifikuar gjatë auditimit të cilat kanë shkaktuar modifikimin e opinionit, kanë të bëjnë me shkaqet si në vijim:

Opinionet e Kualifikuara - janë dhënë për shkak të mos rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese më gjatë se pesë vite, respektivisht që nga transformimi i tyre në vitin 2007 kur ishin nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për prezantim jo të drejt të rrjedhës së parasë sipas aktiviteteve (operative, financuese dhe investuese), për mos njohje të pasurive të pranuar dhe në shfrytëzim sipas kërkesave të kornizës konceptuale për raportim financiar, dhe shënimeve shpjeguese që nuk ishin të plota dhe të sakta (Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a, Hortikultura sh.a, dhe Stacioni i Autobusëve - Prishtinë sh.a).

Opinione të Kundërta - janë dhënë për shkak se informatat lidhur me llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, bilancin e gjendjes, kapitalit rezervë, pasuritë jo qarkulluese, nuk ishin rivlerësuar për më gjatë se pesë vite, rrjedhës së parasë sipas aktiviteteve (operative, financuese dhe investuese), të hyrat e shtyera nuk ishin njohur si detyrime, dyshime të konsiderueshme për të vazhduar me aktivitete sipas parimit të vijimësisë, stoqet ishin regjistruar si llogari të arkëtueshme, prezantime të pa sakta të shumave të pasurive tatimore dhe detyrimeve tatimore për TVSH, dhe shënime shpjeguese nuk ishin të plota dhe të sakta (KRU Hidroregjioni Jugor sh.a, Posta e Kosovës, Telekomi i Kosovës, KUR Prishtina sh.a, KRM Pastrimi sh.a).

Mohim i Opinionit - ZKA ka refuzuar të jap opinion të auditimit për shkak se nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit. Kufizimet në marrjen e informatave dhe pamundësia për të nxjerrë konkluzionet e qarta dhe të bazuara të auditimit, kanë shkaktuar edhe pamundësinë për të formuar një opinion të auditimit (KRM Uniteti sha. Mitrovicë dhe Drini i Bardhë sha. Pejë).

Rekomandimet për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Bordet përkatëse të Drejtorëve

- MZHE në bashkëpunim me Kryesuesit e Bordeve të Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar në Modifikimin e Opinioneve dhe të merren të gjitha veprimet e nevojshme që çështjet të cilat kanë ndikuar në opinione, të korrigjohen apo parandalohen. Gjithashtu, të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PFV të vitit 2019 i adreson të gjitha çështjet që janë ngritur nga auditimi i viti 2018. Kjo, duke ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike, përfshirë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme; dhe
- Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet e Drejtorëve të NP-ve dhe të kërkojnë llogari për përgatitjen e PFV-ve që paraqesin pamje të drejt dhe korrekte që të përmirësohet cilësia e raporteve për ndërmarrjet respektive dhe për zbatimin e rekomandimeve.

15.2 Rekomandimet e vitit paraprak

NP-të që janë audituar nga kompanitë audituese private vitin paraprak kanë rezultuar me numër më të ultë të rekomandimeve për shkak se fokusi dhe metodologjia e punës së tyre ishte e përqendruar kryesisht tek pjesa e raportimeve financiare, dhe më pak tek pajtueshmëria.

Për nivelin e zbatimit të rekomandimeve shihni tabelën me poshtë.

Tabela 29 - Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm për vitin 2017

Nr	Subjektet e audituara	Numri i rekomand.	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.	KMDK sh.a.	11	7	1	3
2.	Stacioni i Autobusëve Prishtinë sh.a.	12	2	7	3
3.	Hortikultura sh.a. Prishtinë	19	13	3	3
4.	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	13	8	2	3
5.	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizrenit	13	7	2	4
6.	Posta e Kosovës sh.a	5	1	3	1
7.	Telekomi i Kosovës sh.a	13	4	0	9
8.	KRU Prishtina sh.a.	20	13	3	4
9.	KRM Pastrimi sh.a	2	1	0	1
10.	KRM Uniteti sh.a. Mitrovicë	15	0	2	13
11.	Drini i Bardhë sh.a. Pejë	20	9	4	7
	Totali i rekomandimeve	143	65	27	51

Nga tabela më lart shihet se:

- Nga rekomandimet e dhëna në vitin paraprak, 45% prej tyre janë zbatuar, 19% prej tyre janë në proces të zbatimit, dhe 36% prej tyre edhe me tutje nuk janë zbatuar; dhe
- NP-të që janë audituar për më shumë se dy vite nga ZKA (KMDK sh.a. dhe Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.), vërehet një përpjekje me serioze në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi paraprak, madje duke e ndikuar edhe ndryshimin/përmirësimin e opinionit të auditorit për PVF e tyre.

15.3 Prokurimet në ndërmarrjet publike

Procesi i prokurimit edhe te NP-të duhet të zbatohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet ekzistuese në fushën e prokurimit publik te ndërmarrjet publike përcillen me mangësi në të gjitha fazat. Të gjitha çështjet e ngritura në këtë fushë, janë paraqitur në detaje në raportet individuale të auditimit, por në mënyrë përmbledhëse, po i praqesim edhe në tabelën në vijim.

Tabela 30 - Çështjet kryesore të cilat janë identifikuar gjatë auditimit të Ndërmarrjeve Publike

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga menaxhmenti
Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit (Në shumicën e ndërmarrjeve të audituara)	Mosfunksionim i mjaftueshëm i kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit dhe realizimit të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.	Dëmtim i buxhetit, mosarritje e vlerës për para si dhe kufizim i konkurrencës.	Të sigurohet forcimi i kontrolleve të brendshme për vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë, respektimi i kërkesave të LPP-së dhe shmangie e ndarjeve për blerjet e njëjta.
Ndarje e procedurave të prokurimit (Stacioni i Autobusëve Prishtinë, Trainkos, KRM Pastrimi, Telekom i Kosovës dhe Hortikultura)	Planifikimi jo i duhur nga njësitë kërkuese dhe mungesa e funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme.	Ndarja e kërkesave që janë të njëjta ose të ndërlidhura dëmton konkurrencën, duke rrezikuar cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.	Planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do t'i shmangë në të ardhmen nevojat për ndarjen e kërkesave si dhe zhvillim i procedurave adekuate duke ndikuar në shtim e vlerës për para.

<p>Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i procedurave të prokurimit</p> <p>(KRM Pastrimi dhe KRM Uniteti)</p>	<p>Njësitë kërkuese nuk kishin bërë kërkesën për mallra apo shërbime me kohë.</p> <p>Numri i lartë i kontratave të nënshkruara jashtë planit të prokurimit</p>	<p>Mosrealizimi i objektivave vjetore të kompanisë sipas parashikimeve fillestare.</p>	<p>Njësitë kërkuese të parashtrajnë kërkesat me kohë për t'i lejuar zyrës së prokurimit planifikimin dhe inicimin me kohë të aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit.</p>
<p>Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Mungesa e zyrtarëve kompetentë për vlerësim të procedurave kishte bërë që zyrtarët që kishin hartuar specifikimet teknike ishin caktuar edhe anëtar të komisioneve të vlerësimit.</p>	<p>Mosrespektimi i parimeve për ndarjen e detyrave rrit rrezikun e paraqitjes së konfliktit të interesit me rastin e kryerjes së procedurave të prokurimit</p>	<p>Formimi i komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit të bazohet në parimet për ndarjen e detyrave me qëllim që të evitohet konflikti i mundshëm i interesit.</p>
<p>Shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik të papërgjegjshëm</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Shpërblimi me kontratë i Operatorit Ekonomik edhe pse në ofertën e tij financiare kishte gabime aritmetike të cilat kalonin dy për qind (2%) të vlerës totale të ofertës.</p>	<p>Mos-krahasimi i çmimeve të njëjësive me çmimet totale të ofertave ka rezultuar në shpërblimin me kontratë të OE-së me çmimin më të larta se konkurenca</p>	<p>Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ushtron mbikëqyrje më rigoroze ndaj komisioneve të vlerësimit në mënyrë që të evitohen rastet e tilla.</p>
<p>Mangësi në procesin e procedurave të prokurimit</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Mangësitë në procesin e procedurave të prokurimit ishin për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme</p>	<p>Caktimi i kriterëve jo adekuate në dosje të tenderit mund të ndikon në shpërblimin me kontratë të OE jo të përgjegjshëm.</p>	<p>Në rastin e aplikimit të kriterit ekonomikisht më të favorshëm, nën kriteret të përcaktuhen në mënyrë objektive dhe të matshme.</p>
<p>Vonesë në realizimin e kontratës</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Mos aplikimi i ndëshkimeve në rastet e vonesave në realizim të kontratës ishte se zyra e prokurimit nuk kishte informata nga menaxheri i kontratës lidhur me vonesat në realizim</p>	<p>Menaxhimi jo i duhur i kontratave ndikon në performancën e dobët në ofrimin e shërbimeve në mënyrë efikase për konsumatorët.</p>	<p>Menaxherët e kontratave, në rastet kur operatorët ekonomik nuk iu përmbahen limiteve kohore për liferimin e mallit, të aplikojnë ndëshkimet për mosplotësimin e kushteve të kontratave</p>

Prokurimi i mallrave të përdorura (KRU Prishtina)	Kompania kishte zhvilluar për procedurën "Furnizim me vetura të përdorura" edhe pse sipas interpretimeve të KRPP-së një gjë e tillë nuk rekomandohet.	Prokurimi i mallrave të përdorura mund të ndikoj në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e automjeteve dhe mund të ndikojnë në blerje krejtësisht jo efektive për autoritetin kontraktues.	Para inicimit të procedurave të prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aktivitet të prokurimit që në një mënyrë redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës (Telekomi i Kosovës)	Mos aplikimi i kontrolleve efektive nga autoriteti kontraktues.	Mos zbatimi i plotë i kërkesave ligjore të prokurimit, mund të rezultojë në menaxhim të dobët në implementimin e kontratave.	Rishikimi i brendshëm të ndërmerret për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se mangësitë e identifikuar janë adresuar.

15.4 Analiza e gjendjes financiare në ndërmarrjet publike

Në vijim të kësaj analize, janë paraqitur janë paraqitur treguesit kryesor të gjendjes financiare për shtatë ndërmarrje publike të nivelit qendror dhe katër të nivelit lokal. Subjekt i kësaj analize kanë qenë: të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtëra dhe afat gjata.

Tabela 31 - Rezultati financiar dhe detyrimet e Ndërmarrjeve Publike më 31.12. 2018 (në euro)

Nr	Subjekti i audituar	Të Hyrat	Shpenzimet	Rezultati financiar	Detyrimet afatshkurtëra	Detyrimet afatgjata
1	KMDK Sh.a	2,307,502	2,146,912	137,015	445,860	1,140,340
2	Stacioni i Autobusëve Sh.a, Prishtinë	1,100,799	1,277,171	(176,372)	69,669	0
3	Hortikultura Sh.a	1,242,485	1,097,537	130,453	3,495	32,258
4	Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a	2,719,462	3,936,688	(476,290)	1,896,603	3,186,968
5	KRU Hidroregjioni Jugor Sh.a, Prizren	5,242,958	5,208,195	34,763	4,569,955	11,459,781
6	Posta e Kosovës sh.a	11,032,384	13,366,225	(2,333,841)	3,921,473	0
7	Telekomi i Kosovës sh.a	66,238,943	82,164,000	(15,925,000)	56,177,000	0
8	KRU Prishtina Sh.a	16,459,736	16,737,177	(751,015)	2,214,209	52,311,203
9	KRM Pastrimi Sh.a	6,834,440	6,582,496	226,749	1,925,514	312,041
10	KRM Uniteti Sh.a	1,686,597	1,826,367	(139,770)	2,621,759	562
11	KRU Drini i Bardhë sh.a	367,080	274,204	900	95,897	2,608,151

Ndërmarrjet publike nuk kanë prezantuar raportime të sakta të llogarive, si në regjistrat kontabël ashtu edhe në PFV. Në pasqyrat financiare për vitin 2018, gjashtë ndërmarrje publike kishin prezantuar rezultat negativ financiar që në total paraqesin humbje prej 19,802,288€, ndërsa pesë ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar me një fitim total prej 529,880€. Pjesën dërmuese të humbjeve prej mbi 18 milionësh e përbëjnë Telekom dhe Posta e Kosovës.

Pasqyra më lart tregon për një stabilitet të brishtë financiar të këtyre ndërmarrjeve. Ato, të gjitha së bashku, kanë mbi 73 milionë detyrime afatshkurtra të financimit, dhe mbi 71 milionë detyrime afatgjata. Aftësia e kthimit të këtyre detyrimeve është mjaft e pasigurt, për shkak se suma e humbjeve është mjaft e lartë, ndërsa ato që kanë pasqyruar rezultate pozitive, fitimet e tyre janë shumë të ulta për të qenë në gjendje t'i financojnë edhe aktivitetet e rregullta operative, por edhe për t'i kthyer kreditë afatshkurtëra brenda afateve të përcaktuara. Edhe vitin e kaluar kemi vlerësuar se me trende të tilla financiare, parimi i vijimësisë së veprimtarisë në disa prej tyre, mund të vie në pikëpyetje serioze.

Pasi që struktura e financimit të këtyre ndërmarrjeve është mjaft e pavolitshme për shkak se mbi 73 milionë janë obligime afatshkurtëra që duhen kthyer brenda një viti, ekziston rreziku real që këto ndërmarrje të mos jenë në gjendje t'i përmbushin këto detyrime. Në këtë rast, Qeveria do të jetë nën presion që t'i mbulojë disa deficite operative të këtyre ndërmarrjeve për t'iu shmangur procedurave të falimentimit për shkak të interesit publik. Pra, nëse nuk merren masa të shpejta për hartimin e programeve sanuese, barra financiare e Qeverisë vetëm sa do të ngarkohet edhe më shumë.

Sa i përket performancës së Bordeve Drejtuese të Ndërmarrjeve publike, ato nuk kanë arritur të vendosin politika reformuese dhe strategji të qarta për tejkalimin e gjendjes aspak të mirë në mjediset ku veprojnë. Prandaj, në kushte të tilla, përfshirja më aktive e Qeverisë në zgjidhjen e problemeve është nevojë e pa kapërcyeshme.

Rekomandojmë Qeverinë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Komunat që:

- Në bashkëpunim me Kryesuesit e Bordeve Drejtuese duhet të analizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, në veçanti ndërmarrjeve që operojnë me humbje, të ndërmarrin masa adekuate për riorganizim të NP-ve, të analizojnë gjendjen e detyrimeve, në veçanti atyre afatshkurtëra, të përcaktojnë burimet për likuiditetin e detyrimeve, si dhe përmes planeve vjetore dhe strategjike, të bëjnë riprogramim të borxheve; dhe
- Komunat përkatëse si aksionarë kryesor të ndërmarrjeve në nivel lokal, të ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe më rigorozë ndaj menaxhmentit të ndërmarrjeve. Po ashtu, edhe performanca e Bordeve Drejtuese duhet të jetë subjekt i rishikimit, dhe aty ku vlerësohet se Bordet nuk janë të afta në përballimin e detyrave, të merren masa për rritjen e përgjegjësisë dhe efektivitetit në punë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për "Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit".

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2017

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA 2017	Rekomandimet e zbatuara	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara	Rekomandimet e pazbatuara
		<i>Kapitulli 9</i>		
Kuvendi i Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> • Të siguroj që pas pranimit të këtij raporti, plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është përgatitur nga Qeveria dhe i njëjti është shqyrtuar edhe nga KMFP. Po ashtu, të siguroj që plani do të inkorporojë të gjitha rekomandimet e dhëna dhe të përcaktoj saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre; dhe • Së paku dy herë në vit të shqyrtoj progresin e arritur për rekomandimet e dhëna, të fuqizoj masat e llogaridhënies dhe të propozoj masat për eliminimin e të gjitha pengesave që mund të ndikojnë në moszbatimin e rekomandimeve. 	Plani i veprimit është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend (KMFP), i cili i ka ftuar përfaqësuesit e Qeverisë për takim lidhur me shqyrtimin e planit.		Nuk ka raporte mbi shqyrtimin e progresit të rekomandimeve brenda vitit.
		<i>Kapitulli 15</i>		
	<ul style="list-style-type: none"> • Të rris llogaridhënien ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të siguruar që Gjykatat Themelore kanë rritur efikasitetin në trajtimin dhe menaxhimin e lëndëve civile në përputhje me procedurat dhe rregullat në fuqi; • Të rishikoj kornizën ekzistuese ligjore për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe të propozoj nismat ligjore për funksionalizimin e rrejtit monitorues dhe masave parandaluese të ndotjes së ajrit; dhe 		Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin e Veprimit për Cilësi të Ajrit, si dhe Instituti Hidrometeorologjik ka vënë në funksion softuerin	Këshilli Gjyqësorë i Kosovës nuk ka ofruar përgjigje apo dëshmi për masat e ndërmarra për rritjen e efikasitetit në menaxhimin dhe trajtimin e lëndëve civile. Zyra Kombëtare e Auditimit do të kryej auditim përcjellës për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përmes komisionit parlamentar për shëndetësi, të inicioj diskutimet për sfidat në aplikimin e SISH dhe të propozoj masat për zbatimin e tij në të gjitha Institucionet shëndetësore. 	<p>Komisioni parlamentar për shëndetësi ka mbajtur dy takime ku ka diskutuar për zbatimin e SISH dhe ka dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemit. Po ashtu, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seance plenare për diskutimin e gjetjeve në auditimin e SISH-it dhe ka propozuar masa për zbatim.</p>	<p>dhe aplikacionin mobil për raportimin e të dhënave të cilësisë së ajrit në kohë reale. Megjithatë, rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit mbeten të vlerësohen me auditim përcjellës.</p>	
Qeveria e Kosovës	<p>Qeveria duhet që t'i shqyrtoj në baza të rregullta raportet vjetore për borxhet publike të Ministrisë së Financave, dhe t'i diskutoj në mënyrë gjithëpërfshirës nevojën për marrjen e borxheve, rezultatet dhe pengesat në proces, si dhe t'i forcoj masat lidhur me shfrytëzimin efikas dhe efektiv të fondeve të huamarrjes.</p>		<i>Kapitulli 3</i>	<p>Bazuar në rrethanat e njëjta edhe këtë vit, vërehet se nuk ka ndonjë veprim konkret që tregon ndonjë progres në menaxhimin e borgjeve publike.</p>

<p>Ministria e Financave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, Ministria e Financave duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara nga Ministritë e linjës në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, Qeverisë duhet t'i sugjerohen masat e duhura për tejkalimin e vështirësive; dhe • MF duhet të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i projekteve do të bëhet në kohën e duhur. 		<ul style="list-style-type: none"> • Në tremujorin e këtij viti, MF ka raport lidhur me gjendjen apo progresin e projekteve të financuara nga huamarrjet. Megjithatë, nuk është vërejtur progres i arritur lidhur me financimin e këtyre projekteve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është vërejtur progres arritur lidhur me ndonjë udhëzim shtesë nga MF që përfshijnë planet e investimeve kapitale.
<i>Kapitulli 4</i>				
<p>Qeveria e Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha organizatat buxhetore mbajnë regjistra të plotë dhe të saktë të pasurive, si në aspektin financiar, ashtu edhe atë sasior; dhe • Të gjitha organizatat buxhetore themelojnë komisionet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive në përputhje me Rregulloren MF nr. 02/ 2013 mbi Menaxhimin e pasurive. 		<ul style="list-style-type: none"> • Disa nga organizatat buxhetore, sidomos te niveli lokal, nuk mbajnë apo kanë mangësi në regjistrat e pasurisë. • Po ashtu, në disa organizata buxhetore të nivelit lokal (7 komuna), nuk janë themeluar komisionet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive. 	

Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Financave duhet të mundësoj çasje të papenguar për regjistrimin dhe përditësimet në regjistrin kontabël të SIMFK; • Llogaritja e zhvlerësimit të pasurive bëhet konform normave të caktuara me rregullore; dhe • Të përcaktohen politika dhe përmes trajnimeve të ofrohen udhëzime të qarta si të trajtohen pasuritë me vlerën kontabël zero. 	<ul style="list-style-type: none"> • Në raportimet individuale, nuk është vërejtur se ka pengesa në çasje në SIMFK. 		<ul style="list-style-type: none"> • Në disa OB, nuk është aplikuar zhvlerësimi i pasurisë. Në anën tjetër për faktin se ende ka OB që nuk aplikojnë E-pasurinë apo regjistrin e tyre nën 1000€. Kjo reflekton edhe në aplikimin e mos zhvlerësimit të pasurisë. • OB ende vazhdojnë të kenë paqartësi lidhur me regjistrimin e pasurive me vlerë zero.
<i>Kapitulli 5</i>				
Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet ta trajtoj problemin e menaxhimit të këtyre llogarive me Doganën dhe Administratën Tatimore, pasi që borxhet e pa mbledhura nga këto dy agjenci përbëjnë rreth 65% të borxheve totale të qytetarëve dhe subjekteve tjera juridike.			Sfidat në menaxhimin e borgjeve të pa mbledhshme ende mbesin. Edhe këtë vit, borgjet e pa mbledhura nga këto dy agjenci mbesin të njëjta rreth 66%.
<i>Kapitulli 8</i>				
	<ul style="list-style-type: none"> • Të vendos procese efektive për të siguruar që procesi i hartimit të RVF/BRK-së 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe kërkesat e raportimit financiar. Çështjet e ngritura në bazën e opinionit duhet të adresohen si çështje prioritare në fushën e përmirësimeve. 		<ul style="list-style-type: none"> • Në Raportin Vjetor Financiar (RVF) të BRK-se për vitin 2018 MF/Thesari kanë ndërmarr veprime dhe në Aneksin nr. 12. Raportimi i detyrimeve kontingjente sipas OB-ve. Megjithatë, 	

<p>Qeveria e Kosovës / Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit</p>	<p>Buxhetimi i shpenzimeve duhet të bëhet në kategori ekonomike adekuate. Më tej, procesi i konsolidimit duhet të përfshij regjistrimin dhe raportimin e plotë të pasurive si dhe informata plotësuese për detyrimet kontingjente;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të siguroj një planifikim të mirë të OB-ve të qeverisjes qendrore që realizojnë të hyra jo tatimore (taksa, ngarkesa dhe tjera), në mënyrë që t'i shmanget praktikës së deritashme të planifikimit në bazë të të dhënave historike dhe përcaktimit vetëm të shumave totale; • Ministria e Financave në koordinim me komunitat të zhvilloj një proces më efikas të monitorimit dhe vlerësimit të planit për grumbullimin e të hyrave, të identifikohen shkaqet për mos përmbushjen e planit dhe kjo të reflektohet në planifikimet buxhetore; • Të siguroj një raportim më cilësor dhe të saktë të detyrimeve kontingjente dhe të vendos një komunikim më të mirë të Avokaturës Shtetërore me Institucionet që ajo i përfaqëson, në mënyrë që palët e paditura t'i kenë informatat në kohën e duhur në lidhje me kontestet dhe paditë; dhe • Thesari/Divizioni për Monitorim, të fuqizoj kontrollin në procesin e ekzekutimit të pagesave sipas nenit 39.2 duke dëshmuar një analizë të plotë dhe të mbështetur me dëshmi. Një rishikim më kritik i raporteve për 	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i makros në koordinim me OB-te përgjegjëse për administrimin dhe grumbullimin e të hyrave nga OB-të nivele qendrore kanë ndërmarr veprime dhe kanë përgatitur projeksionet e parashikuara për realizimin e të hyrave nga OB-te Niveli Qendror. • Testimi i mostrave të auditimit lidhur me pagesat direkte sipas nenit 39.2, nuk ka treguar të gjetura në 	<p>nga gjetjet e raporteve individuale rezultojnë se edhe në vitin 2018 janë identifikuar buxhetin të shpenzimeve në kode jo adekuate si dhe raportimi i jo i plotë dhe i saktë i pasurive.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të hyrat e planifikuara dhe nga OB-te te niveli lokal ishte prej 84% e planit. Vazhdon performancë jo e kënaqshme në realizimin e planit. • Në aneksin nr. 12 të PVF-ve të BRK-se janë prezantuar detyrimet kontingjente, informatat në këtë raport janë konsoliduar nga pasqyrat financiare individuale të OB-ve, ndërsa sa i përket komunikimit ndërmjet Avokaturës Shtetërore dhe institucioneve që i përfaqëson mbetet ende për 	
---	--	---	--	--

	obligimet e papaguara është i nevojshëm dhe aty ku vonesat dhe vlera e obligimeve është materiale, ta adresoj çështjen tek zyrtarët më të lartë në zinxhirin llogaridhënës të organizatës përkatëse.	këtë vit.	zbatim.	
	<i>Kapitulli 9</i>			
Qeveria e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, dhe me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave të përgjegjës ndaj menaxherëve përgjegjës për dështimet në zbatimin e rekomandimeve. 		<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo nuk ka indikacione se janë marrë veprime shtesë për monitorimin apo shqyrtimin e progresit të arritur për zbatimin e tyre. 	
Kuvendet Komunale	<ul style="list-style-type: none"> • Kryetarët e Komunave duhet t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë. 		<ul style="list-style-type: none"> • Në të shumtën e rasteve, planet e veprimit kanë dalë në diskutim në Kuvendet Komunale. Megjithatë, nuk ka raportime në Kuvendet Komunale për progresin dhe sfidat lidhur me zbatimin e tyre. 	
	<i>Kapitulli 11</i>			
Qeveria e Kosovës / Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> • Me rastin e kërkesave nga OB-të, të rishikojnë mundësitë buxhetore dhe të alokojnë fondet e nevojshme për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në organizatat në të cilat këto njësi- ende nuk janë themeluar; • Subjektet e sektorit publik që i kanë të themeluara NjAB-në, duhet të themelojnë edhe Komitetet e Auditimit (KA) për të mbështet dhe 		<ul style="list-style-type: none"> • Nga 14 OB, sa nuk e kishin KA në vitin 2017, vërehet një progres pasi që në 2018 ky numër kishte rënë në 11. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk janë marrë veprime, pasi që NJAB-të ende nuk ishin themeluar në Organizatat që duhet ta kenë të themeluar këtë Njësi edhe sipas kërkesave të UA të vjetër dhe të ri.

	<p>fuqizuar funksionin e auditimit të brendshëm, ndërsa KA-të duhet të jenë më efektive në punën e tyre dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies financiare; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhmenti i organizatave të cilat nuk kanë hartuar regjistër të rreziqeve, duhet të përmbushin këtë kërkesë të MF/K për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara, si dhe të zbatojnë procese të rregullta monitorimi. 		<p>Po ashtu, kemi vërejtur se në fillim të vitit 2019 në 6 Komuna ishte themeluar KA.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizatat Buxhetore (24 prej tyre) për vitin 2018, ende nuk kanë hartuar regjistrin e rreziqeve. Ndërsa sa i përket veprimeve konkrete që janë ndërmarrë në lidhje me menaxhimin e rreziqeve, vërehet një gjendje shqetësuese pasi që pak organizata e kanë trajtuar seriozisht menaxhimin e rrezikut, duke mos bërë azhurnimin dhe monitorimin e rreziqeve ashtu siç kërkohet me procedurat e MFK-së. 	
<p>Qeveria e Kosovës / Ministria e Financave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Platforma e prokurimit elektronik zbatohet plotësisht nga të gjitha organizatat buxhetore dhe në të gjitha procedurat e prokurimit edhe për vlera të vogla; dhe • AQP ka përmirësuar praktikën e prokurimit në kontratat e centralizuara. 	<p><i>Kapitulli 12</i></p>		
		<ul style="list-style-type: none"> • Ka pasur një rritje të dukshme në përdorimin e platformës së prokurimit elektronik, mirëpo nuk është përdorur edhe për vlerat e vogla. • Ajo çfarë është bërë deri tani që mund të ndikojë përmirësimin e praktikave gjatë zhvillimit të procedurave të 		

			centralizuara janë disa ndryshime/plotësime në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik të hartuar nga KRPP.	
	<i>Kapitulli 14</i>			
Qeveria e Kosovës / MKRS	<ul style="list-style-type: none"> • Të iniciojnë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të Institucioneve të kulturës me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu, menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse në ministri. 			<ul style="list-style-type: none"> • Edhe këtë vit situata është e njëjtë që ka të bëjë me inicimin e procedurave për harmonizimin e ligjeve.
Qeveria e Kosovës / MPJ	<ul style="list-style-type: none"> • Të iniciojnë rishikimin e legjislacionit sekondar në lidhje me shërbimin e jashtëm në mënyrë që të qartësohet saktë procedura e përfundimit të mandatit të përfaqësuesve diplomatik, përfshirë periudhat kohore të nevojshme dhe çështjet relevante për tërheqjen dhe ri sistemimin e stafit diplomatik. Në rastet kur paraqitet nevoja për zgjatjen e mandatit të përfaqësuesve të caktuar diplomatik, kjo duhet të bëhet me vendim apo shkresë nga Ministri, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm. 		<ul style="list-style-type: none"> • Çështja e përfundimit të mandatit nuk është rregulluar ende me legjislacion. Mirëpo në rastet kur është tejkalluar afati janë bërë vendime nga ministri për zgjatjen e mandatit (në përjashtim të një rasti të izoluar i cili është i paraqitur në raportin e auditimit të MPJ). 	
Qeveria e Kosovës / Ministria e Diasporës	<ul style="list-style-type: none"> • Brenda një afati të arsyeshëm kohor, të merren veprimet për t'i rekrutuar drejtorët e QKKDM-ve në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që të njëjtit të futen në listën e pagave dhe të paguhen nga kategoria adekuate e 			<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është bërë rekrutimi i drejtorëve të QKKDM-ve sipas kërkesave ligjore. Kjo ka mbetur si peng i Ligjit të ri për diasporën i cili është në procedurë të aprovimit në

<p>Qeveria e Kosovës</p>	<p>shpenzimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qeveria duhet të shqyrtoj çështjen e operimit pa licenca pune të Ndërmarrjeve publike, KMDK dhe KRU “Drini i Bardhë” dhe në bashkëpunim me MMPH dhe Bordet Drejtuese të këtyre dy Ndërmarrjeve, brenda një afati të arsyeshëm, këto dy ndërmarrje të pajisen me licenca valide të punës; dhe • Në bashkëpunim me MZHE, të zgjidhin problemin e përcaktimit të tarifave për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave për nevojat e KMDK-së. 		<ul style="list-style-type: none"> • Licencën e punës KMDK nuk e ka siguruar ende, ndërsa KRU Drini i Bardhë po. 	<p>Kuvend.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk është zgjidhur ende problematika e përcaktimit të tarifave për grumbullimin e mbeturinave për nevojat e KMDK-së.
<p><i>Kapitulli 15</i></p>				
<p>Qeveria e Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të analizoj procesin e prokurimeve të centralizuara dhe të siguroj se prokurimet përmes AQP-së përmbushin me kohë dhe cilësinë e duhur nevojat e organizatave buxhetore, si dhe arrinë vlerën për para; dhe 		<ul style="list-style-type: none"> • KRPP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në bazë të rekomandimeve të dhëna në auditimin Vlera për para në prokurimet e centralizuara ka ndërmarr disa veprime korrigjuese duke plotësuar dhe avancuar më tutje Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik. Niveli i zbatimit të rekomandimeve në këtë fushë mbetet të vlerësohet përmes auditimit të fazës së dytë pas implementimit të prokurimeve të centralizuara. 	

Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> • Të siguroj se angazhimi i punonjësve për marrëveshje për shërbime të veçanta dhe detyra specifike bëhet në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore dhe vetëm për punë dhe detyra të cilat kërkojnë ekspertizë të veçantë për kryerjen e detyrave në sektorin publik • Të analizoj të gjitha mangësitë dhe dobësitë e Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë dhe të ndërmerr masat e duhura që sistemi të jetë plotësisht efikas dhe të gjeneroj të dhëna të plota për të gjithë obliguesit e tatimit në pronë. 		<ul style="list-style-type: none"> • Pavarësisht disa përmirësimeve që ishin bërë gjatë procesit auditues, sistemi i tatimit në pronë vazhdon të prodhoj të dhëna jo të plota. Rezultatet e auditimit të rregullsisë për vitin auditues 2018, tregojnë për probleme në mosbarazime në mes të thesarit dhe sistemit si dhe probleme me regjistrimin e tatimpaguesit ku është lejuar zbritja për banim primar më shumë se njëherë 	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i punonjësve për marrëveshje për shërbime të veçanta dhe detyra specifike ka vazhduar të kryhet jo në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore dhe jo për punë dhe detyra të cilat kërkojnë ekspertizë të veçantë për kryerjen e detyrave në sektorin publik.
<i>Kapitulli 16</i>				
Qeveria e Kosovës / Ministria e Zhvillimit Ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> • Të merr masa të menjëhershme për shqyrtimin e gjendjes së përgjithshme të këtyre ndërmarrjeve publike. Bordet Drejtuese të këtyre ndërmarrjeve duhet të kenë rolin kyç në adresimin e problemeve më kryesore me të cilat përballen ndërmarrjet, dhe më pas, të përcaktojnë një pako masash dhe veprimesh të cilat duhet të zbatohen me qëllim të sanimit të gjendjes ekzistuese. <p>Përveç çështjeve menaxhuese dhe operative, fokus i veçantë i shqyrtimeve duhet të jetë gjendja e detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata dhe aftësia likuiduese e ndërmarrjeve kundrejt detyrimeve që kanë.</p>			<ul style="list-style-type: none"> • Nuk kanë ndërmarrë masa për të përcaktuar pako masash dhe veprimesh pers animin e gjendjes ekzistuese. As ndonjë veprim/fokus nuk është bërë nga Qeveria/MZHE për marrjen e masave për detyrimet afatshkurta dhe afatgjata dhe aftësinë likuiduese të ndërmarrjeve.

Shtojca III: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2018

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

	Shënim	2018		2017		2016	
		Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €
PRANIMET							
Tatimet Direkte							
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	86,797		75,277		80,817	
Tatimi në të ardhura personale	3	152,820		136,924		123,982	
Tatimi në pronë	4	24,196		22,407		25,128	
Tatime tjera direkte	5	3,692		3,426		2,194	
		267,504		238,034		232,121	
Tatimet Indirekte							
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	799,020		756,117		693,754	
Detyrimi doganor	7	123,747		125,993		129,970	
Akciza	8	418,903		432,279		403,296	
Tatime tjera indirekte	9	2,460		847		372	
		1,344,130		1,315,236		1,227,392	
Kthimet tatimore							
Kthimet tatimore	10	-47,880		-57,583		-38,381	
		-47,880		-57,583		-38,381	
Të hyrat jo-tatimore							
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	110,398		103,445		97,172	
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	46,350		43,348		39,933	
Taksa koncesionare	13	8,792		8,519		7,683	
Renta minerare	14	25,233		30,570		30,554	
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	2,092		2,633		4,652	
		192,865		188,515		179,995	
Huamarrja							
Huamarrja e jashtme shtetërore	16	11,334		108,256		44,687	
Pranimet për shërbimin e nën-huazimeve	17	8,250		8,377		8,536	
Huamarrja e brendshme shtetërore	18	102,434		95,301		101,189	
		122,018		211,934		154,412	
Grantet dhe ndihmat							
Grantet e përcaktuara të donatorëve	19	8,319	178	8,312	386	8,735	3,255
		8,319	178	8,312	386	8,735	3,255
Pranimet tjera							
Fondi i depozitave	20	3,612		2,481		2,059	
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	21	10,876		6,716		2,557	
Të hyrat e dedikuara	22	10,493		9,390		9,018	
Të hyrat e njëhershme nga AKP-ja	23	86,146		326		-	
Të hyrat e njëhershëm nga FKPK-ja	24	11,590		-		-	
		2,009,673	178	1,923,360	386	1,777,908	3,255
Gjithsej Pranimet							
PAGESAT							
Operacionet							
Paga dhe rroga	25	592,588		550,749		544,831	
Mallra dhe shërbime	26	229,057	10	204,161	5	183,050	103
Shërbime komunale	27	23,440		24,158		23,362	
		845,085	10	779,068	5	751,242	103
Transferet							
Subvencione dhe transfere	28	558,778		508,316		475,103	
Shpenzimet kapitale							
Prona, impiantet, pajisjet, transferet	29	533,064	168	471,098	381	449,147	3,151
Pagesat tjera							
Pagesa e borxhit	30	40,741		77,308		85,199	
Pagesa për anëtarësim në IFN	31	-		-		717	
Kthimet nga fondet e depozitave	32	1,890		1,014		1,835	
		1,979,559	178	1,836,805	386	1,763,242	3,255
Gjithsej Pagesat							
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		30,115		86,555		14,666	
Para të gatshme në fillim të vitit	33	357,760		271,204		256,539	
Para të gatshme në fund të vitit	33	387,874	-	357,760	-	271,204	-

*Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018*

Shënim	2018				2017	2016
	Buxheti fillestar A	Buxheti përfundimtar B	Realizimi C	Ndryshimet buxhetore D=C-B	Realizimi	Realizimi
	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet direkte	267,040	267,040	267,504	464	238,034	232,121
Tatimet indirekte	1,378,385	1,378,385	1,344,130	(34,255)	1,315,236	1,227,392
Kthimet tatimore	(46,000)	(46,000)	(47,880)	(1,880)	(57,583)	(38,381)
Të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor	4,000	4,000	-	(4,000)	-	-
Të hyrat e njëhershme tatimore nga borxhet e NSH-ve	4,000	4,000	-	(4,000)	-	-
Të hyrat jo-tatimore	202,000	202,000	192,865	(9,135)	185,881	175,343
Grantet dhe ndihmat	19,000	19,000	8,497	(10,503)	8,698	11,989
Huamarrja	216,814	216,814	122,018	(94,796)	211,934	154,412
Pranimet tjera*	132,500	144,090	122,717	(21,373)	21,547	18,286
Gjithsej Pranimet	2,177,739	2,189,329	2,009,851	(-179,478)	1,923,746	1,781,162
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Shërbimet e përgjithshme publike	208,666	223,661	204,611	(19,050)	193,212	171,491
Mbrojtja	53,667	48,949	46,477	(2,472)	34,914	44,081
Rendi dhe siguria publike	199,001	184,705	176,342	(8,363)	156,050	154,865
Çështjet/marrëdhëniet ekonomike	528,366	561,693	450,818	(110,875)	418,819	384,929
Mbrojtja e ambientit	87,307	22,286	16,447	(5,839)	9,934	10,570
Çështje banimi dhe komuniteti	13,929	52,129	43,212	(8,916)	35,288	40,505
Shëndetësia	212,480	211,018	199,806	(11,211)	178,607	167,843
Rekreacion, kulturë, religjion	68,063	64,282	57,080	(7,202)	47,929	38,292
Arsim	305,496	318,787	301,877	(16,910)	282,747	280,153
Mbrojtja sociale	415,506	442,185	440,435	(1,750)	401,370	386,017
Të tjera **	66,164	66,164	42,631	(23,533)	78,322	87,750
Gjithsej Pagesat	2,158,645	2,195,859	1,979,737	(216,122)	1,837,191	1,766,497
Deficiti/Suficiti	19,094	(6,530)	30,115	36,644	86,555	14,666

Shënim: (*) Përfshihen: të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e njëhershme të AKP-së (janë bërë e pjese e buxhetit final si pranim), të hyrat e njëhershme të FKPK-së dhe pranimet nga depozitat (përfshijtur planifikimin buxhetor për depozita), financimi i interesit sipas tabelës 1 të ligjit të buxhetit Nr.06/L-020.

(**) Përfshihen: pagesa e borxhit, nen-huazimi, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave (përfshijtur planifikimin buxhetor për depozita)

*Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018*

		2018	2017	2016
	<u>Shënim</u>	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €
Pasuritë financiare - paraja e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	35	374,663	339,906	257,393
Kuotat në IFN (2018)	36	1,741	-	-
Fondi në mirëbesim për zhvillim	37	4,514	5,047	4,125
Paratë e gatshme në transit	38	4,031	10,179	7,371
Llogaritë e misioneve diplomatike	39	1,074	1,045	929
Paratë e gatshme në dorë (arka)	40	1,851	1,583	1,385
Gjithsej pasuritë në para të gatshme		387,874	357,760	271,204
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	41	8,366	6,837	7,280
Të hyrat vetanake të bartura	42	48,240	32,880	27,156
Fondi në mirëbesim për zhvillim	43	11,437	10,321	10,058
Të hyrat e dedikuara	44	1,706	803	841
Të tjera	45	16,432	14,722	13,109
		86,182	65,564	58,446
Të pashpërndara		301,693	292,196	212,759
Gjithsej Bilanci i Fondeve	33	387,874	357,760	271,204

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM / DATE: 23.08.2019			
Mësimi Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Nr. ifaqëve Nr. Stranica No. Pages
03	47	1846	1



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija Ministry of Finance Thesari - Trezor - Treasury			
Nr. ifaqëve Org. Jedin. Org. Unit	THESAR	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	132
Nr. ifaqëve Broj stranica No. pages	✓	Data Datum Date:	23, 08, 2019
Dollësi PRISHTINEJA			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

AED
z. Ahmet Ismaili
Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit,
Ministria e Financave



Data: 23 Gusht 2019, Prishtinë